



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Bulqizë

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

MBI “AUDITIMIN FINANCIAR”

Tiranë, tetor 2025

		PËRMBAJTJA	Faqe
SHKURTIME			3-3
I		PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4-10
	1	Përshkrimi i shkurtër i Raportit të Auditimit	4-5
	2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	5-9
	3	Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit	9-10
II.		HYRJA	11-15
	1	Objektivat e auditimit dhe Qëllimi i auditimit	11-11
	2	Identifikimi i çështjes	11-12
	3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	12-12
	4	Përgjegjësitë e audituesve	12-13
	5	Kriteret e vlerësimit	13-14
	6	Standardet e auditimit	14-14
	7	Metodat e auditimit	14-15
	8	Dokumentimi i auditimit	15-15
III.		PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	16-64
	1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	16-16
	2	Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit	16-64
	2.1.1	Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin e brendshëm	16-25
	2.1.2	Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e auditit të brendshëm	25-32
	2.2	Vlerësimi Raportimit Financiar, hartimi i pasqyrave financiare	32-55
	2.3	Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.	56-64
IV.		GJETJET DHE REKOMANDIMET	64-75

AAM	Aktive Afatgjata Materiale
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave të Ndërtimeve Informale
AK	Autoritet Kontraktor
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
AZHT	Agjencia e Zhvillimit të Territorit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NJA	Njësi Administrative
NJP	Njësia e Prokurimit
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator Ekonomik
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
PF	Pasqyrat Financiare
PMNZSH	Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtim
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SHA	Shoqëri Anonime
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
UP	Urdhër Prokurimi
USH	Urdhër Shpenzimi
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.

Bashkia e Bulqizës është njësi vendore institucion i pavaruar, ku pas ndarjes së re territoriale është një bashkim mes qytetit dhe 8 njësi administrative si vijon: njësia administrative Bulqizë (qyteti), njësitë administrative Shupenzë, Gjoricë, Fushë-Bulqizë, Zerqan, Trebisht, Ostren, Martanesh.

Sipas Censurit të vitit 2024 numëron një popullsi prej 26,826 banorësh.. Bashkia e re ka në një sipërfaqe prej 678.51 km². Bashkia e re shtrihet thuajse në të njëjtin territor me krahinë etnografike të Bulqizës dhe ka terren kodrinor dhe malor. Relievi kodrinor-malor përcakton si burime kryesore gjeneruese bujqësinë dhe blegtorinë, por pa harruar edhe industrinë e nxjerrjes së kromit dhe atë të pasurimit të mineralit të kromit, ku rajoni i Bulqizës është mjaft i njohur. Ndërkohë, një tjetër burim i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të këtij rajoni konsiderohet edhe turizmi malor familjar si dhe ngritja e qendrave për grumbullimin e bimëve medicinale, me të cilat zona është mjaft e pasur. Projekte të mëdha të ndërmarra gjatë viteve të kaluara si asfaltimi i segmentit të rrugës nacionale “Qafa e Buallit- Shupenzë”, pjesë e Rrugës së Arbërit, si dhe hapjen e tunelit të po kësaj rruge në Qafën e Buallit me gjatësi 460 metër dhe trasenë Qafa e Buallit-Ura e Vashës kanë lehtësuar lëvizjen dhe transportin. Po kështu, investime të rëndësishme mund të konsiderojmë edhe sistemim asfaltimet e rrugëve rurale që lidhin qendrat e komunave Zerqan, Fushë-Bulqizë dhe Gjoricë, me rrugën nacionale. Qyteti i Bulqizës, i ndërtuar në funksion të minierës së kromit dhe rezervave të mëdha të kromit ka një numër të konsiderueshëm biznesesh, ndërsa numri i të punësuarve në minierë si dhe përfitimet ekonomike nga punësimi kanë variuar gjatë dekadave të fundit

Misioni i Bashkisë Bulqizë është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve, duke garantuar vetëqeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore. **Synimi kryesor** është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

Buxheti i Bashkisë Bulqizë si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavarur, nga transferta e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transferta specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave ndërkombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

a. Për vitin 2024 nga Bashkia Bulqizë janë shpenzuar gjithsej 1,120,854 mijë lekë nga të cilat: shpenzime për paga dhe kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 343,413 mijë lekë; për shpenzime operative në vlerën 113,108 mijë lekë; për shpenzimet korrente të brendshme në vlerën 408,260 mijë lekë; për investime në vlerën 256,073 mijë lekë.

b. Për vitin 2024 Bashkia Bulqizë nga mbledhja e taksave dhe tarifave vendore ka arkëtuar gjithsej vlerën 127,199 mijë lekë.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të Ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore”, nenit 50 “Auditi i jashtëm”, pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: “1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njërive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë”.

Ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Bulqizë si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar

nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Bulqizë për periudhën e aktivitetit 2024 qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

c. Qëllimi i auditimit

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- *Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm;*

- *Mbi vlerësimin e raportimit financiar dhe dhënien e opinionit për pasqyrat financiare të vitit 2024;*

- *Mbi zbatimin i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.*

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore.

Auditimi është kryer mbi bazë risku. ***Vlerësimi i riskut të kontrollit;***

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë faktorët e riskut prej 0,7 % për shpenzimet dhe 2% për investimet. Për vitin 2024 niveli i materialitetit pranohet në vlerën 25,614 mijë lekë dhe gabimi i lejuar (10% - 20%) në vlerën 2,561 mijë lekë për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Mbi transaksionet u aplikuan: - teste të kontroleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (u analizua menaxhimi financiar dhe kontrolli).

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

e. Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 17 gjetje dhe ka dhënë 17 rekomandime, nga ku 12 masa organizative dhe 12 rekomandime, 1 masë për arkëtim detyrime për tatim taksa vendore dhe 1 rekomandim, 4 masa për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave me efekt mungesë të ardhurash dhe 4 rekomandime.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore. Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:

▪ ***Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin.***

- Gjatë auditimit u konstatua se bashkia nuk ka procedurë të dokumentuara për raportimin e shkeljeve të etikës dhe për marrjen e masave ndëshkuese. Gjithashtu, mungesa e mekanizmave të dedikuara për trajtimin e ankesave për korrupsion tregon për një dobësi në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe transparencës institucionale.
- Bashkia nuk disponon një plan vjetor rekrutimi, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në planifikimin dhe menaxhimin efikas të burimeve njerëzore. Rekrutimet bëhen sipas nevojave të momentit, pa një analizë paraprake të burimeve dhe nevojave strategjike.
- Mungon vlerësimi i rreziqeve për mashtrime, si dhe kryerja e vlerësimeve periodike të ekspozimit ndaj tyre.
- Bashkia nuk disponon një sistem të brendshëm raportimi për shkeljet e rregullave apo raste të mundshme mashtrimi, duke kufizuar aftësinë e saj për të ndërhyrë në kohë dhe për të mbrojtur burimet publike.
- Nuk është hartuar gjurmë auditimi për proceset kryesore të punës.
- Mungesa e sistemeve të informacionit (IT) funksionale përtej platformave qendrore si APP dhe SIFQ, si dhe mungesa e procedurave për rikuperimin dhe ruajtjen e të dhënave (back-up), përbën një tjetër rrezik të konsiderueshëm për sigurinë dhe integritetin e informacionit financiar dhe administrativ.

▪ ***Mbi organizimin dhe funksionimin e auditit të brendshëm.***

- Gjatë auditimit u konstatua se nga Bashkia Bulqizë nuk është ngritur Komiteti i Auditimit, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në nenet 12, 13 të Ligjit nr. 114/2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*” i ndryshuar.
- Për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2024, nuk janë audituar aktivitete që kryen Bashkia Bulqizë, si Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit si dhe Inspektoriat i Mbrojtjes së Territorit Vendor, në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit;
- Në çdo raport auditimi, audituesit nuk kanë dhënë asnjë opinion të përgjithshëm mbi të gjitha sistemet e audituara, nëse këto sisteme funksionojnë në nivelin e duhur nga të gjitha strukturat apo punonjësit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve.
- NjAB në Bashkinë Bulqizë nuk ka dosje të përhershme për çdo njësi publike ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli VI, pika “*Dosja e Përhershme*”.
- Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk ka hartuar “*Programin për sigurimin e brendshëm të cilësisë të drejtorisë së auditimit të brendshëm*”

▪ ***Në procedurat e raportimit financiar dhe hartimin e pasqyrave financiare***

- Teprica e llog. 231 “*Për aktive afatgjata materiale*” paraqitet në shumën 232,089,659 lekë në pasqyrën e pozicionit financiar, e cili nuk rakordon me llogaritë kundërpartit të saj si: llog. 106 “*Teprica e granteve kapitale të huaja*” në fondin e konsoliduar, e cila paraqitet në shumën 117,223,816 lekë, dhe llogaria 105 “*Teprica e granteve kapitale të brendshme*” paraqitet në shumën 0 lekë, pra me një diferencë prej 114,865,843 lekë. Kjo diferencë është keqklasifikuar në llogarinë 101 “*Teprica(fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar*” në PF.
- Nga auditimi i të ardhurave konstatohet se kemi mospërputhje midis pasqyrës së performancës dhe pasqyrës së flukseve monetare. Të ardhurat jo tatimore të kontabilizuara gjatë vitit në pasqyrën e performancës janë në shumën 66,509,118, ndërsa të ardhurat tatimore në pasqyrën e rezultatit pasqyrohen në shumën 51,571,090 lekë me një mosrakordim në shumën 14,938,028 lekë të të ardhurave të së njëjtës natyrë. Kontabilizimi në këtë llogari është

keqklasifikim. Ekzistenca e kësaj diference paraqet në mënyrë jo të plotë dhe të saktë strukturën e të ardhurave të realizuara gjatë periudhës ushtrimore.

- Nga auditimi i pjesës së tretë të pasqyrës së performancës “*Teprica ose deficieti i periudhës (Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor)*” konstatohet se në rezultat nuk janë marrë në konsideratë të ardhurat e transferuara në buxhet në shumën 26,956,107 lekë, të cilat duhet të përfshihen në “*Shpenzimeve të tjera*” në veprimet rregulluese për efekt të nxjerrjes së rezultatit. Ky veprim ka sjellë deformim të rezultatit, rrjedhimisht rezultati i periudhës nuk është i saktë.

- Nga auditimi i pasqyrës së investimeve dhe burimeve të investimeve konstatohet se kjo pasqyrë statistikore nuk është e plotësuar në mënyrë të saktë, për një pasqyrim të plotë të të gjitha transaksioneve që kanë ndodhur gjatë vitit lidhur me burimet e financimit dhe investimet. Konstatohet se veprimet kontabël në kredi të llogarisë 231 “*Investime në proces*” nuk rakordojnë me veprimet në debi të klasës 2 pas kapitalizimeve, me një diferencë në shumën 24,514,182 lekë. Kjo shumë nuk është kontabilizuar nëpërmjet llogarisë së investimeve por direkt në klasën 2.

- Nga auditimi konstatohet se në llogarinë 105 “*Grante të brendshme kapitale nga buxheti*” janë akorduar 204,001,812 lekë, ndërsa sipas pasqyrës së flukseve monetare “*Akordim fonde buxhetore për shpenzime kapitale (+)*” janë në shumën 427,559,455 lekë, pra me një diferencë në shumën 223,557,643 lekë. Kjo diferencë i përket fondeve të trashëguara. Akordimet e kontabilizuara janë paraqitur në shumën neto.

▪ ***Mbi realizimin e të ardhurave dhe saktësinë e kontabilizimit të tyre***

- Bashkia Bulqizë ka nivel të lartë debitorësh që në fund të vitit 2024 arrijnë në shumën progresive prej 109,425,160 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë dhe për vjeljen e detyrimeve janë nxjerrë vetëm njoftim-vlerësimi për detyrimin dhe nuk është aplikuar asnjë masë tjetër shtrënguese

- Nga shuma progresive e debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore nuk është kontabilizuar shuma prej 2,442,356 lekë.

-Në lidhje me detyrimet për taksën në infrastrukturë nga legalizimet e ndërtimeve pa leje në fund të vitit 2024 rezulton të jenë debitorë 40 persona me vlerë 940,259 lekë, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e bashkisë.

- Nga auditimi ka rezultuar se 9 subjekte ushtrojnë aktivitet të tregtimit të karburanteve nga të cilët 2 subjekte nuk janë pajisur me autorizim/licencë për të cilët nuk është marrë asnjë masë shtërnguese, ndërsa nga 7 subjektet e tjerë kanë detyrime të papaguara në shumën 5,800,000 lekë, e cila nuk është evidentuar në kontabilitet. Nga këto 7 subjekte, 3 kanë likuiduar pjesërisht detyrimet ndërsa 4 subjekte nuk kanë kryer asnjë likuidim për detyrimet e tyre.

- Nga auditimi në lidhje me arkëtimin e të ardhurave nga dhënia me qira të parcelave nga fondi pyjor/kullozor u konstatua se, në fund të vitit 2024 paraqiten debitorë 4 shoqëri qiramarrëse që nuk kanë shlyer detyrimet e kontratës në vlerën 30,038,472 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë. Detyrimi në vlerën 30,038,472 lekë nuk është kontabilizuar.

▪ ***Mbi mecurinë e zbatimit të rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm.***

- Bashkia Bulqizë nuk është respektuar afati 6 mujor i kthimit të përgjigjes për mecurinë e zbatimit të rekomandimeve. Niveli i pranimit të rekomandimeve është 100% dhe realizimi në masën 40 %.

- Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Nga 14 masa organizative të rekomanduara gjithsej, 7 janë zbatuar plotësisht, 1 është në proces zbatimi, 1 është zbatuar pjesërisht dhe 5 nuk janë zbatuar.

- Nga **1** masë e rekomanduar për arkëtimin e detyrimeve në vlerën 99,933,852 lekë për tatim taksat vendore (të ardhura të munguara) të rekomanduara, **1** masë është në proces zbatimi.
- Nga **4** masa të rekomanduara për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, me efekt mungesë të ardhurash në vlerën 42,132,697 lekë, 2 masa janë zbatuar pjesërisht, 2 masa janë pa zbatuar
- Nga **1** masë e rekomanduar për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike, 1 masë është zbatuar.
- Nga 1 masë disiplinore e rekomanduar për 3 punonjës, 3 masa nuk janë zbatuar.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore: Me qëllim zgjidhjen e problematikave janë dhënë disa rekomandime si vijon:

▪ ***Në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin.***

Strukturat përgjegjëse të Bashkisë Bulqizë të marrin masa për ngritjen dhe funksionimin e një sistemi të integruar të kontrollit të brendshëm për hartimin dhe miratimin e procedurave të shkruara për raportimin e shkeljeve të etikës dhe trajtimin e rasteve të mundshme të korrupsionit, si dhe krijimin e një mekanizmi të qartë për menaxhimin e këtyre ankesave në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale. Hartimin e një plani vjetor të rekrutimit, të bazuar në një analizë të nevojave reale të burimeve njerëzore dhe objektivave strategjike të institucionit. Vendosjen e një sistemi të brendshëm raportimi për shkeljet, që lejon identifikimin dhe reagimin në kohë ndaj çështjeve të ndjeshme.

Investime në sisteme funksionale IT që plotësojnë nevojat specifike të bashkisë dhe ndërtimin e një politike për rikuperimin dhe ruajtjen e të dhënave (data back-up), për të garantuar sigurinë dhe vazhdimësinë e funksioneve administrative dhe financiare. Përgatitjen e gjurmëve të auditimit për proceset kryesore të punës.

▪ ***Në lidhje me organizimin dhe funksionimin e auditit të brendshëm***

Në funksion të garantimit të një funksioni të pavarur dhe efektiv të auditimit të brendshëm në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, rekomandohet që Bashkia Kurbin të ndërmarrë masa përmirësuese për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit, zbatimin rigoroz të planit vjetor të auditimit dhe fokusimi në fushat me risk të lartë, dhënia e opinionit të përgjithshëm në raportet e auditimit, krijimin dhe mirëmbajtjen e dosjeve të përhershme për çdo njësi të audituar, dhe ndjekjen dhe përfundimin me sukses të procesit të certifikimit për të gjithë audituesit e Njësisë së Auditimit të Brendshëm.

▪ ***Në lidhje me raportimin financiar dhe saktësinë e pasqyrave financiare.***

- Të merren masa të menjëhershme për sistemimin e veprimeve kontabël sipas llogarive përkatëse me qëllim paraqitjen sa më të drejtë të investimeve dhe burimeve të investimeve që i përkasin njësisë për periudhën ushtrimore sipas kërkesave të teknikave kontabël.

- Të merren masat e nevojshme për kryerjen e regjistrimeve kontabël dhe rakordimit të të ardhurave me qëllim pasqyrimin sa më të saktë të tyre në pasqyrat financiare.

- Drejtoria e Financës të marrë masat për kryerjen e sistemeve dhe regjistrimeve në kontabilitet për një pasqyrim më të drejtë të fondit neto, me qëllim që të eliminohen parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

- Të merret masa për evidentimin e diferencës së konstatuar në shumën 24,514,182 lekë dhe të kryerjë sistemimet e regjistrimit në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, për një pasqyrim më të drejtë dhe të saktë të pozicionit financiar, me qëllim që të parandalohen parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare

▪ ***Në lidhje me arkëtimin e detyrimeve debitore dhe kontabilizimin e tyre***

-Të merren masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimeve tatimore për debitorët dhe në vijim të të ndiqen të gjitha rrugët ligjore në rend shterues, për arkëtimin e detyrimeve debitore në shumën 109,625,160 lekë nga subjektet e biznesit dhe taksapaguesit familjarë.

- Të merren masa për identifikimin e saktë të listave të debitorëve për taksa dhe tarifa vendore që i përkasin vlerës së pa kontabilizuar prej 2,442,356 lekë dhe të bëhet kontabilizimi i saj.

- Të kryhen veprimet për kontabilizimin detyrimeve debitore sipas listave me vlerat e taksës të llogaritur dhe të zbatohen procedurat ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit për 40 persona në shumën 940,259 lekë.

-Të merren masa për kontabilizimin e detyrimeve debitore të papaguara në vlerën 5,800,000 lekë dhe arkëtimin e tyre, nga 7 subjekte debitore që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e hidrokarbureve. Ndërsa për 2 subjekte të pa licencuara, të merren të gjitha masat shtrënguese ligjore për pajisjen e tyre me autorizim/licencë.

-Të merren masa që të kontabilizohen detyrimet nga qiradhënia në vlerën 30,038,472 lekë dhe të zbatohen të gjitha procedurat administrative e ligjore arkëtimin e tyre.

▪ ***Në lidhje me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm.***

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përshtetimin e atyre në proces zbatimi

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit.

Opinioni për auditimin financiar¹: i kualifikuar²:

Ne kemi audituar hartimin dhe konsolidimin e pasqyrave financiare të Bashkisë Bulqizë, për periudhën 01.01.2024-31.12.2024, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese si dhe të gjitha pasqyrat statistikore që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i zbatimit të parimeve kontabël si dhe i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, nga auditimi i pasqyrave financiare të subjektit Bashkia Bulqizë janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një *opinionit të kualifikuar*.

Baza për opinionin:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI. Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti dhe në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, kemi përmbushur përgjegjësitë etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 23,745 mijë lekë dhe jemi mbështetur në shpjegimet si më poshtë:

¹ - Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.

² - Referuar Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me vendimin nr. 246, datë 29.12.2022 “Për miratimin e manualit të auditimit financiar “ të Kryetarit të KLSH-së, kapitulli VII, pika 7.3.5 (faqe 54 dhe 60-61), “Një “Opinion i Kualifikuar”, jepet në rastet kur: audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë.”

-Teprica e llog. 231 “Për aktive afatgjata materiale” paraqitet në shumën 232,089,659 lekë në pasqyrën e pozicionit financiar, e cila nuk rakordon me llogaritë kundërparti të saj si: llog. 106 “Teprica e granteve kapitale të huaja” në fondin e konsoliduar, e cila paraqitet në shumën 117,223,816 lekë, dhe llogaria 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme” paraqitet në shumën 0 lekë, pra me një diferencë prej 114,865,843 lekë. Kjo diferencë është keqklasifikuar në llogarinë 101 “Teprica (fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar” në PF.

-Nga auditimi i të ardhurave konstatohet se kemi mospërputhje midis pasqyrës së performancës dhe pasqyrës së flukseve monetare. Të ardhurat jo tatimore të kontabilizuara gjatë vitit në pasqyrën e performancës janë në shumën 66,509,118, ndërsa të ardhurat tatimore në pasqyrën e rezultatit pasqyrohen në shumën 51,571,090 lekë me një mosrakovim në shumën 14,938,028 lekë të të ardhurave të së njëjtës natyrë. Kontabilizimi në këtë llogari është keqklasifikim. Ekzistenca e kësaj difference paraqet në mënyrë jo të plotë dhe të saktë strukturën e të ardhurave të realizuara gjatë periudhës ushtrimore.

-Nga auditimi i pjesës së tretë të pasqyrës së performancës “Teprica ose deficiti i periudhës (Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor)” konstatohet se në rezultat nuk janë marrë në konsideratë të ardhurat e transferuara në buxhet në shumën 26,956,107 lekë, të cilat duhet të përfshihen në “Shpenzimeve të tjera” në veprimet rregulluese për efekt të nxjerrjes së rezultatit. Ky veprim ka sjellë deformim të rezultatit, rrjedhimisht rezultati i periudhës nuk është i saktë.

-Nga auditimi i pasqyrës së investimeve dhe burimeve të investimeve konstatohet se veprimet kontabël në kredi të llogarisë 231 “Investime në proces” nuk rakordojnë me veprimet në debi të klasës 2 pas kapitalizimeve, me një diferencë në shumën 24,514,182 lekë, duke mos pasqyruar plotësisht të gjitha transaksionet që kanë ndodhur gjatë vitit Kjo shumë nuk është kontabilizuar nëpërmjet llogarisë së investimeve por direkt në klasën 2.

-Nga auditimi konstatohet se në llogarinë 105 “Grante të brendshme kapitale nga buxheti” janë akorduar 204,001,812 lekë, ndërsa sipas pasqyrës së flukseve monetare “Akordim fonde buxhetore për shpenzime kapitale (+)” janë në shumën 427,559,455 lekë, pra me një diferencë në shumën 223,557,643 lekë. Kjo diferencë i përket fondeve të trashëguara. Akordimet e kontabilizuara janë paraqitur në shumën neto.

-Nga auditimi i llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” konstatohet se nuk janë kontabilizuar detyrime në shumën 43,521,725 lekë, e cila përbëhet nga: taksat dhe tarifave vendore në shumën 2,442,356 lekë, taksa e ndikimit në infrastrukturë në shumën 940,259 lekë, tarifa e autorizim/licencës për tregtim karburantesh në shumën 5,800,000 lekë dhe tarifa e qirasë nga kontratat e qiradhënies të parcelave nga fondi pyjor/kullor në shumën 30,038,472 lekë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. prot. 465/1, datë 25.04.2025, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 29.04.2025 deri në datë 06.06.2024, në subjektin Bashkia Bulqizë për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024 u krye auditimi “Mbi auditimin financiar”, nga grupi i auditimit me përbërje:

I. Sh, përgjegjës grupi;

A. C, auditues;

V. B, auditues.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

Objekti dhe qëllimi i auditimit: Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2024, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë

raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet Bulqizëeriale në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përfundim të auditimit hartohet raporti përfundimtar i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Bulqizë.

Identifikimi i çështjes: Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Raport Përfundimtar i auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësisë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Bulqizë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Bulqizë.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese. Kryetari i Bashkisë Bulqizë (*Administratori i Përgjithshëm*), në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Bulqizë, bazuar në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3.

NA i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar aktivitetin e bashkisë.

Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të

menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.³

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH-së.

Përgjegjësitë e audituesve. Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare të Bashkisë Bulqizë dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.

Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: etika dhe pavarësia, kontrolli i cilësisë menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si përkatësia, plotësia, saktësia dhe vlerësimi, periudha, klasifikimi dhe kuptueshmëria, ligjshmëria dhe rregullësia, ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, alokimi i fondeve dhe transaksionet financiare.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Bulqizë është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, paragrafi 44-51.

Kriteret e vlerësimit. Auditimi është bazuar në Ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare

³ Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, neni 15

të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe auditit të brendshëm: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm publik”; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”; udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar; udhëzimin e MF nr.22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore”; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues”; Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 “Për miratimin e manualit të MFK”; Urdhri i Ministrit të Financave nr. 100, datë 16.10.2017 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.

- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjet vjetore të buxhetit me udhëzimet në zbatim të tyre, si dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”; Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” i ndryshuar; udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”; udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” etj.; udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar; udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”.

- Në fushën e mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare: Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar me udhëzimin e MFE nr.5 datë 21.02.2022; Udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave lokale”, i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënie e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime; udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Standardet e auditimit. ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontroleve të brendshëm”; ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit,

ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

Metodat e auditimit. Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Në gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin*⁴. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që Bulqizëerialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- *Kontrolli aritmetik.* Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).
- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.* Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.
- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.* Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.
- *Kontrolli i vlerësimit.* Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
- *Konfirmim nga të tretët.* Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

⁴ *ISSAI 1320 (ISA 320) trajton përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e Bulqizëerialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të perdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.*

- Kontrolli sipas një treguesi. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.
- Verifikimi i transaksioneve - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.
- Intervistimi - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
- Raporte dhe informacione - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.
- Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

Dokumentimi i auditimit. Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe atij të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit në terren (aktkonstatimeve), të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, si dhe pas reflektimit të observacioneve të subjektit nën auditim të aktkonstatimeve u përgatit Projektraporti i Auditimit. Me kthimin e përgjigjes nga subjekti i audituar pas shqyrtimit të projektraportit me observacione nga grupi i auditimit përgatitet Raporti Përfundimtar i Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm

Auditimi në Bashkinë Bulqizë u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar. Në këtë subjekt u evidentuan disa të meta e dobësi në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në drejtim të menaxhimit financiar, kontrollit të brendshëm, veprimtarisë së auditit të brendshëm, raportimit financiar, si dhe ndjekjes së ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin dhe realizimin e auditimit, grupi i auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave për shpenzimet dhe të

ardhurat e veta, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Sfidat me të cilat përballet: Bashkia përballet me një sërë sfidash të rëndësishme janë: Menaxhimi i mbetjeve urbane dhe sistemimi i rrjetit të kanalizimeve; Ndërhyrja në infrastrukturën e rrugëve dytësore të qytetit dhe fshatrave përreth, mirëmbajtja e institucioneve arsimore dhe shëndetësore; Mbështetja dhe nxitja më tej e turizmit, rritja e të ardhurave nëpërmjet politikave fiskale dhe menaxhimit të mirë të resurseve që ka kjo bashki; Ripërtëritja e jetës kulturore dhe artistike të zonës, por dhe zhvillimi i ambienteve dhe aktiviteteve sportive për rritjen e përfshirjes së të rinjve në jetën sociale të qytetit, etj.

Rëndësia e këtij auditimi është sepse, auditimi është pjesë jetike e një sistemi rregullator, që ka për qëllim të vlerësojë dhe evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, si edhe shfrytëzimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ky sistem bën të mundur që subjekti i audituar të ndërmarrë veprimet korrigjuese sipas rastit, të rritë përgjegjshmërinë në llogaridhënie, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara, si dhe parandalimin e shkeljeve me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve.

2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit

2.1 1. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Kuadri ligjor i veprimtarisë së Bashkisë Bulqizë si më poshtë:

-Ligji nr.10296/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar;
-Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
-Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;
-Ligji nr.7961 /1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar;
-Ligji nr.68/2017 “Për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;
-Ligji “Për menaxhimin e sistemit buxhetor të RSH”;
-VKM nr.243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar me VKM nr.746/2018;
-VKM nr. 833 datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”;
-Udhëzimi nr. 15 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”;
-Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016.

1.1 Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike, për periudhën 01.01.-31.12.2024.

Ky auditim u krye për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Bulqizë, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

I. Komponenti “Mjedisi i kontrollit”

Ky komponent përfshin integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike, politikën menaxheriale dhe stilin e punës, strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit, politikën dhe praktikën e menaxhimit të burimeve njerëzore, aftësitë profesionale të punonjësve.

Parimi 1 - Njësia Publike demonstroi angazhim për integritet dhe vlerat etike.

Nëpërmjet këtij parimi është vlerësuar angazhimi i Bashkisë Bulqizë në hartimin dhe zbatimin e elementëve dhe mekanizmave të nevojshëm për zhvillimin e integritetit dhe vlerave etike në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se Bashkia Bulqizë ka miratuar Rregulloren e Brendshme për vitin 2024, me Vendimin nr. 88, datë 30.04.2024 “Për miratimin e rregullores së organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të administratës së Bashkisë Bulqizë”.

Në Bashkinë Bulqizë është miratuar kodi i etikës profesionale me urdhrin nr.2414 datë 11.05.2023.

Rregullorja e Brendshme dhe Kodi Etik janë të afishuar në faqen zyrtare të Bashkisë.

Një problematikë e evidentuar lidhur me këtë parim është mungesa e programeve të trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatorë.

Bashkia nuk ka procedurë të shkruara për raportimin e shkeljeve të rregullave mbi etikën dhe për marrjen e masave.

-Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se për vitin 2024, Bashkia ka përcaktuar procedurë për mbrojtjen ndaj sinjalizuesve por nuk ka mekanizma të cilat i dedikohen ankesave për korrupsion. Gjithashtu konstatohet se nuk ka evidenca që të tregojnë aftësinë e njësisë publike për të kryer një hetim të brendshëm të drejtë dhe të ndershëm.

Gjatë vitit 2024 nuk janë marrë masa disiplinore:

Bashkia vlerëson performancën e personelit nëpërmjet vlerësimeve të punës të cilët përmbajnë edhe elementë të vlerësimit dhe monitorimit për zbatimin e rregullave të etikës.

Parimi 2 - Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) / Bordi apo Këshilli i drejtuesve demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet përgjegjshmëria e menaxherëve të nivelit të lartë për të ushtruar përgjegjësinë dhe mbikëqyrjen mbi performancën e njësisë publike dhe implementimin e kërkesave kryesore për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se nuk ka raporte periodike mbi monitorimin e planit të veprimit për KB.

Nga Drejtoritë dhe Sektorët janë hartuar planet mujore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit (NA) dhe Këshillit Bashkiak lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve.

Në Rregulloren e Brendshme nr. 88, datë 30.04.2024 është përcaktuar përgjegjësia menaxheriale e drejtuesve të të gjitha strukturave të bashkisë të cilët janë përgjegjës dhe raportojnë e i japin llogari, sipas shkallës hierarkike, eprorit direkt deri tek Kryetari ose tek

nëpunësit të cilëve kryetari u ka deleguar përgjegjësinë, për: Hartimin dhe monitorimin e planeve vjetore dhe periodike në përputhje me objektivat strategjike, afatmesme si dhe urdhrat dhe udhëzimet e Kryetarit, menaxhimin/administrimin e risqeve/problemeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejojnë (nëpërmjet identifikimit, vlerësimit dhe kontrollit periodik të zbatimit të masave për zvogëlimin e risqeve), informacionin në kohë dhe në formën e kërkuar për rezultatet e arritura gjatë përmbushjes së përgjegjësisë të tyre, për risqet dhe defektet serioze në veprimtarinë e strukturave që drejojnë, si dhe për masat e marra e të zbatuara për riparimin e këtyre defekteve

Konstatimi për vitin 2024

Nëpërmjet shkresës Nr. 1023 prot., datë 27.02.2025 është dërguar pranë MFE-së “Pyetësori i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm”, si dhe “Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm” dhe “Raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme të njësisë publike që mbulon”, për vitin e mëparshëm.

Për sa trajtuar më sipër konstatohet se, në formatin e këtij raporti përfshihen kapitujt/elementët e parashikuar në Udhëzimin nr. 28, datë 15.12.2011, “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”, Shtojca nr. 2, konkretisht:

- II. Vlerësimin e sistemit të MFK-së në të cilën përfshihet:
- III. Gjetjet dhe rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm
- IV. Masat e marra gjatë vitit për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësi
- V. Rekomandime të përgjithshme për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm në të cilën përfshihet:

Rekomandimet për përmirësimin e legjislacionit në fuqi në fushën e kontrollit të brendshëm, për ndjekje të mëtejshme nga njësitë qendrore të harmonizimit të Ministrisë së Financave.

Bashkia ka hartuar planin e menaxhimit të risqeve të nivelit të mesëm dhe të lartë për veprime korrigjuese/përmirësuese kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm, kjo për vitin 2024.

Titullari merr opinione për performancën e institucionit nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, dhe nga Njësia e Auditimit të Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese.

Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

Parimi 3 - Titullari / NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë

Ky parim ka në fokus strukturën organizative të njësisë (organigramën), përcaktimin e qartë të detyrave dhe përgjegjësisë funksionale të çdo niveli autoriteti si dhe nivelit të delegimit të tyre. Parimi përcakton përgjegjësinë e Titullarit / Nëpunësit Autorizues për krijimin e strukturave të përshtatshme organizative, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së njësisë publike si dhe kanalizimin e linjave të qarta të raportimit brenda dhe jashtë strukturave të njësisë.

Institucioni vepron mbi bazën e rregullore të brendshme të miratuar me Vendimin nr. 88, datë 30.04.2024 “Për miratimin e rregullores së organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të administratës së Bashkisë Bulqizë” e cila përmban përshkrimin e vendeve të punës sipas funksioneve.

Nuk është hartuar dhe miratuar në dokument të veçantë deklarata e misionit.

Për vitin 2024, me Vendimin nr. 02, datë 05.01.2024 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Bulqizë dhe Institucionet të varësisë dhe funksioneve të deleguara për vitin 2024” është miratuar struktura e përbërë nga **420** punonjës, ndër të cilat **73** nëpunës civilë dhe me kod pune 346 punonjës.

- Struktura organizative e bashkisë

Administrata e Bashkisë përbëhet nga funksionarët politikë (jo nëpunës civil), nëpunësit civilë dhe punonjësit, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen nga Kodi i Punës. Struktura është e ndërtuar sipas detyrave funksionale dhe përbëhet nga:

Funksionet politike: Kryetari; Zëvendëskryetarët; Administratorët; Kabineti. Emërimi dhe lirimi i funksionarëve politikë dhe funksionarëve të kabinetit të bashkisë bëhet me Urdhër të Kryetarit.

Nëpunësit civilë: Shërbimi Civil në bashki organizohet dhe funksionon sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, duke përcaktuar skemën e administrimit të këtij shërbimi. Pozicionet e shërbimit civil klasifikohen sipas kategorive, klasave dhe natyrës së pozicionit. Pozicionet e shërbimit civil ndahen në këto kategori:

- a. Nëpunës të nivelit të lartë drejtues: - Sekretari i Përgjithshëm.
- b. Nëpunës të nivelit të mesëm drejtues: - Drejtorë Drejtorie
- c. Nëpunës të nivelit të ulët drejtues: - Përgjegjës Sektori
- d. Nëpunës të nivelit ekzekutiv: - Specialistët.

Punonjësit, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen nga Kodi i Punës. Përfshihen të gjithë punonjësit e tjerë.

Struktura e Bashkisë Bulqizë për vitin 2024

		Nëpunës Civilë	73
Numri i të punësuarve në strukturën e miratuar	420	Nëpunës me kontratë	346
Numri i të punësuarve me kontratë provizore		-	-
Vende vakante		-	1

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore Bulqizë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Përgjatë vitit 2024 janë rekrutuar **3** punonjës të rinj. Në dosjet e personelit, nuk janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion, dhe as objektivat për secilin punonjës.

Bashkia Bulqizë ka linkun dhe faqen e saj zyrtare në internet e cila përditëson dokumentet e rëndësishme dhe informacione për njësi vendore.

Një element tjetër i rëndësishëm, i cili thekson nevojën për rritje të përgjegjshmërisë menaxheriale, është procesi i delegimit, ku konstatohet se bashkia përdor procedurat për delegimin e detyrave.

Parimi 4 -Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave

Ky parim vlerëson angazhimin e njësive publike për të tërhequr, zhvilluar dhe mbajtur personel kompetent në përputhje me objektivat e njësisë.

-Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale e cila ka mangësi në të dhënat për masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë.

- Në lidhje me rekrutimin (punësimin) e punonjësve pranë Bashkisë Bulqizë për vitin 2024.

Përgjatë vitit 2024, janë rekrutuar **3** punonjës (punonjës me Kod punë), pranë Bashkisë Bulqizë. Procedurat e rekrutimit bëhen sipas nevojave që dalin gjatë vitit, pavarësisht se nuk ka një plan vjetor rekrutimi.

Përsa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, DMBNJ mban regjistrin e trajnimeve që kryejnë punonjësit, por nuk ka një plan të miratuar për nevojat e punonjësve për trajnim.

Nga drejtoria juridike dhe e burimeve njerëzore nuk është hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime nga menaxheret e programeve për Shkollën Shqiptare të Administratës Publike.

Nga vetë bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.

Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk është krijuar, në mospërputhje me përcaktimet e bëra në nenin 12, 13 të Ligjit 114/2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” i ndryshuar dhe VKM nr. 160, datë 02.03.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit”.

Parimi 5 -Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale

Njësia publike duhet të ketë një mekanizëm të dokumentuar për të mbajtur një personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësisë dhe objektivave që lidhen me kontrollin e brendshëm.

Nga auditimi i kryer rezulton se bashkia ka të përcaktuara përgjegjësitë dhe përgjegjshmërinë menaxheriale në dokumentin e rregullores së brendshme. Njësia publike ka hartuar plane vjetore pune për të gjitha drejtoritë dhe nuk ka autorizime për delegimin e detyrave.

Një faktor tjetër i rëndësishëm, i cili ndikon në efektivitetin e përcaktimit të përgjegjshmërisë menaxheriale, është edhe përfaqësimi i rregullt në Grupin e Menaxhimit Strategjik, me qëllim diskutimin e çështjeve që lidhen me kontrollin e brendshëm dhe adresimin e mangësive kryesore të konstatuara.

Për vitin 2024, me shkresën nr. 3099 prot., datë 27.02.2024, Titullari i Bashkisë ka nxjerrë Urdhrin nr. 272 datë 17.01.2024 “*Menaxhimi dhe koordinimin e riskut në Bashkinë Bulqizë*” Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se takimet e GMS, dokumentohen me procesverbale. Vlen të theksojmë se GMS luan një rol kyç për sa i takon integritetin të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike.

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”, për periudhën 2023-2024.

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

Parimi 6 – Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva

Ky parim paraqet një pamje të elementëve bazë të nevojshëm për zhvillimin e procesit të menaxhimit të riskut. Përcaktimi i objektivave të njësisë publike është formimi i bazës mbi të cilën zbatohet vlerësimi i riskut dhe krijohen aktivitetet pasuese të kontrollit. Titullarët / NA / Menaxherët përcaktojnë objektivat dhe i grupojnë ato në kategori më gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e njësisë, në lidhje me aktivitete, raportimet dhe pajtueshmërinë.

Nga auditimi i kryer konstatohet se, Bashkia ka përgatitur Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA), në të cilin evidentohen objektivat dhe prioritetet e institucionit, së bashku me programet që këto objektiva i përkasin.

Bashkia ka hartuar plan-veprime operationale të miratuara për arritjen e qëllimeve të politikave afatmesme (PBA), por objektivat e parashikuara në buxhetin vjetor kane si baze PBA-në. Rezulton se objektivat e miratuara i komunikohen stafit të bashkisë nëpërmjet emailit apo shkresave zyrtare.

Në planin vjetor të punës çdo njësi publike do të zhvillojë objektivat dhe aktivitetet të cilat duhet të kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike për të cilat ata janë përgjegjës.

Parimi 7 – Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave

Megjithëse analiza e riskut mund të fillojë nga niveli i lartë menaxherial ose në një funksion operativ, çelësi është ekzistenca e një procesi të përgjithshëm për të përcaktuar se si identifikohen dhe menaxhohen risqet në të gjithë njësinë publike.

Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi rezulton se njësia publike ka krijuar mekanizma të organizuar dhe funksionalë të procesit të menaxhimit të riskut.

Janë identifikuar dhe vlerësuar risqet përmes një procesi të strukturuar dhe sistematik që përfshin vlerësimin e rëndësisë potenciale dhe priorizimin e risqeve të përputhshmërisë.

Parimi 8 – Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve

Mashtrimi ekziston (ose mund të ndodhë) në shumicën e njësive publike. Ekzistenca e një risku të tillë të rëndësishëm ka bërë që formati i përditësuar i pyetësorit të vetëvlerësimit dhe regjistrit të riskut të përfshijë vlerësimin e riskut të mashtrimit duke theksuar se duhet të merret parasysh për çdo objektiv.

Nga auditimi i kryer konstatohet se bashkia nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi.

Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues.

Parimi 9- Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme

Ndryshimi është i vazhdueshëm në të gjitha njësitë publike. Ato duhet të kenë një proces formal për të identifikuar ndryshimet e rëndësishme, të brendshme dhe të jashtme, si dhe të vlerësojnë risqet dhe qasjet për të minimizuar riskun në kohë.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se ka sistem të Kontrollit të Brendshëm.

III. Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”, për periudhën 2023-2024.

Veprimtaritë e Kontrollit përfshijnë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut. Aktivitetet e kontrollit duhet të integrohen tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen. Futja e aktiviteteve të kontrollit në një fazë të mëvonshme është më e kushtueshme dhe më pak efikase.

Parimi 10 – Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit.

Nuk ka "zgjedhje ideale" në zgjedhjen e aktiviteteve të duhura të kontrollit. Përkundrazi, aktivitetet e kontrollit, ose një kombinim i aktiviteteve të kontrollit (politikat, procedurat dhe përgjegjësitë) duhet të zgjidhen për të zvogëluar në mënyrë të mjaftueshme riskun e mosrealizimit të objektivave në një nivel të pranueshëm. As menaxhimi dhe as auditimi i brendshëm nuk duhet të fillojnë një analizë të aktiviteteve të kontrollit me një listë të kontrolleve dhe të identifikojnë nëse janë të pranishëm apo jo. Përkundrazi, kontrollet duhet të vlerësohen në raport me risqet që duhet të minimizohen.

Në vijim të auditimit të kryer, konstatohet mungesa e hartave apo manualeve të proceseve të punës që sjellin si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësiive. Vlen të theksojmë se përgatitja e një harte me proceset e punës garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të tij.

Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ sipas sistemit të dy firmave, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

Listë prezencat plotësohen nga përgjegjësi i sektorit përkatës dhe listë pagesa përpilohet nga specialisti i pagave, të dhënat hidhen çdo muaj në librin e pagave.

Në zbatim të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, bashkia ka hartuar procedurat për organizimin e prokurimeve. Komisionet propozohen nga drejtorët e drejtorive sipas natyrës së objektit të prokurimit (punë, mall, shërbim etj.)

Në zbatim të Udhëzimit nr. 01 datë 05.01.2018 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të PP... dhe krijimi i tyre në sistemin e PP” është hartuar dhe miratuar regjistri i prokurimeve. Ky regjistër është publikuar në faqen e APP dhe përditësohet sa herë ka ndryshime.

Për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por vepohet në bazë të legjislacionit për arkivat. Aktualisht punohet me sistemin online AMFIS i përdorur për pagesat i cili ruan në sistem praktikat e pagesave të kryera me Degën e Thesarit dhe në Bankën e Shqipërisë.

Parimi 11 - Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë

Teknologjia është bërë një element kyç operacional i pothuajse çdo organizate. Megjithatë, ekzistojnë kërcënime për objektivat organizative nëpërmjet depërtimit të jashtëm të rrjetit, mungesës së kujdesit në testimin e softuerit ose thjesht proceseve të dobëta të sigurisë. Çdo organizatë duhet të identifikojë kontrollet e përgjithshme dhe efektivitetin e tyre për të zbutur këto kërcënime të rëndësishme.

Bashkia nuk ka sisteme funksionale të IT-së të ndryshme nga ato fikse (pra përveç sistemeve qeveritare si APP, SIFQ, etj.) dhe nuk ka një procedurë të rikuperimit dhe të ruajtjes, back-up-it. Ndarja e detyrave në funksionimin e sistemeve të IT- së bëhet duke hapur llogari personale për të gjithë punonjësit sipas funksionit që kanë në çdo proces. *Bashkia nuk ka plan për menaxhimin e riskut IT për rikuperimin e të dhënave në rast fatkeqësie natyrore, për vitin vitin 2024.*

Parimi 12 – Njësia Publike vendos aktivitete kontrollit përmes politikave dhe procedurave.

Përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit duhet të identifikohen dhe komunikohen përmes politikave dhe procedurave të ndryshme. Proceset duhet të jenë në vend për të siguruar që të gjitha aspektet zbatohen dhe funksionojnë.

Bashkia ka procedura të shkruara dhe politika të brendshme për ndarjen e përgjegjësiave për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj në mënyrë të tillë që i njëjti person të mos kryejë detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar. *Ka plan-veprime të ndryshme operative dhe të menaxhimit të riskut për aktivitetin e kontrollit, 2024.*

Gjurma e auditimit.

Gjurma e auditimit përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësive publike dokumentohen në atë formë.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se, bashkia nuk ka ndërtuar gjurmë auditimi për proceset kryesore të punës. Gjurmët e auditimit duhet të përgatiten nga menaxherët për proceset kryesore të punës së njësive dhe është përgjegjësi e NA të njësive të sigurojë titullarin se këto procese janë identifikuar dhe janë përgatitur gjurmët e auditimit për to.

IV. Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”, për periudhën 2023-2024.

Informimi dhe komunikimi përfshin identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë

të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.

Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv. Informacioni është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen efektive të detyrave të ngarkuara.

Rëndësia e kanaleve të informacionit dhe komunikimit me të cilat informacionet transferohen mund të shihet drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes. Cilësia e një vendimi të marrë është e kushtëzuar nga cilësia e informacionit në drejtim të kohës, përshtatshmërisë, saktësisë dhe disponueshmërinë.

Parimi 13 - Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor.

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet nëse njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion të rëndësishëm, cilësor për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Në vijim të auditimit, konstatohet se bashkia nuk i kushton rëndësinë e duhur përcjelljes së informacionit dhe raportimit.

Bashkia ka një sistem komunikimi dhe raportimi, si brenda dhe jashtë institucionit por *ky sistem i raportimit nuk jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj, kjo për të dy vitet objekt auditimi 2023-2024..*

Procesi i komunikimit dhe informimit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit. Punonjësit kanë akses në përdorimin e postës elektronike me qëllim transmetimin e informacionit në kohë më të shkurtër.

Nuk ka sistem për kontabilizimin e të dhënave në bashki.

Parimi 14 - Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm

Njësia publike komunikon në mënyrë të brendshme informacionin, duke përfshirë objektivat dhe përgjegjësitë, të nevojshëm për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Përsa i përket krijimit dhe përdorimit të linjave të brendshme të komunikimit, nëpunësit e bashkisë sqarojnë se janë hartuar procedura të shkruara për të siguruar që menaxherët dhe personeli i bashkisë të informohen mbi që të gjitha vendimet, projektet, procesverbalet e mbledhjeve dhe nismat e tjera të bashkisë, në bazë të vendimit nr. 40 datë 30.04.2024, Programi i Transparencës.

Bashkia përgatit raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e njësive në lidhje me shërbimet publike.

Në faqen zyrtare të institucionit pasqyrohen vendimet dhe projektet e bashkisë. Drejtuesit e institucionit njoftohen nëpërmjet shkresave apo në rrugë elektronike sa herë që ka alokime fondesh.

Parimi 15 - Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohen procedurat e komunikimit të njësive publike me palët e treta lidhur me çështjet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Bashkia është në marrëdhënie ndërvepruese të përditshme, duke përcjellë informacione të ndryshme në rrugë zyrtare, në format shkresore dhe **evidentohet që punonjësit përdorin adresat zyrtare të e-mailit**. Bashkia siguron qasje publike nëpërmjet publikimit faqes së internetit të njësive të informacionit lidhur me: Dokumentin e Buxhetit vjetor të propozuar; Buxhetin e miratuar të bashkisë; Raporte periodike të zbatimit të buxhetit; Pasqyrat vjetore financiare të dhe të buxhetit; Planet vjetore të prokurimit, proceset e hapura të prokurimit, kontratat e lidhura, statistika mbi prokurimet; Raporti i auditimit të jashtëm për njësinë mbi pasqyrat financiare dhe aktivitetin e vitit paraardhës.

Institucioni realizon konsultime publike me qytetarët dhe grupet e interesit për çështje që lidhen me përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Çdo sugjerim nga aktorët kryesor diskutohet për të reflektuar ndryshimet e duhura në buxhet.

V. Komponenti: “Monitorimi” për periudhën 2023-2024.

Monitorimi realizohet përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm.

Parimi 16 - Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe / ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Procesi i monitorimit duhet të përfshijë vlerësimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kohë dhe me kosto efektive. Vlerësime të herëpashershme të këtyre sistemeve duhet të kryhen sipas nevojës.

Nga auditimi i kryer, konstatohet se institucioni ka përcaktuar në rregulloren e brendshme rregullat bazë për raportimin e ecurisë dhe statusit të implementimit të objektivave, ndërkohë që ende nuk janë hartuar manualet e proceseve të punës, ku të jenë përcaktuar të gjithë proceset e detajuara në afate kohore dhe për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre.

Progresi lidhur me arritjen e objektivave dhe analizimi i shkaqeve për dështimet e mundshme monitorohet nëpërmjet raportimeve periodike. Institucioni ka një plan veprimi të menaxhimit financiar dhe kontrollit të miratuar për monitorimin e MFK-së.

Bashkia Bulqizë, monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar me shkresën nr. 2806 prot., datë 19.02.2025 në Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë MFE-së.

Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, realizohet nëpërmjet shërbimit të Auditimit të Brendshëm.

-Bashkia Bulqizë ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila kontrollon performancën e sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi.

NJAB ka hartuar planin strategjik, të miratuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresën nr. 11273/1 datë 13.10.2023, të auditit të brendshëm, raportin vjetor dhe raportet e auditimit për çdo auditim të kryer përgjatë vitit 2023 dhe me shkresën nr. 11273/1 datë 13.10.2023, të auditit të brendshëm, raportin vjetor dhe raportet e auditimit për çdo auditim të kryer përgjatë vitit 2024.

Parimi 17 - Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë.

Kur identifikohen mangësitë e kontrollit të brendshëm, titullari i njësisë publike duhet të ndërmarrë veprimet korrigjuese dhe t'i komunikojë ato në nivelin e duhur dhe në kohën e duhur. Mangësitë mund të identifikohen në nivelin e komponentit ose në procesin e kontrollit të brendshëm në tërësi.

Në bazë të auditimit të kryer, titullari i institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH ka ndërmarrë masa korrigjuese, për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu II, neni 16, pika 2, Kreu III, neni 22, pika 1;

-Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 5.2.7 “Monitorimi dhe Raportimi”;

-“Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.3, Kapitulli V, Aneksat.

Sa më sipër arrihet në konkluzion se:

Përsa i përket sistemit të MFK: Bashkia nuk ka një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. Festime Mjeshtri në cilësinë e kryetarit të Bashkisë, z. R. B. në cilësinë e Drejtorit të Financës, z.K. K. në cilësinë e Drejtorit të Burimeve Njerëzore, z.H. P. në cilësinë e N/Kryetarit të Bashkisë.

2.1.2 Organizimi, përbërja dhe funksionimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2024.

Dokumentacioni që u analizua për të vlerësuar veprimtarinë e njesisë së auditit të brendshëm është si vijon:

- Karta e Auditimit të Njesisë AB të Bashkisë Bulqizë;
- Plani Strategjik dhe vjetor, si dhe pasqyrat shoqëruese;
- Programimi i auditimeve për vitin 2024;
- Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm;
- Dosjet e përhershme të subjekteve të audituara;
- Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditit të Brendshëm, dhe ngritja e nivelit profesional të tyre.
- Vlerësimi i auditimeve.

Në zbatim të Ligjit nr.114/2015, datë 20.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, neni 10, pika 1, ku në mënyrë eksplicite përcaktohet se:

“Të gjitha njësitë publike, të përfshira në nenin 3, të këtij ligji, duhet të marrin masa për krijimin e shërbimit të auditimit të brendshëm, sipas formave të përcaktuara në gerrat a-c të kësaj pike”, është ngritur dhe funksionon Sektori i Auditit të Brendshëm në varësi funksionale nga Titullari i Bashkisë Bulqizë, duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardi Atributiv nr.1100 i Institutit Ndërkombëtar të Auditëve të Brendshëm.

Nga auditimi i kryer mbi funksionimin e NJAB të Bashkia Bulqizë, rezultoi se :

➤ **Organizimi dhe Funksionimi** : Bazuar në VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e NJAB në sektorin publik” Bashkia Bulqizë ka ngritur NJAB. Për vitin 2024 NJAB ka funksionuar me 3 auditues sipas strukturës organizative të përcaktuar nga Titullari i Bashkisë me vendim nr. 02/1 datë 05.01.2024 “Për miratimin e strukturës , organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës me emrat përkatës të bashkisë Bulqizë , Institucioneve në varësi dhe njësive Administrative për vitin 2024”.

➤ **Konkluzion:** Për vitin 2024 Njësia e Auditit të Brendshëm ka funksionuar me 3 (auditues), pasi në strukturën e miratuar me VKB nr.02/1 prot , datë 05.01.2024 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës me emrat përkatës të Bashkisë Bulqizë, institucioneve në varësi dhe njësive administrative për vitin 2024” në të cilën është përcaktuar 1 përgjegjës i Sektorit të Auditit dhe 2 specialist të auditimit të brendshëm.

Detyrat dhe kompetencat e NJAB janë përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Bulqizë të miratuar me VKB nr.88 datë 30.04.2024 “Për organizimin , funksionimin ,detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Bulqizë”.

Struktura e NJAB, niveli i arsimit, certifikimi, përvoja dhe trajnimet e audituesve paraqiten sipas tabelës se mëposhtme:

Nr	Periudha 2024	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi në pune	Vjetërsi në auditim/vite	Certifikimi	Trajnime të vijueshme
1	B. T.	Përgjegjës sektori	Finance Kontabilitet	6	6	Cert.2023	Po
2	A. J.	Auditues	Drejtuës Finance	15	8	Cert 2021	Po
3	E. B.	Auditues	Financë Bankë	4	1	Jo	Jo

Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes të punonjësit të strukturës së Auditit të Brendshëm rezulton se dy punonjësit janë certifikuar dhe ka ndjekur trajnime për vitin 2024 vetëm përgjegjësja e sektorit, “trajnime për kualifikimin profesional”, në përputhje me kërkesat e

ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015 ”Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar nenet 11, “Punësimi i Audituesit të Brendshëm” neni 19 “Certifikimi i audituesve të brendshëm” dhe neni 20 “Trajnimi i vijueshëm profesional i audituesve të brendshëm”.

- **Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik**

NJAB në mbështetje të Urdhrit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrisë së Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar ka hartuar “Kartën e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” në Bashkinë Bulqizë, e cila është miratuar nga titullari me urdhrin nr.3866, datë 18.18.2021.

- **Planet Strategjike dhe Vjetore:**

Në mbështetje të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik janë hartuar dhe miratuar planet strategjike sipas viteve:

Per vitin 2024 me shkresën nr.5195, datë 19.10.2023 është miratuar plani strategjik për vitet 2024 – 2026 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2024.

Këto plane janë dërguar zyrtarisht (por edhe me postë elektronike) në Drejtorinë e të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në përputhje me Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, si dhe urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar ,me shkresën nr.5195prot,datë 18.10.2023.

Njësia e AB në Bashkinë Bulqizë mbulon me auditim 10 drejtori dhe 5 sektorë të Bashkisë Bulqizë, Këshilli Bashkiak Bulqizë, 7 njësi Administrative dhe “Sport Klub Bulqiza Shpk” me ortak të vetëm Bashkia Bulqizë. NJAB në hartimin e këtyre planeve është fokusuar në prioritetin e risqeve të identifikuar, dhe ka marrë në konsideratë respektimin e frekuencës së kryerjes së auditimeve.

- **Realizimi i Planeve Vjetore:**

- **Për vitin 2024 nga NJAB** në Bashkinë Bulqizë për vitin 2024, planifikoi në total 9 misione auditimi të cilat janë realizuar 8 misione auditimi me një realizim në masën 90%. NJAB Bulqizë ka realizuar 8 misionet e auditimit të planifikuar dhe të kërkuara nga titullari dhe institucione të tjera shtetërore, nga të cilat 1 auditim i kombinuar,3 auditime përputhshmërie, 3 auditime financiare dhe kontrolli i zbatimit të rekomandimeve. Realizimi e auditimeve paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT						
		Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga të realizuarat, sipas llojit				
				Përputhshmëri	Financiar	Kombinuar	Performancë	Tjera
4	Viti 2024	9	8	3	3	1		1

Raportimi : Për veprimtarinë e NJAB Në Bashkinë Bulqizë për periudhën objekt auditimi, është raportuar në mënyrë sistematike. Janë hartuar dhe dërguar në NJQHAB të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë raportet periodike vjetore të shoqëruara këto me evidencat e raportimit në mënyrë progresive dhe vlerësimin përmbyllës për veprimtarinë e NJAB, përkatësisht:Me shkresën nr.569 prot, datë 12.02.2025, është dërguar Raporti Vjetor i Veprimtarisë së NJAB, Bashkia Bulqizë për vitin 2024. Të dhënat për realizimet e angazhimeve nga AB për auditimet e kryera paraqiten në tabelat e mëposhtme:

Nr	Subjektet e Audituar	Realizimi i angazhimeve të auditimit									
		Auditime të realizuara sipas llojit të tyre							Statusi i Angazhimit		
		Gjithsej	Shërbime të Sigurisë nga të cilat:					Shërbime Këshilli	Angazhime me kërkesë të titullari	Angazhime të përfunduara	Angazhime në proces
			A. të përputhshëm	A. të performancë	A. financiare	A. tek. Informacionit	A. të kombinuara				
1	Sport Klub Bulqiza Sh.p.k	1			1						
2	Drejtoaria e Taksave dhe Tarifave Vendore	1	1								
3	Dr. Menaxh Burimeve Njerzore dhe Juridike	1				1					
4	Drejtoaria e Finances	1			1						
5	Dr. Sherb. Publike, Mirmbatjes se Rrugeve Rurale e Mjeteve të Transportit	1			1						
6	Njësia Administrative Gjoricë	1	1								
7	Dr. Arsimit, Trashëg kultur, Rinis e Sporte	1	1								
8	Kontrolli i zbatimit të rekomandimeve	1					1				
		8	3		3		1	1			

➤ Gjetje-Rekomandimet

Një aspekt mjaft i rëndësishëm i aktivitetit auditues është dhënia e rekomandimeve në përfundim të auditimeve, ku:

Për vitin 2024 Nga auditimet janë evidentuar 37 gjetje, për të cilat janë dhënë 39 rekomandime gjithsej, nga këta 16 rekomandime për përmirësim të sistemeve, 13 rekomandime për përmirësim të kuadrit nënligjor të institucionit, 7 rekomandime të karakterit organizativ dhe 3 rekomandime për arkëtim, të cilat në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim demi)			
		Gjithsej në numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar	Gjithsej në numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar
8	Viti 2024	39	7	23	9				
TOTALI		39	7	23	9				

Të dhënat e gjetjeve sipas fushave të auditimit dhe subjekteve të auditimit paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	SUBJEKTI AUDITUAR	GJETJET SIPAS FUSHËS OSE SISTEMEVE në NUMER									
		Sistemi i prokurimeve, blerjeve	Sistemi i pagesave, trajtimeve, shërbimeve	Fondet e sig. Shoq, sig.shendetesore,	Sistemet e tatimeve, taksave, doganave	Sistemet e administrimit	Sistemet e privatizimit, shitjes, qiradhënies	Sistemet e koncesioneve, ankandave	Sistemet e legalizimeve, urbanistikës, kthim pronash	Sistemet e kreditimit,	Të tjera
1	Sport Klub Bulqiza Sh.p.k	1	2								2
2	Drejtoaria e Taksave dhe Tarifave Vendore				4						2
3	Dr. Menaxh Burimeve Njerzore dhe Juridike	4									5
4	Drejtoaria e Finances										6
5	Dr. Sherb. Publike, Mirmbatj Rruge Rurale e Mjete të Transportit										6
6	Njësia Administrative Gjoricë										2
7	Dr. Arsimit, Trashëg kultur, Rinis e Sporte										3
8	Kontrolli i zbatimit të rekomandimeve										
	Totali	5	2		4						26

Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve për periudhën audituese është bërë sipas përcaktimeve të manualit të A.B. NJAB u ka dërguar shkresa njëjësive të audituara për informim mbi nivelin e zbatimit të tyre dhe në auditimin e radhës është çështja e zbatimit të rekomandimeve trajtohet si çështje kryesore. Rekomandimet sipas llojit dhe statusit të realizimit në subjektet e audituara, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	Subjekti Audituar	Rek. të dhëna në vitin 2024	STATUSI I REKOMANDIMEVE				REKOMANDIMET SIPAS LLOJIT				
			Rekomandim i dhënë	Rekomandim i pranuar	Rekomandim i zbatuar	Në proces zbatimi	Rekomandime të përmirësimit të sistemeve	Rekomandime të përmirësimit të kuadrit	Rekomandime të karakterit organizativ	Rekomandime për arkëtime	Rekomandime të tjera
1.	Sport Klub Bulqiza Sh.p.k	6	6	6	5	1					
2.	Drejtoiria e Taksave dhe Tarifave Vendore	5	5	5	2	2					
3	Dr. Menaxh Burimeve Njerzore dhe Juridike	11	11	11	2	7					
4	Drejtoiria e Finances	7	7	7	2	3					
5	Dr. Sherb. Publike, Mirmbajt Rruge Rurale e Mjete të Transportit	6	6	6	1	4					
6	Njësia Administrative Gjoricë	2	2	2	2						
7	Dr. Arsimit, Trashëg kultur, Rinis e Sporte	3	3	3	2						
8	Kontrolli i zbatimit të rekomandimeve										

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve, rezultojnë se nga 39 masa të rekomanduara, janë pranuar 39 rekomandime, nga këto 12 rekomandime janë zbatuar, 18 rekomandime janë proces zbatimi, dhe 9 rekomandime nuk janë zbatuar.

Konstatim: Për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2024, nuk janë audituar aktivitete që kryen Bashkia Bulqizë, si Drejtoiria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit si dhe Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit pika 3.1.3 ku citohet:

“Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit”

Komiteti i Auditimit të Brendshëm

Komiteti i Auditimit të Brendshëm, si organ i pavarur që duhet të monitorojë, ofrojë këshilla dhe rekomandime objektive për titullarin e njësisë publike lidhur me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe të mbështesë njësinë e auditimit të brendshëm në përmbushjen e përgjegjësisë së saj, nuk është krijuar nga Bashkia Bulqizë.

Nga kontrolli i dokumentacionit rezultojnë se nuk ka Urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me dispozitat ligjore të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, neni 12, pika b, i cili përcakton se titullari i njësisë publike është përgjegjës për: **“Krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitet publike përkatëse sipas kritereve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas shkronjës “b” të nenit 23 të këtij ligji”.**

Konstatim: Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk është krijuar, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 12, 13 të ligjit 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik” i ndryshuar dhe VKM nr. 160 datë 02.03.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit”.

• Planifikimi/ndryshimet dhe miratimi i programeve vjetore dhe strategjike të auditimeve.

Në Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, pika 3.3, kapitulli, III miratuar me Urdhrin e Ministrit të MFE Nr.100, datë 25.10.2016, përcaktohet se:

“Plani Strategjik dhe Plani Vjetor i përgatitur nga njësitet e AB para se të dërgohet për miratim tek titullari i njësisë publike duhet të dërgohet për mendim tek Komiteti i Auditimit të Brendshëm deri me datën 30 Shtator të çdo viti, i cili e shqyrton dhe jep mendim deri me datën 10 tetor të çdo viti. Planet pas dhënies së mendimit të KAB-së, miratohen nga titullari i

institucionit dhe ato dërgohen jo më vonë se data 20 tetor e çdo viti, në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm....”

Plani strategjik është një dokument që përgatitet nga Njësia e Auditimit të Brendshëm mbi bazën e vlerësimit të riskut të njësisë publik edhe përfaqëson veprimtarinë audituese për një periudhë 3 vjeçare. Plani vjetor i auditimit hartohet vetëm pasi të jetë përfunduar plani strategjik i Auditimit të Brendshëm.

Në mbështetje të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik është hartuar dhe miratuar Plani Strategjik për **periudhën 2024-2026** nga titullari i bashkisë me shkresën nr.5195 prot., datë 10.10.2023.

Plani Strategjik dhe Plani Vjetor janë përcjellë zyrtarisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 5195 prot., datë 18.10.2023, në përputhje me Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.

- **Auditimi i dosjeve të auditimit kryer nga DAB**

Grupi auditimit duke patur në fokus gjetjet e konstatuara në subjektet e audituara në periudhën objekt auditimi 2024, zgjodhi të auditojë dosjet si me poshtë:

Gjetjet kryesore të Auditit të brendshëm:

1.Drejtoria e menaxhimit të burimeve njerëzore

Gjatë vitit 2023 janë përgatitur planet mujore dhe të miratohen vjetore ku të jenë përcaktuar qartë detyrat dhe objektivat

Nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore për vitin 2023 nuk është mbajtur një regjistër për trajnimet që kryejnë punonjësit sipas ftesave që vijnë nga institucione apo shoqata të ndryshme. Nga auditimi u konstatua që nuk ka një sistem vjetor të përgatitjes së nevojave për trajnim, dhe nuk ka procedura të standardizuara për këtë proces

Në zbatim Ligjit Nr.10 296, datë 08.07.2010 Për Menaxhimin Financiar dhe që ka për qëllim përdorimi sa më eficient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangia e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë, si dhe udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Brendshëm Financiar Publik pika 2.3.1 që MFK duhet të trajtojë zgjidhjen e çështjeve në kuadër të zhvillimit të sistemit të gjetjeve dhe Rekomandimeve të Auditit të Brendshëm.

U konstatua që nuk është zhvilluar një regjistër i risqeve të mundshme që mund të pengojnë arritjen e objektivave dhe si rrjedhim as një strategji në formë të shkruar për eliminimin e tyre. Nga auditimi u konstatua gjithashtu që nuk ka një hartë të proceseve kryesore që kryhen nga punonjësit e kësaj drejtorie sipas Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Mungese e specialisteve në disa sektorë.

1.b.Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit

Në dokumentin e Buxhetit 2023, u konstatua që plani i të ardhurave është i paraqitur me zëra të taksave dhe tarifave sipas paketës fiskale, por parashikimi i të ardhurave është bërë duke u bazuar në vitet paraardhëse dhe jo mbështetur në bazën e taksueshme dhe tarifave përkatëse, duke sjellë një parashikim jo shumë të saktë.

2.Sistemi i Pagesave

Nuk jam konstatuar probleme në sistemin e pagesave Nga testimi i pagave janë respektuar struktura dhe niveli i pagave dhe nuk ka tejkallim si në numrin e punonjësve ashtu edhe në fondin e pagave të miratuar nga Këshilli i Bashkisë.

3.Sistemi i prokurimeve.

Nga Sektori Juridik dhe e Prokurimeve Publike nuk është hartuar Gjurma e detajuar e auditit për Prokurimet me vlerë më të madhe se 1,000,000 lekë dhe më të vogël se 1,000,000 në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin neni 10.

Në përcaktimet dhe miratimet e kriterëve të veçanta të kualifikimit si dhe në dokumentet e kërkuara për të vërtetuar realizimin e kriterëve, nuk ka argumentim me hollësi mbi domosdoshmërinë e tyre, mangësi që u konstatuan në 5 procedura nga 7 të audituarat. Kriteret e përdorura për identifikimin e ofertës ekonomikisht më të favorshme, nuk i plotësojnë kushtet e nenit 46, pika 1, e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, për arsye se nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, nuk janë objektive, përpjesëtimore me kontratën objekt prokurimi kërkesa të tilla kanë çuar në rritjen e kostos së punëve, duke paguar më shumë për diferencat në kualifikimin e ofertuesve, pa arritur efektivitet ekonomik në realizimin e prokurimit.

Nga auditimi i dosjeve të procedurave, u konstatua që Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka skualifikuar operatorë që kanë ofruar çmim më të ulët, për mosplotësim të disa kriterëve të veçanta në 5 raste të procedurave të audituara, duke sjellë rritjen e kostove të punëve për Bashkinë Bulqizë pasi janë kualifikuar operatorët me oferta më të larta pa arritur efektivitet ekonomik në realizimin e prokurimit. KVO nuk ka zbatuar pikën 4, të nenit 53 "Shqyrtimi i ofertave të LPP ku përcaktohet: Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentat e tenderit apo gabime që mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.

Nga grupi i AB u konstatua që sektori juridik ka nje performance të dobët në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të Bashkisë në veprimet gjyqësore dhe interesave të Bashkisë

Në zbatim Ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 Për Menaxhimin Financiar dhe që ka për qëllim përdorimi sa më eficient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike, dake respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë si dhe shmangia e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes se pasurisë, si dhe udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016 të Drejtorise të Harmonizimit të Brendshem Financiar Publik pika 2.3.1.

4. Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar.

Sistemi i ruajtjes dhe menaxhimit të aseteve ka probleme dhe konstatua që nuk janë ndjekur procedurat sipas ligjit por vlerësimin e aktiveve the sipas rastit nxjerrjes së tyre jashte përdorimit.

Vlerësimi i sistemeve të kontrollit

Në programet vjetore të punës në disa drejtori, konstatohet që përcaktimi i objektivave nuk është bere shume i qartë, në vazhdim të kësaj nuk janë përcaktuar risqet që mund të pengojnë se arritjen e objektivave.

Mungojnë planet periodike, me objektiva, aktivitete të përcaktuara qartë me afate dhe persona përgjegjës. U gjetën probleme me njohjen dhe zbatimin e Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollim në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, por edhe në Drejtoritë brenda Bashkisë Bulqizë.

Rekomandime për veprim

NJAB Bulqizë, pas konstatimeve të gjetjeve të auditimit në fushat e audituara ka propozuar 39 rekomandime gjithsej nga këta 16 rekomandime për përmirësim të sistemeve, 13 rekomandim për përmirësim të kuadrit nënligjor të institucionit 7 rekomandime të karakterit organizativ dhe 3 rekomandime për arkëtim (të detajuara në pasqyrën bashkëngjitur. Përgjigja dhe reagimet e menaxhimit

Nga rekomandimet e dhëna nga ana e grupit të auditimit, nga ana e menaxhimit janë pranuar plotësisht, ndërkohë janë në proces zbatimi.

Gjetjet kryesore nga auditimi i jashtëm (KLSH) për sistemin e KB
Bashkia Bulqizë të marrë masa për ngritje një strategjie risqeve dhe përcaktimin e koordinatorit të riskut.

Konstatim:

-Në çdo raport auditimi, audituesit nuk kanë dhënë asnjë opinion të përgjithshëm mbi të gjitha sistemet e audituara, nëse këto sisteme funksionojnë në nivelin e duhur nga të gjitha strukturat apo punonjësit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve, si tek përmbledhja ekzekutive (e cila paraqet vetëm gjetjet dhe rekomandimet përkatëse pas sistemeve të vlerësuara) dhe në vijim pas çdo sistemi apo fushe të audituar;

-Raportet e Auditimit nuk kanë në përmbledhjen ekzekutive të përfshirë një përshkrim të shkurtër të subjektit sipas kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, kapitulli IV, pika 4.1.12;

• **Sigurimi i cilësisë së punës të auditimit të brendshëm.**

Programi i sigurimit të cilësisë është projektuar për të mundësuar vlerësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm me qëllimin e krijimit të shërbimit të auditimit të brendshëm, si dhe për të vlerësuar nëse audituesit e brendshëm e zbatojnë Kodin e Etikës dhe Standardet. Programi i sigurimit të cilësisë, vlerëson efikasitetin, efektivitetin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, si dhe identifikon mundësitë për përmirësim.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Bulqizë nuk ka hartuar “*Programin për sigurimin e brendshëm të cilësisë të drejtorisë së auditimit të brendshëm*”.

Është hartuar rregullore për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e kofidencialitetit në Bashkinë Bulqizë në përputhje me Ligjin nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit” e cila është miratuar nga titullari i bashkisë me shkresën nr. 277 prot., datë 17.01.2024.

• **Dosja e përhershme.**

Audituesit e Brendshëm duhet të njohin mirë njësinë publike, veprimtaritë operacionale dhe sistemin financiar me qëllim që të sigurojnë se puna e tyre do të jetë e përshtatshme për organizatën vlerësimin e sistemeve, proceseve të cilat janë pjesë e aktiviteteve të përditshme të njësisë që auditohet. Nga kontrolli i dokumentacionit, rezultoi se audituesit e brendshëm nuk kanë krijuar dosjet e përhershme të auditimit në mos përputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm ku përcaktohet se: ***Njësia e Auditimit të Brendshëm mban një dosje të përhershme për çdo njësi publike ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet.*** Dosja e përhershme duhet të përditësohet pas plotësimit të çdo angazhim auditimi me qëllim që të sigurohen ndryshimet e ndodhura në përmbajtjen e saj. Dosja e përhershme mbahet në format elektronik ose të printuar, kjo në funksion të mundësive të NjAB.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se:

-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në nenet 12, 13 të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar;

-Për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2024, nuk janë audituar aktivitete që kryen Bashkia Bulqizë, si Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit si dhe Inspektoriat i Mbrojtjes së Territorit Vendor, në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit;

-Në çdo raport auditimi, audituesit nuk kanë dhënë asnjë opinion të përgjithshëm mbi të gjitha sistemet e audituara, nëse këto sisteme funksionojnë në nivelin e duhur nga të gjitha strukturat apo punonjësit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve, si tek përmbledhja ekzekutive (e cila paraqet vetëm gjetjet dhe rekomandimet përkatëse pas sistemeve të vlerësuara) dhe në vijim pas çdo sistemi apo fushe të audituar;

- NjAB në Bashkinë Bulqizë nuk ka dosje të përhershme për çdo njësi publike ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli VI, pika “Dosja e Përhershme”.

-Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Bulqizë nuk ka hartuar “Programin për sigurimin e brendshëm të cilësisë të drejtorisë së auditimit të brendshëm”.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi zj.B. B. në cilësinë e Përgjegjëses të Sektorit të Auditit të Brendshëm.

2.2. Auditimi i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.

2.2.1. Auditimi përkatësisë së paraqitjes së aktiveve afatgjata në pasqyrën e pozicionit financiar:

- Regjistrimi fillestar dhe klasifikimi i tyre,
- Inventarizimi periodik.

2.2.2. Auditimi i saktësisë dhe raportimit të paraqitjes në pasqyrën e pozicionit financiar të:

- Llogarive të arkëtueshme,
- Llogarive të pagueshme.

2.2.3. Auditimi i plotësisë dhe saktësisë së pasqyrës së performancës financiare:

- Mbi realizimin dhe regjistrimin e të ardhurave nga burimet e veta dhe transfertat,
- Mbi realizimin dhe regjistrimin e shpenzimeve.

Në zbatim të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1- Formati 1 - Pasqyra e pozicionit financiar për vitin 2024;
- 2- Formati 2 - Pasqyra e performancës financiare, ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2024;
- 3- Formati 3- Pasqyra e flukseve monetare për vitin 2024;
- 4- Formati 4- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto për vitin 2024;
- 5- Formati 5- Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për vitin 2024;
- 6- Formati 6- Pasqyra e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre për vitin 2024;
- 7- Formati 7- Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto për vitin 2024;
- 8- Formati 8- Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave për vitin 2024.

a. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Struktura e llogarive është hartuar mbi bazën e Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MF nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018.”

Auditimi në drejtim të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare u përqendrua në vlerësimin e saktësisë dhe përputhshmërisë ligjore të veprimeve ekonomiko-financiare dhe të dokumentimit të transaksioneve financiare të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi, përjashtuar disa mangësi të trajtuara në vijimësi.

Auditimi u krye në lidhje me dy drejtimet e mëposhtme: mbi afatin ligjor të përcaktuar për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe në vlerësimin e rregullshmërisë dhe saktësisë së llogarive dhe të pozicioneve të bilancit për çdo vit, si dhe kryerjen dhe dokumentimin e veprimeve në ditarin e përgjithshëm (ku janë regjistruar dhe veprimet e bankës), konform udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

Për çdo vit të veçantë të periudhës objekt auditimi, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe kërkesave të Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, me Udhëzimin e MF me nr. 5, datë 21.02.2022, pasqyrat financiare janë përpiluar dhe dërguar për miratim në Degën e Thesarit Tiranë.

Konstatohet se, veprimet kontabël janë azhornuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarë të mbajtur në programin excel, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e dispozitave në fuqi. Llogaritë vjetore, si dhe pasqyrat financiare janë të shoqëruara me situacionin e shpenzimeve të programit dhe ato të realizuara nga Bashkinë Bulqizë, situacione këto të rakorduara me degën e Thesarit.

Pasqyrat Financiare janë të shoqëruara me relacionin shpjegues, sipas udhëzimit të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MF), me situacionin përfundimtar të shpenzimeve si dhe llogaridhënien vjetore.

Në bazë të, të dhënave kontabël përkatëse janë përpiluar Pasqyrat Financiare vjetore mbi llogaritë e vitit ushtrimor që janë raportuar.

Për vitin 2024 janë dorëzuar Pasqyrat Financiare të Bashkisë Bulqizë pranë Degës së Thesarit Bulqizë me shkresën nr. 899 prot., datë 25.02.2025 “Dërgimi i Pasqyrat Financiare viti 2024” protokolluar në degën e thesarit me nr. 14/3 prot. datë 25.02.2025

Gjithashtu, situacionet progresive vjetore janë rakorduar dhe kundër-firmuar rregullisht nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit. Realizimi i buxhetit i është raportuar rregullisht Degës së Thesarit.

b. Vlerësimi nëse drejtat dhe detyrimet janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, si edhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

Në kuadër të standarteve të raportimit financiar (SNK 1) objektivi i pasqyrave për qëllime të përgjithshme është të sigurojnë informacion lidhur me pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin monetar të një njësie ekonomike që është i dobishëm për një grup të gjerë përdoruesish në marrjen e vendimeve ekonomike. Pasqyrat financiare tregojnë gjithashtu dhe rezultatet e drejtimit lidhur me administrimin e burimeve që u janë besuar. Pasqyrat financiare do të pasqyrojnë me drejtësi pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin monetar të një njësie ekonomike. Paraqitja e drejtë kërkon një përfaqësim të besueshëm të efekteve të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera në përputhje me përkufizimet dhe kriteret e njohjes për aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet të përcaktuara në Kuadrin konceptual për raportimin financiar (Kuadri konceptual).

Pasqyra financiare

Në zbatim të udhëzimit nr. 8, datë 03.09.2018, Kapitulli V “Procedurat e paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore”, i ndryshuar. Pasqyrat Financiare kanë për qëllim që të japin një pamje të strukturuar të pozicionit financiar dhe transaksioneve për çdo njësi të qeverisjes së përgjithshme, të sigurojnë informacion për pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset monetare.

Qëllimi i përgjithshëm është që me informacionin që disponojnë, pasqyrat financiare, në rradhë të parë të japin informacion të besueshëm për vendimmarrje për vetë njësinë apo institucionin

raportues, nëpërmjet sigurimit të informacionit rreth burimeve financiare dhe alokimin e tyre, informacionit për mënyrën e financimit të aktiviteteve të njësisë dhe realizimit të kërkesave monetare, lidhur me aftësinë e njësisë për të financuar aktivitetet dhe për të përmbushur detyrimet dhe angazhimet, informacionit për vlerësimin e performancës së njësisë.

Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2024 dhe ato të vitit 2023 konstatohet se tepricat e pasqyruara në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 në pasqyrat e vitit 2023 përputhen me tepricat në celje të vitit ushtrimor 2024 në pasqyrat e vitit 2024.

Nga auditimi i pasqyrave financiare individuale të Bashkisë Bulqizë konstatohet se:

1. Pasqyra e pozicionit financiar

Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar tre pjesët përbërëse të saj paraqiten si më poshtë:
Për vitin 2024

a- Të drejtat (Aktivet)	4,135,792 mijë lekë
b- Detyrimet (Pasivet)	318,213 mijë lekë
c- Fondet Neto (Aktivet neto)	3,817,579 mijë lekë

Aktivet neto plotësojnë rregullin Aktive – Pasive = Aktivet Neto 3,817,579 mijë lekë).

1.1. Të Drejtat (Aktivet)

Të Drejtat, më datë 31 dhjetor të periudhës së auditimit përbëhen dhe pasqyrohen në tabelën nr. 1:

Nga auditimi u konstatua se në vitin 2023 Aktivet e afatshkurtra kanë zënë 13% të totalit të të drejtave në vlerë 497,312 mijë lekë ndërsa Aktivet afatgjata kanë zënë 87% të totalit, në vlerë 3,437,075 mijë lekë.

Gjatë vitit 2024 ky raport pothuajse nuk ka ndryshuar, më konkretisht aktivet e afatshkurtra kanë zënë 15% të totalit të të drejtave në vlerë 628,045 (mijë lekë) ndërsa aktivet afatgjata kanë zënë 85% të totalit, në vlerë 3,507,747 (mijë lekë).

Ndryshimi në Aktivet afatshkurtra gjatë vitit 2024 është në rritje në vlerë me 130,733 (mijë lekë), në raport me peshën specifike të totalit të të drejtave është gjithashtu në rritje me 2%. Ky ndryshim është efekt i rritjes së mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre dhe llogarive të arkëtueshme, dhe konkretisht i rritjes së tepricës së mjeteve monetare, shtimit të inventarit qarkullues, rritjes së detyrimeve të debitorëve ndaj njësisë dhe operacioneve me shtetin. Ndërsa ndryshimi në Aktivet afatgjata gjatë vitit 2024 vlerë kanë ardhur në rritje me 70,671 (mijë lekë) por kanë ardhur me rënie në peshë specifike me 2% në raport me totalin e Të Drejtave, ky ndryshim është efekt i shtimit të aktiveve afatgjata materiale.

1.a Aktivet afatshkurtra (qarkulluese) AASH

Aktivet Afatshkurtra për vitin 2024 janë mbyllur me teprice në shumën 628,045,447 lekë dhe përbëhen nga shumat e rubrikave që përfaqësojnë:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 290,435,202 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 74,618,946 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 262,991,299 lekë;

Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre”, përbëhet nga:

Gjendja e llogarisë nr.520 “Disponibilitete në Thesar”, sipas pasqyrës së pozicionit financiar të periudhës objekt auditimi në fund të vitit ushtrimor mbyllet me tepricë në vlerë 290,435,202 lekë. Tepricat në mbyllje të vitit ushtrimor rakordojnë me rubrikën V “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” dhe rubrikën VI “Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” të pasqyrës së fluksit monetar.

Nga rakordimi me degën e thesarit lidhur me llogarinë nr.520 “Disponibilitete në Thesar”, llogarinë nr.466 “Mjete në ruajtje” dhe llogaritë e të ardhurave nuk konstatohen mosrakordime.

Llogaria nr.520 “Disponibilitete në Thesar”, në pasqyrat financiare objekt auditimi paraqitet në mënyrë analitike në tabelën nr. 2 në aneks:

Llogaritë e klasës 3, sipas Pasqyrave të Pozicionit Financiar të Bashkisë Bulqizë në 31.12.2024, teprica e e kësaj klase është 74618946 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në shumën 31,387,477 lekë dhe llogaria 32 “Inventar i imët” në shumën 43,231,469 lekë pasqyruar në tabelën nr. 3 në aneks

Diferencat me vitet e mëparshme përfaqësojnë lëvizjet e inventarit, konkretisht për vitin 2024-2023 ndryshimi është në shumën 11,769,471 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën (- 11,769,471) lekë.

Nga auditimi i librave të magazinës të vitit 2024 konstatohet se gjendja e llogarive kontabël është e kuadruar me gjendjen e kontabël të librave të magazinës sipas tabelës nr. 4 në aneks:

Llogaritë klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 262,991,299 lekë përbëhet nga llogaria 468 “Debitorë” në shumën 205,706,038 lekë si dhe llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në shumën 57,285,261 lekë të pasqyruara në tabelën nr. 5 në aneks.

- Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” përfaqëson detyrimet që kane të tretët ndaj Bashkisë Bulqizë e cila për periudhën e auditimit është mbyllur me tepricë në shumën 205,706,038 lekë. Kjo shumë e detajuar paraqitet në tabelën nr. 7 në aneks:

Analiza e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”

në lekë

Nr	Subjekti Debitor	Kush e ka lene Detyrimin	Gjendje	Shtesat	Paksimet	Gjendja
			31.12.2023	VITI 2024	VITI 2024	31.12.2024
1	Kopshte + cerdhe pagese ushqimi	Drejtoria e taksave	459,787	121,980	24,590	557,177
2	Entet shtetërore detyrimet ndaj Bashkisë	Drejtoria e Taksave	1,542,907	63,000	59,000	1,546,907
3	Detyrim ndaj kompanice celulare AMC nga ish punonjes te ish komunes Fushe Bulqize	Drejtoria e Taksave	685,557			685,557
4	Biznesi I Vogel	Drejtoria e Taksave	35,613,731	3,137,665	1,638,363	37,113,033
5	Biznesi I Madh	Drejtoria e Taksave	3,496,977	5,847,730	3,117,536	6,227,171
6	ËOOD BULQIZA	Drejtoria e Taksave	5,552,190			5,552,190
7	Subjektet e kromit	Drejtoria e Taksave	50,140,347			50,140,347
8	Abonentet familjare takse toke bujqesore	Drejtoria e taksave		5,360,422		5,360,422
	Shuma e debitorëve nga tatim -taksat		97,491,496	9,170,375	4,839,489	101,822,382
9	Punonjes te Bashkise detyrime pa objekt	Kontrolli I Larte I Shtetit	8,309,657		10,570	8,299,087
10	Popullata, takse e ndikimit ne infrastrukt KLSH	Kontrolli I Larte I Shtetit	8,997,259			8,997,259
11	Shperblim Anetar Keshill Komun lene KLSH	Kontrolli I Larte I Shtetit	5,927,328		25,050	5,902,278
12	Demshperblim kontrate qeraje KLSH	Kontrolli I Larte I Shtetit	2,769,716			2,769,716
13	Pakete turistike lene KLSH	Kontrolli I Larte I Shtetit	165,498		28,524	136,974
14	Gjobe per subjektet, leje shfrytezimi KLSH	Kontrolli I Larte I Shtetit	1,777,416			1,777,416
15	Gjobe kompanite celulare KLSH	Kontrolli I Larte I Shtetit	554,188			554,188
16	Punime te pa kryera lene KLSH	Kontrolli I Larte I Shtetit	19,464,803			19,464,803
17	Gjobe per OE pjesemarres ne tender KLSH	Kontrolli I Larte I Shtetit	954,200			954,200
18	GJOBA IMT (LENE KLSH VITI 2022)	Kontrolli I Larte I Shtetit	12,385,000			12,385,000
19	Qira fond pyjor ne përdorim KLSH 2022	Kontrolli I Larte I Shtetit	31,482,313			31,482,313
20	Takse e leshimit Autor/Licensav KLSH 2022	Kontrolli I Larte I Shtetit	5,800,000			5,800,000
	Shuma e shpërblim dëmi nga KLSH		98,587,378		64,144	98,523,234
	Totali		196,078,874	14,530,797	4,903,633	205,706,038

Burimi: Dega e Shërbimeve Bashkinë Bulqizë /përpunuar nga grupi i auditimit

Nga analizimi i debitorëve konstatohet se ato përbëhen nga detyrime të lëna nga KLSH gjatë auditimeve të mëparshme në shumën 98,587,378 lekë për të cilat subjekti nuk ka marrë asnjë masë për arkëtimin e këtyre detyrimeve të cilat përbëjnë një shumë të konsiderueshme. Dhe detyrime nga Drejtoria e Taksave në shumën 97,491,496 lekë janë të cilat gjatë vitit 2024 janë shtuar në shumën 14,530,797 lekë dhe pakësuar në shumën 4,903,633 lekë. Analiza e debitorëve për disa taksa e tarifa vendore paraqitet më poshtë:

- **Gjendja e debitorëve për taksa e tarifa vendore me datë 31.12.2024.**

Nga përpunimi i të dhënave nga informacioni i vënë në dispozicion rezulton se ka nivel të lartë debitorësh në numër dhe në vlerë për taksat dhe tarifat vendore si më poshtë:

Bashkia Bulqize	Emërtimi	Vlera totale e debitorëve (progresive ne fund 2023)	Shtesa e debitorëve te vitit raportues	Pakesime gjate vitit 2024	Debi e krijuar gjate vitit 2024, pra shtesa minus pakesime	Vlera totale e debitorëve (progresive ne fund 2024	Vlera e kontabilizuar e debitorëve ne PF ne mbyllje te vitet 2024	Vlera e kontabilizuar e debitorëve ne PF ne mbyllje te vitit 2024 persa i takon vetëm vitet 2024	Diferenca e pa kontabilizuar
		a	b	c	d=b-c	e=a+d	f	g	h=e-f
Llog.468	Debitorë të ndryshëm	196,078,874	14,530,797	4,903,633			205,706,038		
	Nga këto:								
PF	Shpërbllim dëmi nga KLSH	98,587,378		64,144	-64,144		98,523,234		
PF	Debitorë nga tatim-taksa	97,491,496	14,530,797	4,839,489	9,691,308		107,182,804		
Spektori i	Debitorë nga tatim-taksa	99,933,852	14,530,797	4,839,489	9,691,308	109,625,160		109,625,160	2,442,356
Tatim	a.Biznesi Madh/vogël	80,256,366	9,170,375	5,121,293	4,049,082	84,305,448		84,305,448	
Taksa	b.Familjare	19,677,486	5,360,422	0	5,360,422	25,037,908		25,037,908	

Burimi: Drejtoria e të Ardhurave dhe Spektori i Financës, përpunuar nga grupi i auditimit

Konkluzion: Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion rezultoi se, ka nivel të lartë debitorësh në numër dhe në vlerë për taksat dhe tarifave vendore, ku në **fund të vitit 2023 vlera debitorëve është 99,933,852 lekë**, shtesat gjatë vitit 2024 janë në shumën 14,530,797 lekë, janë kryer arkëtime në shumën 4,839,489 lekë. Detyrimet progresive **në fund të vitit 2024** janë në shumën **109,625,160 lekë**, e cila përbëhet nga:

- Detyrimet debitorë nga biznesit i madh dhe i vogël në shumën 84,305,448 lekë.
- Detyrimet debitorë nga familjarët në shumën 25,037,908 lekë.

Mos arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga taksapaguesit debitorë ka sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Bulqizë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, nenet 6 dhe 9/pika 1.3.

Nga Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Bulqizë për vjeljen e detyrimeve janë mjaftuar vetëm me nxjerrjen e njoftim-vlerësim detyrimin dhe nuk është aplikuar asnjë masë tjetër shtrënguese, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89, 90, 91 dhe 93 dhe me VKB nr. 104, datë 04.12.2023 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore dhe kundërvajtjet administrative për vitin 2024”

Konkluzion: Gjithashtu nga vlera e debitorëve progresiv është kontabilizuar vetëm vlera prej 107,182,804 lekë dhe diferenca prej 2,442,356 lekë nuk është kontabilizuar në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” në aktiv të Formatit 1 “Pasqyra e pozicionit financiar” të pasqyrave financiare. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kap. III, pika 3.2, paragrafi “Vlerësimi i të drejtave dhe detyrimeve” faqe 28-30.

▪ Debitorët nga mos arkëtimi taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet

Të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtime të reja është realizuar në shumën 4,128 mijë lekë nga shuma prej 3,000 mijë lekë e planifikuar, ose në masën 138%, ndërsa realizimi në fakt në vitin 2023 ka qenë 4,773 mijë lekë në të njëjtin nivel me faktin e vitit 2024. Pra në planifikimin e TNI për ndërtime të reja për vitin ushtrimor nuk është marrë në konsideratë fakti i vitit pasardhës. Përsa i përket planifikimit të TNI nga legalizimet nuk ka programim të ardhurash as në vitin 2023 dhe as në vitin 2024. Planifikimi, realizimi, detyrimet debitorë dhe kontabilizimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Bashkia Buqizë	Realizimi 2023	Plani 2024 (detyrimeve sipas	Realizimi 2024 (arkëtim)	Diferenca Plan-Fakt 2024	Vlera e Kontabilizuar ne fund 2024	Debi në fund 2023	Debia ne fund 2024		Vlera e Kontabilizuar	Diferenca mes vlerës se kontabilizuar
							Krijuar 2024	Vlera pogresive		

		kontratave te lidhura)							ne fund 2024	dhe debise ne fakt
TNI per ndertimet e reja	4,773,320	3,000,000	4,127,932	+1,127,932	4,715,249		-	-	4,715,249	-
TNI nga legalizimet	-	-	332,765			1,273,024		940,259	-	940,259

Konkluzion: Nga auditimi dhe referuar të dhënave të vënë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave konstatohet se:

- Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja është realizuar 4,128 mijë lekë nga 3,000 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 138%, ndërsa realizimi në fakt në vitin 2023 ka qenë 4,773 mijë lekë në të njëjtin nivel me faktin e vitit 2024. Pra në planifikimin e TNI për ndërtime të reja për vitin ushtrimor nuk është marrë në konsideratë fakti i vitit paraardhës. Përsa i përket planifikimit të TNI nga legalizimet nuk ka programim të ardhurash as në vitin 2023 dhe as në vitin 2024.

- Në lidhje me detyrimet për taksën në infrastrukturë nga legalizimet e ndërtimeve pa leje në fund të vitit 2023 kanë qenë 44 individë në shumën 1,273,024 lekë nga të cilët gjatë vitit 2024 kanë paguar vetë 4 individe në shumën 332,765 lekë. Në fund të vitit 2024 rezultojnë rezultojnë të jenë debitorë 40 persona me vlerë 940,259 lekë, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Bulqizë. Mos arkëtimi i detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë është në kundërshtim VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të Të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, pika 3 dhe me paketën fiskale.

Gjithashtu vlera debitore prej 940,259 lekë për TNI në fund të vitit 2024 nuk është kontabilizuar në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” në aktiv të Formatit 1 “Pasqyra e pozicionit financiar” të pasqyrave financiare në kundërshtim me UMF nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në UMFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kap. III, pika 3.2, paragrafi “Vlerësimi i të drejtave dhe detyrimeve” faqe 28-30. Listat e debitorëve të TNI paraqiten në aneks.

▪ Debitorët nga mos arkëtimi i tarifës për autorizim/licencë për ushtrimin e aktiviteti tregtim të hidrokarbureve (pika karburanti)

Sipas dokumentacioni dhe të dhënave të vënë dispozicion, subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet me seli në territorin e Bashkisë Bulqizë, janë 9, ku 7 subjekte për shitjen karburanteve dhe 2 subjekte për shitjen e gazit të lëngshëm, nga të cilët janë pajisur me licencë 7 prej tyre dhe 2 subjekte nuk janë pajisur me licencë.

Të ardhurat nga tarifa për licence tregtimi nafte bruto e nënproduktet e saj janë realizuar në shumën 650 mijë lekë nga shuma prej 1,000 mijë lekë e planifikuar, ose në masën 65%, ndërsa realizimi në fakt në vitin 2023 ka qenë 1,380 mijë lekë, pra në planifikimin nuk është marrë në konsideratë fakti i vitit paraardhës. Planifikimi, realizimi, detyrimet debitore dhe kontabilizimi i tarifës së autorizim/licencës për tregtimin e karburanteve paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Bashkia Buqizë	Realizimi 2023	Plani 2024 (detyrimeve sipas kontratave te lidhura)	Realizimi 2024 (arkëtim)	Diferenca Plan-Fakt 2024	Vlera e Kontabilizuar ne fund 2024	Debi në fund 2023	Debia ne fund 2024		Vlera e Kontabilizuar ne fund 2024	Diferenca mes vlerës se kontabilizuar dhe debise ne fakt
							Krijuar 2024	Vlera pogrative		
Tarifa per licence tregtimin nafte bruto e nenproduktet e saj	1,380,000	1,000,000	650,000	- 350,000	650,000	5,800,000	-	5,800,000		5,800,000

Konkluzion: Nga auditimi ka rezultuar se 9 subjekte ushtrojnë aktivitet të tregtimit të karburanteve me seli në territorin e Bashkisë Bulqizë, nga të cilët 2 subjekte nuk janë pajisur

me autorizim/licencë për shitje karburanti, për të cilët nuk është asnjë masë shtrënguese, ndërsa nga 7 subjektet e tjerë, 3 prej tyre kanë likuiduar pjesërisht vlerën e plotë dhe 4 subjekte nuk kanë likuiduar detyrimet gjithsej në vlerën 5,800,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë. Kjo vlerë debitore nuk është evidentuar në kontabilitet në llog.468 “Debitorë të ndryshëm”. Këto veprime janë në pajtueshmëri me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 22, pika 3, germa “dh” me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 35, VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, me UMF nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në UMFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kap. III, pika 3.2, paragrafi “Vlerësimi i të drejtave dhe detyrimeve” faqe 28-30. Në mënyrë të detajuar detyrimet paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Subjekti	Nipt	Afati i Autorizimit		Detyrimi për autorizimin	Pagesat e kryera	Diferenca
			Fillimi	Mbarimi			
1	“M” shpk	L.....T	22.05.2015	21.05.2020	1,000,000	0	1,000,000
2	“XH O” shpk	L.....A	01.02.2015	31.01.2020	1,000,000	0	1,000,000
3	“M M” shpk	J.....I	15.05.2015	14.05.2020	1,000,000	0	1,000,000
4	“J” shpk	K.....I	26.05.2013	25.05.2018	1,000,000	0	1,000,000
5	“R O” shpk	L.....P	19.11.2020	13.12.2024	1,000,000	600,000	400,000
6	“T D” shpk	L.....S	24.09.2021	23.09.2022	1,000,000	200,000	800,000
7	“XH 2013” shpk	L.....Q	03.11.2021	03.11.2022	1,000,000	400,000	600,000
SHUMA					7,000,000	1,200,000	5,800,000
	“T” shpk	K.....F	Pa autorizim				
	“T” shpk	L.....Q	Pa autorizim				

▪ Debitorët nga mos arkëtimi i tarifës së qirasë, si detyrim kontraktor nga dhënia me qira të parcelave nga fondi pyjor/kullosor

Të ardhurat nga tarifa për pyjet dhe kullotat janë realizuar në shumën 14,474 mijë lekë nga shuma prej 11,440 mijë lekë e planifikuar, ose në masën 127%, ndërsa realizimi në fakt në vitin 2023 ka qenë 9,778 mijë lekë, pra në planifikimi janë marrë në konsideratë kontratat afatgjatë të lidhura, por nuk janë marrë në konsideratë kontratat sezonale. Planifikimi, realizimi, detyrimet debitore dhe kontabilizimi i tarifës së qirasë paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Bashkia Buqizë	Realizimi 2023	Plani 2024 (detyrimeve sipas kontratave të lidhura)	Realizimi 2024 (arkëtim)	Diferenca Plan-Fakt 2024	Vlera e Kontabilizuar ne fund 2024	Debi në fund 2023	Debia ne fund 2024		Vlera e Kontabilizuar ne fund 2024	Diferenca mes vlerës se kontabilizuar dhe debise ne fakt
							Krijuar 2024	Vlera pogrative		
Tarifa per pyjet dhe kullotat	9,707,740	11,400,000	14,440,000	+3,040,000	14,440,000	31,824,726	-	30,038,472	-	30,038,472

Konkluzion: Nga Bashkia Bulqizë janë lidhur dhe administrohen 16 kontrata qiraje për dhënie me qira të parcelave nga fondi pyjor/kullosor me sipërfaqe 107.863 ha, me afate 10 dhe 35 vjeçare. Nga auditimi në lidhje me arkëtimin e të ardhurave nga dhënia me qira të parcelave nga fondi pyjor/kullosor u konstatua se në fund tvitit 2024 paraqiten debitorë 4 shoqëri qiramarrëse që nuk kanë shlyer detyrimet e kontratës në vlerën 30,038,472 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Bulqizë. Gjithashtu nuk është bërë në mbyllje të PF të vitit ushtrimor 2024 kontabilizimi në llog.468 “debitorë të ndryshëm” i vlerës debitore prej 30,038,472 lekë sipas listës së shoqërive qiramarrëse debitore. Këto veprime janë në pajtueshmëri me kontratat përkatëse të lidhura të qiradhënies neni 4 “vlera e qirasë vjetore” dhe neni 5 “pagesa dhe regjimi i saj” kontratave përkatëse, me Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar neni 830, me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 12, germa “g”, neni

22, pika 3, germa “dh” dhe VKB-ve për miratimin e paketave fiskale dhe me UMF nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në UMFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kap. III, pika 3.2, paragrafi “Vlerësimi i të drejtave dhe detyrimeve” faqe 28-30. Në mënyrë të detajuar detyrimet paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	Subjekti	Kontrata		Sip ha	Vlera kontratës	Detyrimi Deri 31.12.23	Likujduar Deri 31.12.23	Pa likujduar 31.12.23	Paguar gjatë vitit 2024	Gjendja në fund të vitit 2024	Datat e likujdimit
		Nr	Date								
1	E	1824	15.05.2017	0.8	153,845	923,070	163,920	759,150		759,150	
2	Cr P	1218	05.04.2017	8.9	217,510	1,305,060	780,000	525,060		525,060	28.05.2024
3	A-T	435	08.02.2017	0.52	72,925	510,475	72,925	437,550	437,550		
4	D T	4082/2	15.11.2017	2.8	398,567	2,391,402	0	2,391,402		2,391,402	
5	G 1	1203	04.04.2017	0.47	266,072	1,330,360	550,017	780,343	780,343		19.03.2024
6	G 2	1202	04.04.2017	2.3	125,020	750,120	181,759	568,361	568,361		19.03.2024
7	T 2003	260	06.09.2012	7.36	3,488,345	34,883,450	8,520,590	26,362,860		26,362,860	
	Totali			23.15		42,093,937	10,269,211	31,824,726	1,786,254	30,038,472	

▪ Debitorët nga mos arkëtimi i taksave të shërbimit hotelier

Të ardhurat nga taksa e shërbimit hotelier janë realizuar në shumën 24 mijë lekë nga shuma prej 150 mijë lekë e planifikuar, ose në masën 16%, ndërsa realizimi në fakt në vitin 2023 ka qenë 40 mijë lekë. Vlera debitor është 60,000 lekë, e cila nuk është e kontabilizuar. Planifikimi, realizimi, detyrimet debitorë dhe kontabilizimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Bashkia Buqizë	Realizimi 2023	Plani 2024 (detyrimeve sipas kontratave të lidhura)	Realizimi 2024 (arkëtim)	Diferenca Plan-Fakt 2024	Vlera e Kontabilizuar ne fund 2024	Debi në fund 2023	Debia ne fund 2024		Vlera e Kontabilizuar ne fund 2024	Diferenca mes vlerës se kontabilizuar dhe debise ne fakt
							Krijuar 2024	Vlera pogrësive		
Tarifa për hotel	40,250	150,000	24,500	125,500	125,500	31,824,726	60,000	60,000	-	60,000

- Llogaria 4342 “Operacione me shtetin(Të drejta)” mbyllet me tepricën e pasqyruara në pasqyrat financiare në shumën 57,285,261 lekë. Kjo tepricë përfaqëson detyrimet për pagat, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, detyrimet e TAP si dhe detyrime të tjera. Kjo llogari ka si kundërparti llogaritë e detyrimeve 401,421, 431, 435, 436, 437 dhe 467. Llogaritë kundërparti të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin(Të drejta)” në mënyrë analitike paraqitet si në tabelën nr. 6 në aneks:

1.1.b Aktivët Afatgjatë

AAGJ mbyllet në pasqyrat financiare në shumën 3,507,747,510 lekë dhe përbëhen nga aktivët afatgjatë jomateriale në shumën 11,120,946 lekë, aktivët afatgjatë materiale në shumën 3,264,336,905 lekë, aktivët afatgjatë financiare në shumën 200,000 lekë si dhe investimet në shumën 232,089,659 lekë sipas tabelës nr. 8 në aneks:

Aktivët afatgjatë jomateriale përbëhen nga llogaria 202 “Studime dhe kërkime” në shumën 11,120,946 lekë dhe përbëhet në mënyrë analitike sipas tabelës nr. 9 në aneks:

Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” në fund të vitit 2024 pasqyrohet në shumën neto 11,120,946 lekë. Nga auditimi i pasqyrës “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (vlera neto)” **konstatohet** se kjo llogari është pakësuar në shumën 2,192,643 lekë për projekte të cilat janë amortizuar plotësisht, dhe është shtuar me projekte të reja në shumën 5,172,816 lekë. Për amortizimin e kësaj klase nga subjekti është përdorur norma e amortizimit 15% dhe metoda e amortizimit me “Vlerë të mbetur”. Metoda e amortizimit me vlerë të mbetur e aplikuar nga subjekti është në kundërshtim me Udhëzimit të MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, pika 36 në të cilën përcaktohet se: “Për aktivët afatgjatë jomateriale, amortizimi të llogaritë me metodën lineare me normë amortizimi 15%.”

Efekti në pasqyrat e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mos aplikimit të normës së saktë të amortizimit jap një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të pozicioneve financiare. Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 “Paraqitja E Pasqyrave Financiare”, paragrafi 27 i SNKSP 1 “Paraqitja E Pasqyrave Financiare”. Gjithashtu paraqitja në këtë mënyrë e veprimeve kontabël nuk mbështetet në parimet bazë të kontabilitetit publik sipas Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar pika 5.

Aktivët afatgjatë materiale pasqyrohen në tabelën nr. 10 në aneks dhe përbëhen nga:

- a- Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” mbyllet me tepricë në shumën 5,193,576 lekë
- b- Llogaria 211 “Pyje, Kullota Plantacione” mbyllet me tepricë në shumën 16,494,469 lekë
- c- Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione” mbyllet me tepricë në shumën 1,032,069,149 lekë
- d- Llogaria 213 “Rruge, rrjete, vepra ujore” mbyllet me tepricë në shumën 2,106,909,893 lekë
- e- Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” mbyllet me tepricë në shumën 17,246,803 lekë
- f- Llogaria 215 “Mjete transporti” mbyllet me tepricë në shumën 49,587,621 lekë
- g- Llogaria 218 “Inventar ekonomik” mbyllet me tepricë në shumën 36,835,394 lekë

Llogaritë përbërëse të AAM analizohen si më poshtë:

-Llogaria 210 “Toka, troje, terrene”, në fund të vitit 2024 pasqyrohet në vlerën neto 5,193,576 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 4,926,397 lekë.

Nga auditimi i pasqyrës “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (vlera neto)” të vitit 2024 llogaria 210 është shtuar me një vlerë prej 267,179 lekë. Kjo vlerë korrespondon me aplikimin e amortizimit të kësaj klase në vitet e kaluara e cila është sistemuar në vitin 2024 pasi kjo klasë nuk i nënshtrohet amortizimit.

-Llogaria 211 “Pyje, kullota plantacione”, në fund të vitit 2024 pasqyrohet në vlerën neto 16,494,469 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 16,494,469 lekë. Nga auditimi i pasqyrës “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (vlera neto)” të vitit 2024 llogaria 211 nuk ka pasur ndryshime

-Llogaria 212 “Ndërtesa dhe konstruksione”, në fund të vitit 2024 pasqyrohet në vlerën neto 1,032,069,149 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 1,042,359,614 lekë. Nga auditimi i pasqyrës “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (vlera neto)” të vitit 2024, llogaria 212 është shtuar me një vlerë prej 44,028,964 lekë dhe është pakësuar për amortizimin vjetor në shumën 54,319,429 lekë. Është aplikuar metoda e amortizimit me “Vlerë të mbetur” dhe normë amortizimi vjetore 5%.

-Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, në fund të vitit 2024 pasqyrohet në vlerën neto 2,106,909,893 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 1,886,853,478 lekë. Nga auditimi i pasqyrës “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (vlera neto)” të vitit 2024, llogaria 213 është shtuar me një vlerë prej 333,254,455 lekë dhe është pakësuar në shumën 113,198,040 lekë për amortizimin vjetor. Është aplikuar metoda e amortizimit me “Vlerë të mbetur” dhe normë amortizimi vjetore 5%.

-Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, në fund të vitit 2024 pasqyrohet në vlerën neto 17,246,803 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 14,138,177 lekë.

Nga auditimi i pasqyrave “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (vlera neto)” për periudhën objekt auditimi kjo llogari është shtuar me 4,016,353 lekë dhe është pakësuar vetëm për amortizimin e llogaritur gjatë vitit në shumën 907,727 lekë. Nga auditimi **konstatohet**

regjistri analitik i aktiveve nuk është i plotësuar me aktive të ndara në mënyrë të veçantë por është i paraqitur me grup aktivesh. Konstatohet se metoda e llogaritjes së amortizimit është me “Vlerë të mbetur” dhe me normë amortizimi 5%. Norma e aplikuar nga subjekti në masën 5% është në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, pika 36 e cila sanksionon se: “Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacioni fiskal përkatës, si më poshtë vijon: ... Për të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale duhet të zbatohet norma vjetore e amortizimit 20% mbi bazë grupimi.....”.

Efekti në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mos aplikimit të normës së saktë të amortizimit jap një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të pozicioneve financiare. Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 “Paraqitja E Pasqyrave Financiare”, paragrafi 27 i SNKSP 1 “Paraqitja E Pasqyrave Financiare”. Gjithashtu paraqitja në këtë mënyrë e veprimeve kontabël nuk mbështetet në parimet bazë të kontabilitetit publik sipas Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar pika 5.

-Llogaria 215 “Mjete transporti”, në fund të vitit 2024 pasqyrohet në vlerën neto 49,587,621 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 48,534,526 lekë.

Nga auditimi i pasqyrave “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” për periudhën objekt auditimi kjo llogari është shtuar me 10,840,000 lekë dhe është pakësuar vetëm për amortizimin e llogaritur gjatë vitit në shumën 9,786,905 lekë. Konstatohet se metoda e llogaritjes së amortizimit është me “Vlerë të mbetur” dhe me normë amortizimi 20%.

-Llogaria 218 “Inventar ekonomik” në fund të vitit 2024 pasqyrohet në vlerën neto 36,835,394 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 43,515,745 lekë.

Nga auditimi i pasqyrave “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” për periudhën objekt auditimi konstatohet se llogaria 218 është shtuar me një vlerë prej 2,780,879 lekë dhe është pakësuar me amortizimin në shumën 9,461,230 lekë. Konstatohet se metoda e llogaritjes së amortizimit është me “Vlerë të mbetur” dhe me normë amortizimi 20% dhe 25% sipas klasifikimit të aktiveve.

➤ Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave në përputhje me rregullat kontabël

Auditimi u fokusua në rregullshmërinë e kryerjes së procesit të inventarizimit sipas Udhëzimit nr. 30 të MF, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave të dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar sa më poshtë vijon:

Nga auditimi u konstatua se Bashkinë Bulqizë ka të dhëna mbi vlerën kontabël të aktiveve në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, neni 26 ku citohet: “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësoj një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike që siguron të ardhur ...”

Nisur nga rëndësia dhe materialiteti sasior dhe në natyrë i aspekteve të menaxhimit material dhe mundësisë për veprime të pajustificuara, është audituar periudha 2024.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit **konstatohet** se, për periudhën objekt auditimi, nuk është realizuar procesi i inventarizimit sipas parashikimeve të Paragrafit nr. 74, i Udhëzimit të Ministrisë së Financave

nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar që sanksionin se: “Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës”

Regjistrimi i aktiveve është kryer konform Kreut III, "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre", të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, date 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësite e Sektorit Publik".

Konstatohet se aktivet janë të regjistruara si grup dhe jo të veçanta. Aktivet në fletët e inventarit nuk janë klasifikuar sipas llogarive përkatëse.

Hyrja e aktiveve në përgjithësi është dokumentuar me fletë hyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre, konform pikës 37, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik". Dalja e aktiveve në përgjithësi është realizuar konform pikës 38, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësite e Sektorit Publik".

Konstatohet se regjistri i aktiveve nuk është i hartuar sipas përcaktimeve të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

➤ Inventarët e aseteve të kaluara me VKM Bashkisë dhe NJA nga Pushteti Qendror, certifikimi, vlerësimi dhe kontabilizimi i tyre.

Bashkisë Bulqizë përveç pasurive të paluajtshme (aktive) të vlerësuara të paraqitura në PF i janë transferuar listat përfundimtare të inventarëve me VKM përkatëse të gjitha pasuritë e paluajtshme që shtrihen në territorin nën juridiksionin e bashkisë, ku numri dhe statusi i tyre sipas njësive administrative paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Bashkia Bulqizë	Njësitë vendore	VKM për transferimin e pasurive të paluajtshme	Sasia	Certifikuar	Inventarizim i perditësuar	Vlerësuar	Kontabilizuar	Prona të zaptuara	Prona në proces legalizimi
	<i>Bashkia Bulqizë</i>	<i>Nr.5, dt 04.01.2013</i>	69	68	68				
Bulqizë	<i>Nj.Adm Zerqan</i>	<i>Nr.809, dt 06.10.2010</i>	98	5	5				
	<i>Nj.A Fushë Bulqizë</i>	<i>Nr.480, dt 30.05.2013</i>	603	4	4				
	<i>Nj.Adm Martanesh</i>	<i>Nr.523, dt 30.06.2010</i>	148	1	1				
	<i>Nj.Adm Trebisht</i>	<i>Nr.903, dt 21.12.2011</i>	40	-	-				
	<i>Nj. Adm. Gjoricë</i>	<i>Nr.124, dt 02.02.2009</i>	858	1	1				
	<i>Nj. Adm Ostren</i>	<i>Nr.160, dt 27.02.2013</i>	100	2	2				
	<i>Nj.Adm.Shupenzë</i>	<i>Nr.483, dt 30.05.2013</i>	152	4	4				
	Totali		2068	85	85				
	<i>Pyje dhe kullota</i>	<i>Nr.433, dt 08.06.2016</i>							
	<i>44209.66 ha</i>	<i>Nr rendor 2236</i>							

Konkluzion: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurat e ndjekura për hipotekimin dhe vlerësimin e pronave të paluajtshme të listave përfundimtare të formularëve të inventarit të transferuara me VKM nga pushteti qendror u konstatua se Bashkisë Bulqizë i janë transferuar në përdorim/pronësi 2068 asete dhe 43,209.66 ha pyje e kullota, nga të cilat ka të regjistruara dhe pajisur me certifikatë vetëm 85 asete, rrjedhimisht dhe të inventarizuara. Për pjesën tjetër të pasurive të pa luajtshme dhe parcelat nga fondi pyjor/kullor nuk është kryer përditësimi i inventarit dhe nuk janë marrë masa për përgatitjen e dokumentacionit tekniko-ligjor të tyre për të vijuar me procesin e aplikimit dhe regjistrimit të tyre në DVASHK Dibër. Për këto asete mungon informacioni për gjendjen e tyre, nëse janë ende ekzistente, të zaptuara, të dëmtuara, në proces legalizimi nga individë etj. Gjithashtu nuk ka vlerësim të pasurive të paluajtshme si ato të certifikuara dhe ato të pa certifikuara, duke mos evidentuar si aktive në PF me ndikim në pasqyrimin e gjendjes reale të pasurisë së kësaj njësie vendore.

Në pasqyrat financiare aktivet të evidentuara në llogaritë: llog.210 “Toka, troje, terrene” në vlerën 5,193,576 lekë, llogaria 211 “Pyje, kullota plantacione” në vlerën 16,494,469 lekë dhe

llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 1,032,069,149 lekë, të cilat janë AAGJM (pasuri) që kanë mbetur pronë shtet të trashëguara nëpërmjet PF të ish-institucioneve që para viteve 1990 bashkisë dhe ish-komunave. Bashkia Bulqizë nuk ka kryer asnjë veprim për hipotekimin e këtyre AAGJM në pronësi të saj, ndërkohë që kontabilizimi i tyre aktiveve nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV “Përditësimi, inventarizimi, transferimi dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme publike” nenet 35-4, me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, Kreu I, pika 4, Kreu III, pika 35.

Aktivitet afatgjata financiare përbëhen nga:

-Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” pasqyrohet në pasqyrën e pozicionit financiar në shumën 200,000. Kjo shumë përfaqëson vlerën e pjesëmarrjes së subjektit në shoqërinë “S. K. B. shpk” me 100% të aksioneve në vlerën 100,000 lekë. Dhe 100% të aksioneve të shoqërisë “Ë. B. SHPK” me vlerën 100,000 lekë.

Investimet përbëhen nga llogaria 231 “Për aktive afatgjata materiale” dhe pasqyrohen në shumën 232,089,659 lekë në pasqyrën e pozicionit financiar. Kjo llogari si kundërparti të saj ka llogaritë 105 dhe 106 të fondit të konsoliduar. Llogaria 106 Teprica e granteve kapitale të huaja në fondin e konsoliduar pasqyrohet në shumën 117,223,816 lekë, ndërsa llogaria 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme” pasqyrohet në shumën 0 lekë.

Konstatohet një diferencë prej 114,865,843 lekë. Efekti në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare është dhënia e një pasqyre jo të drejtë dhe të saktë të pozicionit financiar. Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 “Paraqitja E Pasqyrave Financiare”, paragrafi 27 i SNKSP 1 “Paraqitja E Pasqyrave Financiare”. Gjithashtu paraqitja në këtë mënyrë e veprimeve kontabël nuk mbështetet në parimet bazë të kontabilitetit publik sipas Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar pika 5.

1.2. Detyrimet

Llogaritë e klasës 4, në pjesën e detyrimeve të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme. Ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Bulqizë në datën 31 dhjetor të secilës periudhë kundrejt punonjësve për paga, organeve tatimore për tatimin mbi pagat, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, kreditorëve për mjetet në ruajtje të cilat janë fondet e ngurtësuar lidhur me garancitë e kontratave mes subjekteve dhe bashkisë si dhe operacioneve me shtetin.

Detyrimet në datat e mbylljes së periudhave ushtrimore përbëhen vetëm nga detyrimet afatshkurtra dhe paraqiten në tabelën nr. 11 dhe përbëhen nga:

- Llogaria 401-408, “Furnitorë e llogari të lidhura me to” përfaqëson shumën e detyrimeve që institucioni ka ndaj ofruesve të shërbimeve ose mallrave kryesisht të muajit dhjetor në shumën 22,079,516 lekë.

- Raportimi i detyrimeve në Ministrinë e Financës është bërë me shkresën nr. 1088 prot., datë 28.02.2025 me lëndë “Dërgim i shtojcës 5 mbi shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe nënhuave të paguara me fondet e trashëguara”, sipas udhëzimit nr. 35 datë 29.12.2023, të detajuara sipas tabelës së mëposhtme:

Detyrimet total në fund të vitit 2023	Paga	Detyrimet për likuidimin e fatu-rave tatimore për shpenzime korren-te	Detyrimet për likuidimin e faturave tatimore për investime	Detyrimet për likuidimin e vendimeve gjyqësore		Detyrim et për likuidim in e huave afatgjat a	Shpro në-sime	Investime	Totali i detyrimeve në fund të vitit 2024	Shtesa gjatë vitit 2024	Vlera e detyrimeve të raportuara në kontabilitet	Diferenca
				Detyrim i sipas vendimi t	Shpenzim e përmbarue -sesi							(vlera totale e detyrime-ve vlera e kontabili-zuar)

Udhëzimi të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar pika 5.

Konstatohet se detyrimet për sigurimet shëndetësore në listëpagesën e muajit dhjetor 2024 përllogariten në shumën 1,047,377 lekë ndërsa në pasqyrën e pozicionit financiar janë pasqyruar në shumën 514,250 lekë. Diferenca e konstatuar është në shumën 533,120 lekë. Detyrimi i konstatuar për sigurime shëndetësore për punonjësit në pasqyrat financiare është nënvlerësuar në shumën 533,120 lekë. Efekti në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mos konstatimit të saktë të detyrimeve për sigurime shëndetësore jep një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të detyrimeve financiare të subjektit. Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 “Paraqitja E Pasqyrave Financiare”, paragrafi 27 i SNKSP 1 “Paraqitja E Pasqyrave Financiare”. Gjithashtu paraqitja në këtë mënyrë e veprimeve kontabël nuk mbështetet në parimet bazë të kontabilitetit publik sipas Udhëzimi të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar pika 5.

- Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” përfaqësohen të hyrat (të ardhurat) që vijnë në llogarinë e thesarit të institucioneve që në një periudhë tjetër do t’u kthehen nga kjo llogari të tretëve. Në pasqyrën e pozicionit financiar për vitin 2024 kjo llogari paraqitet në vlerën kontabël 55,221,902 lekë, vlerë kjo e cila është e rakorduar me degën e thesarit, dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave për mallra dhe shërbime të cilat do tu kthehen të tretëve sipas kushteve të kontratave.

- Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” në shumën 205,706,038 lekë përfaqëson detyrimin që Bashkia i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të pa arkëtuara nga vitet e mëparshme. Kjo llogari rakordon me llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”.

1.3. Fondet Neto

Rubrika C e pasqyrës së pozicionit financiar evidenton aktivet neto ose fondet neto. Fondet neto përbëjnë diferencën midis totalit të aktiveve me totalin e pasiveve. Fondet neto përfshijnë zëra si: teprica apo deficioni i akumuluar, rezultatet e mbartura, rezultati i veprimtarisë ushtrimore, rezerva nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata, etj.

Nga auditimi konstatohet se Aktivet neto plotësojnë rregullin $\text{Aktive} - \text{Pasive} = \text{Aktivet Neto}$ për periudhat objekt auditimi.

Fondi i Konsoliduar përbëhet nga llog 101 “Fondi i akumuluar” i cili për vitin 2024 mbyllet me tepricë 2,955,799,219 lekë. Llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” përfaqëson rezultatin e vitit ushtrimor 2024 në shumën 290,435,202 lekë. Llogaria 115 “Nga Fondet e veta te investimeve” në shumën 442,152,048 lekë, llogaria 106 “Teprica e granteve kapitale të huaja” në shumën 117,223,816 lekë, llogaria 107 “Vlera e mjeteve të caktuara në përdorim” në shumën 200,000 lekë si dhe “Nga faktorë të tjerë” në shumën 11,769,471 lekë të pasqyruara në tabelën nr. 12 në aneks.

Nga auditimi i Pasqyrës së ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto, tepricat e llogarive në fund të periudhës ushtrimore pasqyrohet si në tabelën nr. 13 në aneks:

Nga auditimi **konstatohet se** totali fondeve neto në të dy pasqyrat rakordon por tepricat e llogarive të cilat ndikojnë dhe përbëjnë seksionin e tretë të pasqyrës së pozicionit financiar të cilat konvergojnë nga pasqyra e ndryshimeve në fondet neto nuk rakordojnë, dhe konstatohen diferenca mes së njëjtës llogari në të dyja pasqyrat duke bërë që të arrijmë në konkluzionin se tepricat e pasqyruara nuk na japin një pasqyrim të saktë dhe të drejtë të pozicionit financiar në datën 31 dhjetor 2024. Konkretisht llogaria 85 “Nga Rezultatet e vitit ushtrimor” në pasqyrën

e pozicionit financiar në mbyllje të vitit ushtrimor pasqyrohet në shumën 290,435,202 lekë ndërsa në pasqyrën e ndryshimeve në fondet neto nuk pasqyrohet asnjë e dhënë financiare, pra **rezultoni** një diferencë prej 290,435,202 lekë.

- Llogaria 115 “*Nga Fondet e veta të investimeve*” në pasqyrën e pozicionit financiar në mbyllje të vitit ushtrimor pasqyrohet në shumën 442,152,048 lekë ndërsa në pasqyrën e ndryshimeve në fondet neto pasqyrohet në shumën 101,830,342 lekë, **konstatohet** një diferencë në shumën 340,321,706 lekë.

- Llogaria 12 “*Nga rezultatet e mbartura*” në pasqyrën e pozicionit financiar nuk pasqyrohen të dhëna financiare ndërsa në pasqyrën e ndryshimeve në fondet neto pasqyrohet në shumën 23,635,354 **konstatohet** një diferencë në shumën 23,635,354 lekë.

- Llogaria 106 “*Nga grantet e jashtme kapitale*” në pasqyrën e pozicionit financiar në mbyllje të vitit ushtrimor pasqyrohet në shumën 117,223,816 lekë ndërsa në pasqyrën e ndryshimeve në fondet neto pasqyrohet në shumën 4,088,044 lekë, **konstatohet** një diferencë në shumën 113,135,772 lekë. Efekti në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mos rakordimit të plotë dhe të saktë të llogarive kontabël në pasqyrat financiare jep një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të pozicionit financiar të subjektit. Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 “Paraqitja E Pasqyrave Financiare”, paragrafi 27 i SNKSP 1 “Paraqitja E Pasqyrave Financiare”. Gjithashtu paraqitja në këtë mënyrë e veprimeve kontabël nuk mbështetet në parimet bazë të kontabilitetit publik sipas Udhëzimi të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar pika 5.

2. Pasqyra e Performancës

Pasqyra e performancës financiare pasqyron në mënyrë të klasifikuar dhe strukturuar informacionin për të ardhurat, shpenzimet, transfertat dhe operacionet që lidhen me rezultatin financiar të periudhës ushtrimore të mbyllur të krahasuar me periudhën e vitit të mëparshëm.

Nga auditimi i gjendjes së llogarive në pasqyrën e performancës rezultoi se, konstatimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është kryer konform rregullave. Rakordimi dhe kuadrimi është bërë si për llogaritë sintetike ashtu edhe për ato analitike.

Totali i të “*Ardhurave*” në Pasqyrën e Performancës F2 është i barabartë me totalin e shpenzimeve vjetore plus rezultatin e ushtrimit. Për vitin 2024 pasqyra paraqitet si më poshtë:

a- Të ardhurat (grupi A) = 1,175,788,880 lekë

b- Shpenzimet (grupi B) = 885,353,678 lekë

c- Rezultati i ushtrimit (Ilog.85)= 290,453,202 lekë

- Llogaria 85 “*Teprica ose deficiti i periudhës*” në Pasqyrën e Pozicionit Financiar (F1) rakordon me vlerën e kësaj llogarie të shënuar në kolonën nr. 132 të Formatit nr. 2 “*Pasqyra e Performancës*”.

Ndryshimi i gjendjes së llogarive të klasës 3 në Pasqyrën e pozicionit financiar në formatin F1 (diferenca midis tepricës më 31.12.2023 me 31.12.2024, përkatësisht 62,849,475 minus 74,618,946 konstatohet -11,769,471 lekë. Kjo vlerë konstatohet e barabartë me tepricën e llogarisë 63 “Ndryshim i gjendjeve të inventarit” në Pasqyrën nr. 2, “Pasqyra performancës financiare”.

2.1 Të ardhurat

Në kuptim të SKK1 Të ardhurat përfaqësojnë flukse hyrëse (rritjen e përfitimeve ekonomike) gjatë periudhës së raportimit, që çojnë në rritjen e aktiveve ose pakësimin e detyrimeve, si dhe që rrisin kapitalin e njësisë ekonomike.

Të ardhurat janë flukse hyrëse parash dhe përfaqësojnë rritjet e përfitimeve ekonomike bruto gjatë ushtrimit kontabël (periudhës së raportimit). Burim kryesor për të ardhurat në sektorin

publik janë nga aktiviteti buxhetor, mallrat e shërbimet (veçori për sektorin publik). Gjithashtu, burime të tjera janë interesat, dividendët, grantet. Të ardhurat rrisin përfitimet ekonomike në formën e rritjes së aktiveve dhe pakësimit të pasiveve (detyrimeve), të cilat kanë për rezultat shtimin e fondeve të veta.

- Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave sipas rakordimin me Degën e Thesarit paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Nr	Lloji i taksës, tarifës	Fakti i Vitit 2023	Plani Viti 2024	Fakti i vitit 2024	Realizimi në % 2024
A	Te Ardhura nga Burimet e Veta	114,825,131	111,663,000	127,196,859	114%
A.1	Te ardhura nga taksat lokale	11,023,841	13,690,000	12,335,728	90%
A.1.1	Taksa Vendore mbi biznesin e vogel	162,177	0	458,810	0%
A.1.2	Taksa mbi pasurine e paluajtshme	5,404,665	9,810,000	6,881,956	70%
A.1.2.1	Taksa mbi Ndertesen	4,894,519	7,318,000	6,352,825	87%
A.1.2.2	Taksa mbi token bujqesore	270,313	2,005,000	218,035	11%
A.1.2.3	Taksa mbi truallin	239,833	487,000	311,096	64%
A.1.3	Taksa Vendore ne sherbimin hotelier	40,250	150,000	24,500	16%
A.1.4	Taksa ndikimit ne infrastruktore nga ndertimet e reja	4,773,329	3,000,000	4,127,932	138%
A.1.5	Taksa e tabeles	643,420	730,000	842,530	115%
A.2	Te Ardhura nga taksat e ndara	52,757,369	41,600,000	59,420,055	143%
A.2.2	Taksa vjetore per qarkullimin e mjeteve te perdorura	15,607,384	15,000,000	15,597,333	104%
A.2.3	Taksa e rentes minerare	25,460,906	18,000,000	30,769,637	171%
A.2.4	Taksa mbi te ardhurat personale	11,689,079	8,600,000	13,049,085	152%
A.3	Te Ardhura nga Tarifa Vendore (jo tatimore)	51,043,921	50,873,000	52,928,939	104%
A.3.1	Tarifa e menaxhimit te mbetjeve	27,358,840	33,496,000	31,628,000	94%
A.3.1.1	Tarifa e pastrimit per familjet	-	2,747,000	1,355,000	49%
A.3.1.2	Tarifa e pastrimit per Institucionet	800,000	875,000	625,000	71%
A.3.1.3	Tarifa e pastrimit per biznesin	26,558,840	29,874,000	29,648,000	99%
A.3.3	Tarifa per ndricimin publik	444,200	1419,000	963,000	68%
A.3.3.1	Tarifa per ndricimin publik nga familjet	-	622,000	222,000	36%
A.3.3.2	Tarifa per ndricimin publik per institucionet	100,000	118,000	71,000	60%
A.3.3.3	Tarifa per ndricimin publik per biznesin	344,200	679,000	670,000	99%
A.3.4	Tarifa per gjelberimin	270,000	648,000	458,000	71%
A.3.4.1	Tarifa per gjelberimin nga familjet	-	207,000	89,000	43%
A.3.4.2	Tarifa per gjelberimin nga Institucionet	80,000	46,000	46,000	100%
A.3.4.3	Tarifa per gjelberimin nga bizneset	190,000	395,000	323,000	82%
A.3.5	Tarifa per sherbimet administrative te bashkise	12,774,830	13,910,000	17,535,939	126%
A.3.5.1	Tarifa per sherbimet administrative te bashkise	-	0	783,761	0%
A.3.5.5	Tarifa e licensimit te veprimtarive te transportit	1,352,490	1,000,000	975,020	98%
A.3.5.6	Tarifa e parkimit per mjetet e licensuar e vendparkim publik	70,000	120,000	325,705	271%
A.3.5.7	Tarifa per licence tregtimin naftes bruto e nenproduktet e saj	1,380,000	1,000,000	650,000	65%
A.3.5.8	Tarifa per pyjet dhe kullotat	9,707,740	11,440,000	14,474,703	127%
A.3.5.9	Tarifa per sherbimet shtese nga zjarrfiksj	-	50,000	28,000	56%
A.3.5.10	Tarifa per zenien e perdorimin e hapesires publike e fasadave	264,600	300,000	298,750	100%
A.3.6	Tarifa te institucioneve te arsimit,kultures,sportit etj	1,975,520	1,400,000	2,136,000	153%
	Qendra kulturore e femijëve	5,000			
A.3.6.8	Kopshtet	985,260	600,000	911,000	152%
A.3.6.9	Çerdhet	985,260	800,000	1,225,000	153%
A.3.10	Tarifa te tjera	0	0	208,000	0%
A.4	Te Ardhurat e tjera	8,219,811	5,500,000	2,512,137	46%
A.4.1	Qeraja nga asetet ne pronesi te bashkise	0	0	0	0%
A.4.7	Kundervajtjet administrative (Gjobat)	193,000	2,000,000	40,500	2%
A.4.8	Sekuestreime dhe Zhdemtime	0	0	800,000	0%
A.4.14	Te tjera (debitor ne vite)	8,026,811	3,500,000	1,671,637	48%
	TOTALI (A1+A2+A3+A4)	114,825,131	111,663,000	127,196,859	114%

Burimi: Drejtoria e Financës dhe DTTV, përpunuar nga grupi i auditimit

Konkluzion: Të ardhurat nga taksat dhe tarifat janë realizuar në shumën 127,198 mijë lekë nga 111,663 mijë lekë të parashikuara, ose në masën 114%. Referuar planifikimit dhe realizimit të Të ardhurave konstatohet se:

- Për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta si:

taksa mbi tokën bujqësore në masën 11%, *taksa e fjetjes në hotel* masën 16%, *taksa mbi truallin* në masën 64%, *tarifa e pastrimit për familjet* në masën 49%, *tarifa e gjelbërimit nga*

familjet në masën 43%, tarifa e ndikimit publik në masën 68%, tarifë për licencë për tregtimin e hidrokarbureve në masën 65%, tarifë për shërbimet shitesë nga zjarrfiksja në masën 56%, debitorë në vite në masën 48%

- Për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet mbi planin në masa të konsiderueshme si: taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja në masën 138%, taksa e tabelës në masën 115%, taksa e rentës minerare në masën 171%, Tatimi mbi të ardhurat personale në masën 152%, tarifa për parkimin publik në masën 271%, tarifat për pyjet dhe kullotat në masën 127%, tarifa për kopshte dhe çerdhe në masën 153%

Ky fakt tregon se planifikimi i të ardhurave në disa zëra të ardhurash nuk është bërë mbi baza reale dhe realizimi i viteve të mëparshme nuk është marrë në konsideratë në planifikim. Gjithashtu për një pjesë të ardhurash nuk është bërë punë e mjaftueshme për arkëtimin e tyre, gjë që ka sjellë ndikim negativ në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 5/a, dhe 6.

▪ Analiza e llogarive të të ardhurave në Formatin 2 “Pasqyra e performancës”

Nga auditimi i pasqyrës së performancës konstatohet se të ardhurat e realizuara gjatë vitit janë rezultat i të ardhurave nga taksat dhe tatimet në shumën 14,938,028 lekë, të ardhurave jotatimore në shumën 51,571,090 lekë dhe granteve korrente në shumën 1,109,279,762 lekë sipas të dhënave të pasqyruara në tabelën nr. 14 në aneks:

- Të ardhurat nga taksat dhe tatimet në shumën 14,938,028 lekë janë rezultat i të ardhurave të krijuara nga ana e Bashkisë Bulqizë nga “Tatim mbi te ardhurat personale” në shumën 458,810 lekë. Të ardhura nga “Taksa mbi përdorimin e mallrave dhe lejimit të veprimtarive” në shumën 7,908,358 lekë.

- Të ardhurat jotatimore në shumën 51,571,090 lekë përbëhen nga të ardhura të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia në shumën 13,451,302 lekë dhe nga të ardhurat sekondare e pagesa shërbimesh në shumën 38,119,788 lekë.

- Grantet korrente përbëhen nga financimet nga buxheti të cilat paraqiten në shumën 1,109,279,762 lekë, dhe përbëhen nga:

- Llogaria 7200 “Nga buxheti për NJQP (Qendrore)” përfaqëson financimin me grante nga buxheti i shtetit për funksionimin e institucionit në shumën 827,055,940 lekë,

- Llogaria 7201 “Nga buxheti për NJQP (Vendore)” përfaqëson financimin me grante nga buxheti i shtetit për funksionimin e institucionit në shumën 20,241,183 lekë,

- Llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” përfaqëson shumën që institucioni u detyrohet punonjësve për pagat, detyrimet ndaj shtetit për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimin e mbajtur për tatimin mbi pagat në shumën 57,285,261 lekë. Kjo shumë rakordon me detyrimet afatshkurtra të pasqyruara në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit objekt auditimi.

- Llogaria 7209 “Te tjera grante korrente te brendshme” në shumën 204,697,378 lekë

▪ Të ardhurat të hyra në llogarinë e Bashkisë sipas aktrakordimit me Degën e Thesarit paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Burimet e financimit të buxhetit vjetor

Në lekë

Nr	Institucioni	Të ardhura nga buxheti i shtetit		Të ardhurat e veta			Të ardhurat nga grantet dhe kreditë si burim financ për shp./investime		Të ardhura të tjera që janë planifikuar/realizuar nga subjekti		Totali i të ardhurave	
		Plan	Fakt	Plan	Perdorur	Realizim	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	Bashkia Bulqizë	1,242,864,576	1,092,028,257	111,663,000	28,825,807	127,298,868	0	0	0	0	1,370,163,444	1,120,854,064
Nga këto:												
1.1	Trans Pakushtëz	388,074,775	261,334,516								388,074,775	261,334,516
1.2	Trans Sektorial	188,941,363	178,941,383								188,941,363	178,941,383
1.3	Transf e Kushtëzu	524,054,126	509,958,046								524,054,126	509,958,046
1.4	Fonde SASPAK											
1.5	Të ardhura Vendo			111,663,000	28,825,807	127,298,868					127,298,868	28,825,807

parashikim të shpenzimeve përtej nevojave.

b- Llog.231 “Shpenzimet për investime” me financim nga buxheti i bashkisë dhe transfertat e kushtëzuar janë realizuar në masën 60%. Ky zë rezultoi i realizuar në nivel të ulët për arsye se fondet për investime me burim financimi të ardhurat e veta dhe transfertat e pakushtëzuar janë realizuar në masën 60% për arsye se një pjesë e investimeve janë prokuruar në fund të vitit 2024, duke mos u financuar ose financuar pjesërisht gjatë vitit 2024. Një pjesë e projekteve nuk janë realizuar dhe një pjesë tjetër janë planifikuar më shumë se vlera e kontratave. Ndërsa fondet për investime me burim financimi nga FSHZH dhe ministrinë e linjës janë realizuar në masën 99%.

▪ Mbi të ardhurat e trashëguara

Në lekë

Emërtimi	Të ardhurat e trashëguara të vitit paraardhës 2023	Të ardhurat e vitit 2024	Të ardhurat nga Fondi i Rindërtimit	Shpenzimet e vitit 2024	Te ardhura që mbeten për tu trashëguar në vitin pasardhës 2025
Bashkia Bulqize	141,794,312	704,315,006		610,896,018	235,213,300
Nga këto:					
-Transf.Pakushtëzuar	64,550,279	388,074,775		381,815,132	70,809,922
-Transf.Sektoriale	31,642,645	188,941,363		154,653,691	65,930,317
-Të Ardhura Vendore	45,601,388	127,298,868		74,427,195	98,473,061
-Fonde për Rindërtimin					

Referuar të dhënave të ardhurave të trashëguara mbështet edhe një herë faktin se bashkia Bulqizë ka patur fonde në dispozicion për rritjen e performancës së realizimit të investimeve dhe nuk ka argument justifikues për realizimin në nivele aq të ulët të fondeve për investime, përveç mungesës së kapaciteteve dhe punës së pa mjaftueshme për vënien në efikasitet të fondeve brenda vitit ushtrimor dhe rritjen e shërbimeve ndaj komunitetit në mënyrë që buxheti të jetë koherent me periudhën që financon. Buxheti i detajuar sipas burimeve të financimit paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Transferta	Fakt 2024	Pesha specifike në totalin e shpenzimeve faktike
Transferta e pakushtëzuar	381,815,132	34%
Transferta e pakushtëzuar sektoriale	154,653,691	14%
Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	74,427,195	7%
Transferta e kushtëzuar	509,958,046	45%
Totali	1,120,854,064	100%

Referuar të dhënave për vitin 2024 shpenzimet buxhetore janë përballuar nga të ardhurat e veta në shumën 74,427 mijë lekë ose në masën 7 %, nga transfertat e pakushtëzuar në shumën 381,815 mijë lekë ose në masën 34 %, transfertat e pakushtëzuar sektoriale në shumën 154,653 mijë lekë ose në masën 14 %, transfertat e kushtëzuar në shumën 509,958 mijë lekë ose në masën 45%.

▪ Vështirësia financiare

Në lekë

Nr	Subjekti	Transfertat e pakushtëzuar + ardhurat vendore	Transfertat për Rindërtimin	Fondet e kushtëzuara	Stoku i detyrimeve të prapambetura	Huatë	Statusi i gjendjes financiare i raportuar	Te ardhurat e përdorura për vitin 2024	Shpenzimet e realizuara për vitin 2024	Shpenzimet e miratuara për vitin 2024
	Bashkia Bulqize (1+2)	846,109,318		524,054,126	2,223,451			235,213,300	1,120,854,064	1,370,163,444
1	Fondet e Bashkisë	846,109,318				0	0.36%	235,213,300	610,896,018	846,109,318
1.1	Burimet e veta									
-	Transferta e pakushtëzuar	452,625,054			2,223,451			70,809,922	381,815,132	452,625,054
-	Transferta sektoriale	220,584,008						65,930,317	154,653,691	220,584,008
-	Të ardhurat vendore	172,900,256						98,473,061	74,427,195	172,900,256
1.2	Fonde për Rindërtimin									
2	Fondet e Kushtëzuara	0		524,054,126					509,958,046	524,054,126

Nga auditimi është konstatuar se detyrimet e papaguara (të akumuluarat) në fund të vitit 2024 paraqiten në vlerën 2,223,451 lekë dhe pesha specifike e stokut të detyrimeve të konstatuara të Bashkisë ndaj palëve të treta është 0.36 % kundrejt fondeve faktik prej 610,896,018 lekë. Kjo

situatë tregon se Bashkia Bulqizë konsiderohet në situatë normale të gjendjes financiare, pasi nuk e ka kaluar pragun 15% në fund të vitit ushtrimor. Gjithashtu raporti i detyrimeve ndaj fondeve vjetore faktike për shpenzime është nën nivelin prej 25%, kështu duke mos u konsideruar institucion në vështirësi financiare sipas nenit 56 “Vështirësia financiare” të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe Udhëzimit e MF nr. 35, datë 29.12.2023 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore” pika 33. Raportimi i detyrimeve në Ministrinë e Financës është bërë me shkresën nr. 1088 prot., datë 28.02.2025.

Në lekë

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Shpenzime vjetore faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpenzime vjetore faktike të NJVQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua afatgjatë	0		
a,1	Marrëvesh financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
a,2	Tituj të emetuar			
a,3	Garanci për të tretë			
b	Hua afatshkurtër	0		
b,1	Marrëvesh financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
b,2	Tituj të emetuar			
b,3	Garanci për të tretë			
II	Detyrimet e prapambetura	2,223,451		0.36%
Llog ekon	Emërtimi			
4864100	Vendime Gjyqesore			
4864200	Det.Prap. Sherbime	0		
4864201	D.P.Energji Elektirke	0		
4864300	Det.Prap.Mirembajtje	0		
4864400	Det.Prap. Investime	2,223,451		
4864500	Det.Prap.Rimbursim t.v.sh.	0		
4864600	Mallra			
4864900	Det.Prap.Te Tjera			
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore			
4864602	Det.Prap.Sig.Shendet	0		
4864603	Det.Prap.Ardh.Personal	0		
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera	0		
4864901	Paga	0		
4864902	Shpronesime	0		
4864903	Transerime te individët	0		
4864904	Transferime te Subjektet	0		
III	Totali (I+II)	2,223,451	610,896,018	0.36%

- *Raportet e monitorimit.*

Për vitin 2024 janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit, realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre në përputhje me kërkesat e ligjit organik të buxhetit. **Për vitin 2024** janë dërguar në MFE raportet e detajuara si më poshtë:

“Raport monitorimi janar-prill 2024” me shkresën nr. 4695 prot., datë 31.05.2024

“Raport monitorimi janar-gusht 2024” me shkresën nr. 8523 prot., datë 30.09.2024

‘Raport monitorimi janar-dhjetor 2024 me shkresën nr. 2041 prot., datë 28.02.2025.

Nga auditimi i raporteve të monitorimit rezulton se në to janë pasqyruar saktë treguesit e realizimit të buxhetit referuar dhe akt akordimit me degën e thesarit. Po kështu këto të dhëna janë pasqyruar në mënyrë të plotë dhe të saktë në raportin e konsoliduar për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të bashkisë.

▪ Shpenzimet njihen në të njëjtën periudhë ushtrimore dhe paraqiten në tabelën nr. 15 në aneks. Analiza e shpenzimeve sipas Formatit 2 “Pasqyra e performancës” në pasqyrat financiare paraqitet si më poshtë:

- Llogaria 600 “*Pagat dhe përfitimet e punonjësve*” në shumën 302,783,385 lekë përfaqëson pagat e personelit të përhershëm dhe të përkohshëm sipas detyrimeve të konstatuara dhe listë pagesa të deklaruara nga subjekti në sistemin e Tatimeve C@ts. Nga auditimi shpenzimeve për paga konstatohet se nuk ka diferenca mes shpenzimeve të deklaruara në pasqyrat financiare dhe rakordimit me degën e thesarit për këtë zë duke sjellë një pasqyrim të saktë të shpenzimeve për paga

Nga auditimi i ditarit të bankës konstatohet se gjatë vitit 2024 Bashkia Bulqizë ka kryer pagesa detyrimesh për vendime gjyqësore të formës së prerë për largim nga puna në shumën 2,672,047 lekë për paga për dy punonjës përkatësisht sipas vendimit gjyqësor nr. 320, datë 07.03.2024 në vlerën 988,760 lekë dhe vendimit gjyqësor nr. 428, datë 28.03.2024 në vlerën 1,152,000 lekë me pasojë efekt financiar negativ për buxhetin e bashkisë. Nga verifikimi i pagesave rezulton se për 2 vendimet e krijuara gjatë këtij viti është shlyer i gjithë detyrimi dhe nuk ka detyrime të prapambetura. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”.

- Llogaria 601 “*Kontribute të Sigurimeve*” në shumën 49,701,090 lekë përfaqëson shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, pjesa e kontributeve e paguar nga punëdhënësi sipas detyrimeve të konstatuara dhe listëpagesave të deklaruara nga subjekti në sistemin e Tatimeve C@ts. Nga auditimi shpenzimeve për sigurime shoqërore dhe shëndetësore konstatohet se nuk ka diferenca mes shpenzimeve të deklaruara në pasqyrat financiare dhe rakordimit me degën e thesarit

- Llogaria 602 “*Blerje mallra e shërbime*” në shumën 124,609,391 lekë përfaqëson shpenzimet operative të kryera nga institucioni në funksion të aktiviteteve, konstatohet se nuk ka diferenca mes shpenzimeve të deklaruara në pasqyrat financiare dhe rakordimit me degën e thesarit.

Për vitin 2024 shpenzimet për mallra dhe shërbime janë klasifikuar sipas nënllogarive të klasës 602. Nga auditimi i llogarisë sintetike 602 “Blerje mallra e shërbime” në pasqyrën e performancës financiare në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në shumën 124,609,391 lekë e cila rakordon me akt rakordimin e thesarit për këtë zë shpenzimesh. Nga auditimi i llogarive analitike të shpenzimeve u konstatua se ka keqklasifikime shpenzimesh mes nënllogarive të klasës 602. Diferencat mes tepricave të paraqitura në pasqyrë me aktrakordimin e thesarit në nivel analitik janë keqklasifikime mes nënllogarive me efekt denatyrim shpenzimesh përkatësisht si më poshtë.

a) Llogaria 602 “*Mallra dhe shërbime të tjera*” në shumën 2,607,870 lekë është paraqitur në pasqyrën e performancës vetëm si llogari sintetike. Në ditarin e shpenzimeve llogaria analitike nuk evidentohen shpenzime për këtë llogari. Konstatohet mosrakordim mes llogarisë sintetike dhe asaj analitike në shumën 2,607,870 lekë. Veprime në kundërshtim me UMF nr.8, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme*”, i ndryshuar

b) Llogaria 6020 “*Materiale zyre e të përgjithshme*” në shumën 5,290,340 lekë paraqitur në pasqyrën e performancës si llogari sintetike. Nga auditimi i llogarisë analitike **konstatohen** keqklasifikime shpenzimesh si “Shërbime eskavatori volvo”, “Projekte elektrike”, “Blerje katrama” të kontabilizuara në këtë llogari në shumën 760,800 lekë. Keqklasifikimet denatyrojnë paraqitjen e shpenzimeve në pasqyrën e performancës. Gjithashtu **konstatohet** mosrakordim mes llogarisë sintetike dhe asaj analitike në shumën 2,179,372 lekë. Veprime në kundërshtim me UMF nr.8, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e*

raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar

c) Nga auditimi i llogarisë 6021 “*Materiale dhe shërbime speciale*” **konstatohet** se llogaria sintetike pasqyrohet në shumën 52,732,662 lekë në pasqyrën e performancës ndërsa llogaria analitike ka të kontabilizuara shpenzime në shumën 5,426,595 lekë. Diferenca mes llogarisë sintetike dhe asaj analitike është në shumën 47,306,067 lekë. Mosrakordimi i llogarisë sintetike me atë analitike është kundërshtim me UMF nr.8, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme*”, i ndryshuar

d) Nga auditimi i llogarisë 6022 “*Shërbime nga të tretë*” **konstatohet** se llogaria sintetike pasqyrohet në shumën 25,053,827 lekë në pasqyrën e performancës ndërsa llogaria analitike ka të kontabilizuara shpenzime në shumën 52,912,939 lekë. Diferenca mes llogarisë sintetike dhe asaj analitike është në shumën -27,859,112 lekë. Mosrakordimi i llogarisë sintetike me atë analitike është kundërshtim me UMF nr.8, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme*”, i ndryshuar,

e) Nga auditimi i llogarisë 6023 “*Shpenzime transporti*” **konstatohet** se llogaria sintetike pasqyrohet në shumën 1,166,910 lekë në pasqyrën e performancës ndërsa llogaria analitike ka të kontabilizuara shpenzime në shumën 22,830,375 lekë. Diferenca mes llogarisë sintetike dhe asaj analitike është në shumën -21,663,465 lekë. Mosrakordimi i llogarisë sintetike me atë analitike është kundërshtim me UMF nr.8, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme*”, i ndryshuar,

f) Nga auditimi i llogarisë 6024 “*Shpenzime udhëtimi*” **konstatohet** se llogaria sintetike pasqyrohet në shumën 7,531,066 lekë në pasqyrën e performancës ndërsa llogaria analitike ka të kontabilizuara shpenzime në shumën 1,166,910 lekë. Diferenca mes llogarisë sintetike dhe asaj analitike është në shumën 6,364,156 lekë. Mosrakordimi i llogarisë sintetike me atë analitike është kundërshtim me UMF nr.8, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme*”, i ndryshuar,

g) Llogaria 6025 “*Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme*” në shumën 7,258,180 lekë përfaqëson shpenzime për shërbime mirëmbajtje.

h) Nga auditimi i llogarisë 6026 “*Shpenzime për qiramarrje*” **konstatohet** se llogaria sintetike pasqyrohet në shumën 988,760 lekë në pasqyrën e performancës ndërsa llogaria analitike ka të kontabilizuara shpenzime qiramarrje në shumën 7,258,180 lekë. Diferenca mes llogarisë sintetike dhe asaj analitike është në shumën 6,364,156 lekë. Mosrakordimi i llogarisë sintetike me atë analitike është kundërshtim me UMF nr.8, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme*”, i ndryshuar,

i) Nga auditimi i llogarisë 6029 “*Shpenzime të tjera operative*” **konstatohet** se llogaria sintetike pasqyrohet në shumën 21,979,776 lekë në pasqyrën e performancës ndërsa llogaria analitike ka të kontabilizuara shpenzime në shumën 12,967,763 lekë. Diferenca mes llogarisë sintetike dhe asaj analitike është në shumën 9,012,013 lekë. Mosrakordimi i llogarisë sintetike me atë analitike është kundërshtim me UMF nr.8, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme*”, i ndryshuar,

I. Llogaria 6041 “*Transferime korrente tek institucione qeveritare të ndryshme*” në shumën prej 13,010,784 lekë përfaqëson përgjithësisht transferta për klubin e sportit Bulqizë

II. Llogaria 6061 "Transferta të paguara nga institucionet e tjera e organet e pushtetit vendor" në shumën prej 395,249,028 lekë përfaqëson pagesa për ndihmën ekonomike dhe invaliditetin

V. Llogaria 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit" nuk është element që ndikon në rezultat, por nëpërmjet operacioneve të transferimit ndikon sipas rastit në shtesë apo pakësim të fondeve bazë të institucioneve. Nga veprimet kontabël të bëra nga institucioni dhe të pasqyruar në pasqyrën e performancës financiare ndryshimi i gjendjes është pasqyruar drejtë në shumën prej -11,769,471 lekë.

Nga auditimi i pjesës së tretë të pasqyrës së performancës "Teprica ose deficit i periudhës (Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor)" konstatohet se teprica është në shumën 290,435,202 lekë. Në këtë rezultat nuk janë marrë në konsideratë të ardhurat e transferuara në buxhet në shumën 26,956,107 lekë të cilat duhet të përfshihen në "Shpenzimeve të tjetra" në veprimet rregulluese për efekt të nxjerrjes së rezultatit. Ky veprim ka sjellë deformim të rezultatit, rrjedhimisht rezultati i periudhës nuk është i saktë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar.

▪ **Pasqyra e flukseve monetare (cash flow)**

Pasqyra financiare e flukseve monetare jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet në mjetet monetare apo ekuivalentet e tyre (llogaritë financiare të klasës 5). Në fund, kjo pasqyrë tregon shtimin apo pakësimin neto të mjeteve monetare të njësisë së qeverisjes së përgjithshme. Nga auditimi i Pasqyrës së flukseve monetare për periudhën objekt auditimi konstatohet se nuk ka diferencë mes të hyrave nga sponsorizimet nga të tretët dhe rakordimeve me thesarin lidhur me grantet e disbursuara gjatë periudhës ushtrimore. Nga auditimi konstatohet se të ardhurat jotatimore të kontabilizuara gjatë vitit janë në shumën 66,509,118 ndërsa të ardhurat tatimore në pasqyrën e rezultatit pasqyrohen në shumën 51,571,090 lekë. Mosrakordimi i të ardhurave të së njëjtës natyre konstatohet në shumën 14,938,028 lekë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF me nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar

Efekti në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mosrakordimit të plotë dhe të saktë të llogarive kontabël në pasqyrat financiare jep një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të pasqyrës së rezultatit të subjektit. Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 "Paraqitja E Pasqyrave Financiare", paragrafi 27 i SNKSP 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare". Gjithashtu paraqitja në këtë mënyrë e veprimeve kontabël nuk mbështetet në parimet bazë të kontabilitetit publik sipas Udhëzimi të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar pika 5.

Nga auditimi i pjesës së dytë të pasqyrës së flukseve "Veprimtaritë e Investimeve" konstatohet se daljet e mjeteve monetare "Për detyrime e investime të vitit ushtrimor" pasqyrohen në shumën 395,373,625 lekë, ndërsa në pasqyrën statistikore "Investimet dhe Burimet e investimeve" shpenzimet për investime pasqyrohen në shumën 231,558,898 lekë. **Konstatohet** një diferencë në shumën 163,814,727 lekë. Efekti në pasqyrat financiare në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mosrakordimit të plotë dhe të saktë të llogarive kontabël në pasqyrat financiare jep një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të fluksit monetar të subjektit. Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare", paragrafi 27 i SNKSP 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare". Gjithashtu paraqitja në këtë mënyrë e veprimeve kontabël nuk mbështetet në parimet bazë të kontabilitetit

publik sipas Udhëzimi të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar pika 5

Nga auditimi **konstatohet se** gjatë periudhës kontabël janë paguar mjete monetare në shumën 52,071,268 lekë, kjo shumë e investuar nuk është pasqyruar në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalit e vet” në pasqyrën e pozicionit financiar e cila ka mbetur e pandryshuar gjatë periudhës kontabël.

▪ Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto

Pasqyra financiare individuale e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve dhe fondeve neto të njësisë së qeverisjes së përgjithshme gjatë vitit ushtrimor të mbyllur raportues.

Nga auditimi i “*Pasqyrës së ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto*” konstatohet se të dhënat e kësaj pasqyre rakordojnë vetëm për totalin e fondeve neto me pasqyrën e pozicionit financiar në rubrikën C.

Konstatohet se në pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet të dhënat e paraqitura nuk rakordojnë me të dhënat e llogarive kontabël për të dhënë ndryshimet që kanë pësuar gjatë periudhës kontabël fondet neto.

Konstatohet se llogaria 85 “Rezultatet e vitit ushtrimor” në pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto pasqyrohet në shumën 0 lekë ndërsa në pasqyrën e pozicionit financiar pasqyrohet në shumën 290,435,202 lekë.

- Llogaria 115 “*Nga fondet e veta të investimeve*” në pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto pasqyrohet në shumën 101,830,341 lekë ndërsa në pasqyrën e pozicionit financiar pasqyrohet në shumën 442,152,048 lekë.

- Llogaria 106 “*Teprica e granteve kapitale te huaja*” në pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto pasqyrohet në shumën 4,088,044 lekë ndërsa në pasqyrën e pozicionit financiar pasqyrohet në shumën 117,223,816 lekë.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimi i MF nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*” i ndryshuar.

▪ Pasqyra e investimeve dhe burimeve të financimit

Nga auditimi i pasqyrës së investimeve dhe burimeve të investimeve konstatohet se kjo pasqyre statistikore nuk është e plotësuar në mënyrë të saktë, në mënyrë që të sjellë një pasqyrim të plotë të të gjitha transaksioneve që kanë ndodhur gjatë vitit lidhur me burimet e financimit dhe investimet.

Konstatohet se veprimet kontabël në kredi të llogarisë 231 nuk rakordojnë me veprimet në debi të klasës 2 pas kapitalizimeve, me një diferencë në shumën 24,514,182 lekë. Nga auditimi konstatohet se në llogarinë 105 grante të brendshme kapitale nga buxheti janë akorduar 204,001,812 lekë ndërsa sipas pasqyrës së flukseve monetare akordim fonde buxhetore për shpenzime kapitale (+) janë në shumën 427,559,455 lekë konstatohet një diferencë në shumën 223,557,643 lekë. Kjo diferencë i përket fondeve të trashëguara. Akordimet e kontabilizuara janë paraqitur në shumën neto, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar.

Përsa më sipër ngarkohet me përgjegjësi: z. R. B. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues, zj. Sh. O. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Kontabilitetit, dhe z. R. H. me detyrë Drejtor i të Ardhurave.

2.3 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.
2. Realizimi i programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor.
3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

➤ Kuadri ligjor dhe nënligjor i verifikimit të zbatimit rekomandimeve

Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe të Udhëzimit të Kryetarit të KLSH nr. 1, datë 04.11.2016 “Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dhe dokumentacioni që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH”.

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

- Detyrat e lëna nga auditimi i mëparshëm, dërguar me shkresën e KLSH-së, 897/7 prot., datë 18.09.2024.
- Korrespondenca shkresore e ndjekur nga Bashkia Bulqizë dhe KLSH.
- Dokumentacioni shoqërues dhe justifikues për kryerjen e rekomandimeve.
- Dokumentacioni i mbajtur nga strukturat e bashkisë dhe raportimet në Këshill Bashkiak për këtë qëllim, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezultoi se:

I. Respektimi i afatit prej 20 ditësh, për informimin e KLSH-së mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Në mos zbatim të nenit 15, gërma “j”, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Bashkia Bulqizë nuk **ka kthyer përgjigje** në KLSH, **duke mos respektuar kështu afatin 20 ditor** të informimit në lidhje me planin e veprimeve të ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna:

Referuar shkresës nr. 897/7 prot., datë 18.09.2024, për dërgimin e Raportit Përfundimtar dhe rekomandimeve është plotësuar afati 6 mujor për të raportuar lidhur me plotësimin e përcaktimeve të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2, “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”. Sipas verifikimit Bashkia Bulqizë nuk **ka kthyer përgjigje**, por nga KLSH është programuar auditim financiar në Bashkinë Bulqizë në datë 25.04.2025, ku përfshihet si drejtim auditimi zbatimi i rekomandimeve, datë e cila është në kufijtë e periudhës 6-mujore të kthimit të përgjigjes.

III. Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak Bulqizë, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna:

Bashkia Bulqizë nuk ka hartuar planin e veprimit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, dhe si rrjedhim **nuk ka raportuar** rregullisht pranë Këshillit Bashkiak, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5, ku përcaktohet që: “Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i

njesisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njesisë”.

IV. Rekomandimet e KLSH-së:

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në Bashkinë Bulqizë administruar në KLSH me nr. 358/6 prot., datë 12.06.2024, janë rekomanduar gjithsej:

- 15 masa organizative, pranuar nga subjekti;
- 1 masë për arkëtim të detyrimeve (të ardhura të munguara) nga taksat dhe tarifave vendore në vlerën 99,933,852 lekë;
- 4 masa për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore me efekt mungesë të ardhurash në vlerën 42,132,697 lekë.

V. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH-së:

Nuk ka shkresë nga Bashkia Bulqizë për refuzimin e rekomandimeve, rrjedhimisht statusi i rekomandimeve është “i pranuar” të cilat paraqiten si më poshtë:

Masat	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
Masa organizative	14	14	0
Masa për arkëtim detyrimesh nga taksa e tarifa të ardhura të munguara	1 99,933,852	1 99,933,852	0
Masa për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave	4 42,132,697	4 42,132,697	0
Masa për eliminim e efekteve në administrimin e fondeve publike e 3E	1	1	
Totali	20	20	0

VI. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e Bashkisë Bulqizë:

Rekomandime	Rekomanduar	Të zbatuara	Të zbatuara pjesërisht	Në proces zbatimi	Të pa zbatuara
Masa organizative	14	7	1	1	5
Masa për arkëtim detyrimesh nga taksa e tarifa të ardhura të munguara	1 99,933,852			1 99,933,852	
Masa për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave	4 3,577,360+5,800,000+1,273,765+31,482,313		2 32,756,078		2 9,377,360
Masa për eliminim e efekteve në administrimin e fondeve publike e menaxhimin me 3E	1	1			
Totali	20	8	3	2	7
Totali në %	100%	40%	15%	10%	35%

5. Mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e fundit në Bashkinë Bulqizë

Në përfundim të auditimit janë rekomanduar masat si vijon:

Në auditimin e fundit KLSH i ka rekomanduar Bashkisë Bulqizë 20 masa, të cilat janë pranuar plotësisht.

A. MASA ORGANIZATIVE.

1.1.Rekomandimi: Bashkia Bulqizë, Drejtoria e Financës, të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura duke hartuar plane të detajuara për këtë qëllim dhe të raportojë periodikisht në MFE vlerat e detyrimeve të prapambetura faktike.

Menjëherë dhe në vijimësi

Rekomandimi: i pranuar.
Koment i grupit të auditimit: Nga verifikimi i dokumentacionit financiar dhe të pagesave nëpërmjet bankës rezulton se, Bashkia Bulqizë nga vlera e detyrimeve për fatura të pa likuiduara prej 7,078 mijë lekë që i përket vlerës pjesore të tre projekteve të investimit akumuluar në fund të vitit 2023 ka likuiduar vlerën prej 4,855,217 lekë të 2 objekteve të investimit dhe ka mbetur vlera prej 2,223,451 lekë detyrim i pa u likuiduar për projektin e

investimit me objekt: “Ndërtim ujësjellësi fshati Peladhi” për shkak të konflikteve të pronësisë të pretenduar nga banorët.

Statusi i rekomandimit: në proces zbatimi.

2.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Bulqizë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për identifikimin e gjendjes së aseteve të mbetura pa regjistruar, të cilat i janë transferuar në pronësi në mënyrë përfundimtare, si dhe të fillojë përgatitja e dokumentacionit tekniko ligjor të secilit prej tyre për të vijuar me aplikimet përkatëse për pajisje me çertifikatë pronësie.

Menjëherë

Rekomandimi: i pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nuk është nxjerrë asnjë urdhër nga titullari për ngritjen e një grupi pune për identifikimin e gjendjes së aseteve të transferuara dhe përgatitjen e dokumentacionit tekniko ligjor për aplikimet në ASHK dhe për këtë arsye nuk është kryer asnjë veprim për hipotekimin e pasurive të paluajtshme për këtë periudhë.

Statusi i rekomandimit: pa zbatuar.

3.1.Rekomandimi: Nga Drejtoria e Financës në Bashkinë Bulqizë të merren masat për krijimin dhe mbajtjen e llogarive analitike për llogaritë 31 “Materiale” dhe 32 “Inventar i imët”, pjesë e klasës 3 “Gjendja e inventarit qarkullues”, në mënyrë që të ketë një vlerë të identifikuar për secilën prej tyre, si dhe të paraqiten në mënyrë të saktë dhe reale vlerat e llogarive 31 “Materiale” dhe 32 “Inventar i imët” në pasqyrën e pozicionit financiar. Gjithashtu të kryhen sistemimet përkatëse për vlerat 452,864 lekë dhe 4,441,818 lekë, që i takojnë përkatësisht llogarive 31 dhe 32.

Me mbylljen e pasqyrave viti 2024

Rekomandimi: i pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga shqyrtimi i dokumentacionit financiar të vënë në dispozicion rezulton se është bërë identifikimi i diferencave përkatëse për llog. 31 “Materiale” dhe llog. 32 “Inventar i imët” dhe janë sistemuar gjatë vitit 2024, duke u paraqitur saktë në PF.

Statusi i rekomandimit: i zbatuar.

4.1.Rekomandimi: Nga Drejtoria e Financës në Bashkinë Bulqizë të merren masat që të paraqiten në mënyrë të saktë dhe reale vlerat e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” dhe të kryhet sistemimi i vlerës prej 2,000 lekë, me qëllim paraqitjen e gjendjes reale të kësaj llogarie.

Me mbylljen e pasqyrave viti 2024

Rekomandimi: i pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga shqyrtimi i dokumentacionit financiar të vënë në dispozicion rezulton se me mbylljen e pasqyrave financiare është bërë sistemimi kontabël i llog.468 “Debitorë të ndryshëm” për vlerën e deviacionit prej 2000 lekë.

Statusi i rekomandimit: i zbatuar

5.1.Rekomandimi: Nga Drejtoria e Financës në Bashkinë Bulqizë të merren masat që të kontabilizohet vlera prej 7,078,668 lekë dhe të kryhen veprimet e nevojshme në mënyrë që në fund të vitit ushtrimor të paraqiten në mënyrë të saktë gjendjet e llogarive 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” në pasqyrën e pozicionit financiar.

Me mbylljen e pasqyrave viti 2024

Rekomandimi: i pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga shqyrtimi i dokumentacionit financiar të vënë në dispozicion rezulton se me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2024 është bërë kontabilizimi i saktë i detyrimeve për furnitorë në llog. kundërparti 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në aktivin e pasqyrës së pozicionit financiar.

Statusi i rekomandimit: i zbatuar.

6.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Bulqizë, të marrë masa që në vijimësi duke u bazuar në dokumentet përkatëse financiare dhe ligjore të saktësojë gjendjen e studimeve dhe projekteve përsa i takon llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”, duke verifikuar, saktësuar dhe analizuar vlerën prej 4,865,108 lekë të paraqitur në pasqyrat financiare, si dhe të disponojë informacionin e nevojshëm lidhur me vënien në zbatim të këtyre projekteve dhe studimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Rekomandimi: i pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga shqyrtimi i dokumentacionit financiar të vënë në dispozicion rezulton se me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2024 është bërë identifikimi i 9 projekt-studimeve vlerës prej 4,865,108 lekë dhe sistemimi kontabël në llogaritë përkatëse të klasës 2 të AAGJM duke ja shtuar vlerës së aktivitetit përkatës.

Statusi i rekomandimit: i zbatuar

7.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Bulqizë, të marrë masa që në vijimësi të paraqesë në mënyrë të saktë dhe reale gjendjen e llogarisë 210 “Toka, troje, Terrene” në mbyllje të vitit ushtrimor në pasqyrën formati 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata, vlera neto” dhe në pasqyrën e pozicionit financiar, duke marrë në konsideratë që kjo llogari nuk i nënshtrohet amortizimit. Gjithashtu të realizohen sistemimet përkatëse për vlerën 267,179 lekë të kësaj llogarie.

Me mbylljen e pasqyrave viti 2024

Rekomandimi: i pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga shqyrtimi i dokumentacionit financiar të vënë në dispozicion rezulton se me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2024 është bërë sistemimi kontabël të vlerës prej 267,179 lekë, duke hequr vlerën e amortizimit të llogaritur gabim të aktiveve në llog. 210 “Toka, troje, Terrene” dhe reflektuar në gjendjen e kësaj llogarie në PF.

Statusi i rekomandimit: i zbatuar

8.1.Rekomandimi: Bashkia Bulqizë, të marrë masa që të krijojë një grup pune me specialistë të fushës, me qëllim transferimin në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” sh.a të 1 (një) artikulli të mbetur pjesë të inventarit të aktiveve, duke ndjekur procedurat e marrjes në dorëzim të firmosura nga të dy palët, si dhe të kryej veprimet kontabël në mbyllje të pasqyrave financiare duke zbritur e mbetur prej 225,599,068 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Rekomandimi: i pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se me mbylljen e vitit ushtrimor i vitit 2024 nuk është bërë kalimi kapital i projektit të investimit me objekt: “Ndërtim Ujësjiellësi i disa Fshatrave të NjA Gjoricë Faza e II” në vlerën 225,599,068 lekë, pasi për këtë objekt investimi nuk është bërë marrja në dorëzim përfundimtare, si dhe likuidimi përfundimtar është bërë në vitin 2024. Për këto arsye nuk janë kryer veprimet e kalimit kapital të këtij aktivi tek UK sha Dibër dhe për rrjedhojë nuk janë bërë dhe veprimet kontabël në PF në mbyllje të vitit 2024.

Statusi i rekomandimit: pa zbatuar

9.1.Rekomandimi: Bashkia Bulqizë të marrë masa që për aktivet të cilat kanë qenë pjesë e llogarisë 24 “Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara” të konsideruara si mjete të dëmtuara për vlerën 11,955,591 lekë, të bëjë grupimin e tyre si dhe të ngrejë komision për asgjësimin dhe vlerësimin si mbeturinë (skrap) me qëllim shitjen e tyre duke realizuar të ardhura. Kjo si rrjedhojë edhe e faktit që këto aktive nuk figurojnë më si pjesë e kësaj llogarie në kontabilitet, pasi janë bërë veprimet e amortizimit total të tyre duke bërë që në fund të vitit 2023 këto aktive të rezultojnë në vlerën 0 lekë, pra të amortizuara totalisht.

Menjëherë

Rekomandimi: *i pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nuk janë kryer procedurat për vlerësimin, nxjerrjen jashtë përdorimit dhe zberthimin në pjesë të automjeteve që nuk funksionojnë, si dhe procedurat e asgjësimit dhe vlerësimin e shitjen pjesëve të kthyer në mbeturinë (skrap).*

Statusi i rekomandimit: *pa zbatuar*

10.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Bulqizë, me qëllim paraqitjen reale të amortizimit dhe raportimit financiar të llogarive pjesë e klasës 21 “Aktivet Afatgjata materiale”, të marrë masat që:

- Të llogaritet amortizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale duke përdorur normat e sakta të amortizimit sipas llojit specifik të aktivitetit dhe sipas rregullave të llogaritjes së tij, për secilën kategori aktivesh sipas kuadrit ligjor dhe udhëzimit përkatës.

- Të kryhen siç duhet dhe në mënyrë të qartë sistemimet / lëvizjet midis llogarive, duke u kujdesur që pas realizimit të tyre efekti të jetë 0 (zero), për aq kohë sa konsiderohen vetëm sistemime midis llogarive të aktiveve pjesë e llogarive të klasës 21 “Aktivet Afatgjata materiale”.

- Të kryhet sistemimi përsa i takon vlerës 200,483,667 lekë duke u siguruar që amortizimi total i akumuluar i aktiveve në mbyllje të vitit ushtrimor të paraqitet në vlerë të saktë dhe reale.

Me mbylljen e pasqyrave viti 2024

Rekomandimi: *i pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Nga shqyrtimi i dokumentacionit financiar i përgatitjes së PF në mbyllje të vitit 2024 u konstatua se janë llogaritur amortizimet e aktiveve sipas normave të miratuara si dhe janë kryer veprimet e sistemimit kontabël për vlerën totale të amortizimit vjetor prej 200,483,667 lekë për diferencë në minus apo plus me vlerat përkatëse për secilin grup aktivesh të AAMGJ.*

Statusi i rekomandimit: *i zbatuar*

11.1.Rekomandimi: Nga Drejtoria e Financës në Bashkinë Bulqizë të merren masat që në vijimësi:

- Të kryhet procesi i inventarizimit duke mundësuar realizimin e të gjitha fazave të tij, si inventarizimi fizik, vlerësimi i gjendjes së aktiveve dhe nxjerrja jashtë përdorimit për aktivet sipas nevojës, duke u bazuar në gjendjen e tyre reale të amortizimit, të evidentuar gjatë procesit të inventarizimit.

- Të hartohet dhe miratohet një regjistër aktivesh ku të paraqiten të gjitha aktivet që zotëron apo ka në administrim Bashkia Bulqizë, si dhe të hartohet një rregullore specifike për ndjekjen e procedurave të ruajtjes, mbrojtjes dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

Rekomandimi: *i pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Nga shqyrtimi i dokumentacionit financiar të vënë në dispozicion rezulton se për vitin 2024 nuk është kryer inventar fizik i aktiveve. Ndërsa libri i aktiveve nuk është plotësuar sipas formatit të miratuar.*

Statusi i rekomandimit: *pa zbatuar*

12.1.Rekomandimi: Nga Drejtoria e Financës në Bashkinë Bulqizë të merren masat që të kryhen sistemimet përkatëse për vlerën 7,771,619 lekë, si dhe të paraqitet në mënyrë të sakte dhe reale gjendja e llogarive 401 – 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në fund të vitit ushtrimor.

Me mbylljen e pasqyrave viti 2024

Rekomandimi: *i pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Nga shqyrtimi i dokumentacionit financiar të vënë në dispozicion rezulton se vlera prej 7,771,619 lekë e kontabilizuar gabim në llog.401-404“Furnitorë e llogari të lidhura me to” është sistemuar në kontabilitet.*

Statusi i rekomandimit: *i zbatuar*

13.1.Rekomandimi: Nga Drejtoria e Financës në Bashkinë Bulqizë të merren masat që në vijimësi të paraqiten në mënyrë të saktë dhe reale vlerat e llogarive të klasës 7 në pasqyrën e performancës financiare, në mënyrë që të kuadrojnë me akt-rakordimet e thesarit.

Me mbylljen e pasqyrave viti 2024

Rekomandimi: *i pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Nga shqyrtimi i dokumentacionit financiar të vënë në dispozicion rezulton se për hartimin e pasqyrës së performancës tek PF të viti 2024 plotësimi i gjendjeve të llogarive të klasës 7 nuk është i saktë dhe nuk është bazuar mbi vlerat e paraqitura në aktrakordimin me thesarin.*

Statusi i rekomandimit: *pa zbatuar*

14.1 Rekomandimi: Sektori përgjegjës për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave pranë Bashkisë Bulqizë, të marrë masa për hartimin e planeve të menaxhimit apo mbarështimit për secilën prej ngastrave që ka në pronësi përpara dhënies së tyre në përdorim, si dhe të lidhë kontratat për dhënie në përdorim duke respektuar llojin e përdorimit të planifikuar në plane menaxhimi.

Në vijimësi

Rekomandimi: *i pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nga Bashkia Bulqizë ka zhvilluar procedurën e prokurimit për shërbimin me objekt: “Për hartimin e planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore kullosore Zerqan, NjA Zerqan, Bashkia Bulqizë” në datën 26.05.2025 dhe është në fazë të pritjes së ankimeve të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në tender.*

Për 9 subjekte minerare që ushtrojnë aktivitetet në parcelat e fondit pyjor/kullosor në përdorim/pronësi të bashkisë Bulqizë, kanë filluar procedurat e dhënies me qira të këtyre parcelave subjekteve që i kanë në shfrytëzim. Për këtë kanë dalë urdhrat e titullarit 33-35, datë 27.06,2024, është marrë VKB nr.202, datë 30.04.2025 për dhënie në përdorim të parcelave, pjesë e fondit pyjor/kullosor kundrejt qirave 9 subjekteve që ushtrojnë aktivitetet mineral. Janë në fazën e lidhjes së kontratave.

Statusi i rekomandimit: *zbatuar pjesërisht*

B. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE

1.1.Rekomandimi: Bashkia Bulqizë, Drejtoria e të Ardhurave, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e tyre në vlerën 99,933,852 lekë.

Menjëherë

Rekomandimi: *i pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave rezulton se nga detyrimi në vlerë progresive prej 99,933,852 lekë në fund të vitit 2023 nga taksapaguesit debitorë është arkëtuar vlera prej 5,121,293 lekë gjatë vitit 2024. Nga Drejtoria e të Ardhurave gjatë vitit 2024 nuk janë nxjerrë njoftim-vlerësimet për detyrimet për taksapaguesit debitorë në vite. Janë marrë masa shtërnguese si bllokim llogarie në bankat e nivelit të dytë me shkresat nr.prot. 6327-6494 në datën 20.12.2023 për 166 taksapaguesit të biznesit.*

Statusi i rekomandimit: *proces zbatimi*

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH

1.1 Rekomandimi: Bashkia Bulqizë, Drejtoria e të Ardhurave të marrin masa për identifikimin e saktë të listave të debitorëve, detyrimi i të cilëve nuk është kontabilizuar dhe të dërgojë pranë Drejtorisë së financës listat përkatëse për kontabilizimin e detyrimit prej 3,577,360 lekë.

Menjëherë

Rekomandimi: *i pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore rezulton se nuk është marrë asnjë masë për zbërthimin e deviacionit në vlerën 3,577,360 lekë dhe identifikimin e debitorëve që i përkasin kësaj vlere. Për këtë arsye nuk është kryer asnjë veprim për sistemimin në kontabilitet të vlerës 3,577,360 lekë.*

Statusi i rekomandimit: *pa zbatuar*

2.1.Rekomandimi: Bashkia Bulqizë, Drejtoria e të Ardhurave, të marrë masa që me shkresë zyrtare të dërgohen në Drejtorinë e Financës për kontabilizim detyrimet e papaguara, si dhe për pajisjen me Autorizim/Licencë për shitje karburanti dhe të zbatohen të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin nga 7 subjekte të vlerës 5,800,000 lekë.

Menjëherë

Nr.	Subjekti	Nipt	Afatit Autorizimit		Detyrimi për autorizimin	Pagesat e kryera	Diferenca
			Fillimi	Mbarimi			
1	"M "shpk	L.....T	22.05.2015	21.05.2020	1,000,000	0	1,000,000
2	"XH O"shpk	L.....A	01.02.2015	31.01.2020	1,000,000	0	1,000,000
3	"M M"shpk	J.....I	15.05.2015	14.05.2020	1,000,000	0	1,000,000
4	"J" shpk	K.....I	26.05.2013	25.05.2018	1,000,000	0	1,000,000
5	"R O"shpk	L.....P	19.11.2020	13.12.2024	1,000,000	600,000	400,000
6	"T D"shpk	L.....S	24.09.2021	23.09.2022	1,000,000	200,000	800,000
7	"XH "shpk	L.....Q	03.11.2021	03.11.2022	1,000,000	400,000	600,000
SHUMA					7,000,000	1,200,000	5,800,000

Rekomandimi: *i pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore rezulton se për 7 subjekte që ushtrojnë aktivitet shitje me pakicë hidrokarbure me vlerë debitorë prej 5,800,000 lekë për tarifën e autorizim/leje*

aktiviteti, nga të cilat nuk ka pagesa gjatë vitit 2024. Vlera debitorëve prej 5,800,000 lekë nuk është kontabilizuar nga Drejtoria e Financës në llog.468 “Debitorë të ndryshëm”.

Statusi i rekomandimit: pa zbatuar

3.1.Rekomandimi: Bashkia Bulqizë, Drejtoria e të Ardhurave, të marrë masa që me shkresë zyrtare të dërgohen në Drejtorin e Financës për kontabilizim listat me vlerat e taksës së llogaritur dhe të zbatohen procedurat ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit për 44 persona me vlerë 1,273,024 lekë.

Menjëherë

Rekomandimi: i pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave rezulton se për 44 persona debitorë në vlerën 1,273,024 lekë për TNI janë bërë njoftime për shlyerje detyrimi me shkresat nr.prot.719-743, datë 12.02.2024. Nga Drejtoria e Financës nuk është bërë kontabilizimi i vlerës debitorë prej 1,273,024 lekë në llog.468 “Debitorë të ndryshëm”. Nga vlera debitorë prej 1,273,024 lekë e krijuar gjatë vitit 2023 kanë paguar 4 individë në vlerën 332,765 lekë.

Statusi i rekomandimit: zbatuar pjesërisht

4.1. Rekomandimi: Bashkia Bulqizë, Drejtoria e të Ardhurave, të marrë masa që me shkresë zyrtare të dërgohen në Drejtorin e Financës për kontabilizim listat me vlerat e qirave të papaguara dhe të zbatohen të gjitha procedurat administrative e ligjore për të kërkuar zbatimin e kontratave dhe arkëtimin nga 7 subjekte të vlerës 31,482,313 lekë.

Menjëherë

Nr	Subjekti	Kontrata		Sip ha	Vlera kontratës	Detyrimi Deri 31.12.23	Likujduar Deri 31.12.23	Pa likujduar 31.12.23	Paguar gjatë vitit 2024	Gjendja në në fund të vitit 2024	Datat e likujdimit
		Nr	Date								
1	E	1824	15.05.2017	0.8	153,845	923,070	163,920	759,150		759,150	
2	C P 2016	1218	05.04.2017	8.9	217,510	1,305,060	780,000	525,060		525,060	28.05.2024
3	A-T	435	08.02.2017	0.52	72,925	510,475	72,925	437,550	437,550		
4	D T	4082/2	15.11.2017	2.8	398,567	2,391,402	0	2,391,402		2,391,402	
5	G 1	1203	04.04.2017	0.47	266,072	1,330,360	550,017	780,343	780,343		19.03.2024
6	G 2	1202	04.04.2017	2.3	125,020	750,120	181,759	568,361	568,361		19.03.2024
7	T 2003	260	06.09.2012	7.36	3,488,345	34,883,450	8,520,590	26,362,860		26,362,860	
	Totali			23.15		42,093,937	10,269,211	31,824,726	1,786,254	30,038,472	

Rekomandimi: i pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore rezulton se për 7 subjekte qiramarrës të parcelave nga fondi pyjor/kullor me vlerë debitorë prej 31,824,726 lekë për tarifën e qirasë, kanë paguar 3 subjekte në vlerën 1,786,254 lekë dhe vlera e mbetur debitorë progresive debitorë në fund të vitit 2024 është 30,038,472 lekë. Vlera e debitorëve prej 31,824,726 lekë nuk është kontabilizuar nga Drejtoria e Financës në llog.468 “Debitorë të ndryshëm”.

Statusi i rekomandimit: zbatuar pjesërisht

D. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Bulqizë të marrë masa që në të ardhmen, vendimet që lidhen me largimin nga puna të punonjësve të jetë të argumentuar, të mbështetur në ligj, si dhe të respektojnë afatet e njoftimit për largimin.

Në vijimësi

Rekomandimi: *i pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nuk ka largime nga puna për vitin 2024.*

Statusi i rekomandimit: *i zbatuar*

E. MASA DISIPLINORE

Për të gjithë punonjësit trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga KLSH-ja nuk është rekomanduar dhënia e masës disiplinore konkrete, pasi shkeljet e konstatuara dhe të evidentuara janë nën materialitetin e përcaktuar nga grupi i auditimit. **Lihet në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë**, fillimi ose jo i procedurave disiplinore në referim të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nënpunësin Civil”, VKM nr. 115, datë 05.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bazuar në kontratën individuale të punës.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

- Bashkia Bulqizë nuk **ka kthyer përgjigje** në KLSH, **duke mos respektuar kështu afatin 20 ditor** të informimit në lidhje me planin e veprimeve të ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve. Gjithashtu nuk ka respektuar afatin 6-mujor të kthimit të përgjigjes për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve. Strukturat drejtuese, kanë vepruar dhe kanë marrë masat, por jo të mjaftueshme për zbatimin e rekomandimeve. Niveli i pranimin të rekomandimeve është 100% dhe realizimi në masën 40 %.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: zj. F. M. në funksionin e Kryetares së Bashkisë Bulqizë, z. H. P. në funksionin e nën/Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, z. R B me detyrë Drejtor Financës e Shërbimeve dhe z. R. H. me detyrë Drejtor i të Ardhurave.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit u konstatua se Bashkia nuk ka procedura të dokumentuara për raportimin e shkeljeve të etikës dhe për marrjen e masave ndëshkuese. Gjithashtu, mungesa e mekanizmave të dedikuara për trajtimin e ankesave për korrupsion tregon për një dobësi në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe transparencës institucionale.

Bashkia nuk disponon një plan vjetor rekrutimi, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në planifikimin dhe menaxhimin efikas të burimeve njerëzore. Rekrutimet bëhen sipas nevojave të momentit, pa një analizë paraprake të burimeve dhe nevojave strategjike.

Po ashtu, mungon vlerësimi i rreziqeve për mashtrime, si dhe kryerja e vlerësimeve periodike të ekspozimit ndaj tyre. Gjithashtu, Bashkia nuk disponon një sistem të brendshëm raportimi për shkeljet e rregullave apo raste të mundshme mashtrimi, duke kufizuar aftësinë e saj për të ndërhyrë në kohë dhe për të mbrojtur burimet publike. Nuk është hartuar gjurmë auditimi për proceset kryesore të punës. Mungesa e sistemeve të informacionit (IT) funksionale përtej platformave qendrore si APP dhe SIFQ, si dhe mungesa e procedurave për rikuperimin dhe ruajtjen e të dhënave (back-up), përbën një tjetër rrezik të konsiderueshëm për sigurinë dhe integritetin e informacionit financiar dhe administrativ. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu II, neni 16, pika 2, Kreu III, neni 22, pika 1 me Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinorit të riskut në njësitë publike”, pika 5.2.7 “Monitorimi dhe Raportimi” dhe “Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të

Ministrit të Financave nr. 8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.3, Kapitulli V, Anekset. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1.1, faqe 16-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse të Bashkisë të marrin masa për ngritjen dhe funksionimin e një sistemi të integruar të kontrollit të brendshëm për hartimin dhe miratimin e procedurave të shkruara për raportimin e shkeljeve të etikës dhe trajtimin e rasteve të mundshme të korrupsionit, si dhe krijimin e një mekanizmi të qartë për menaxhimin e këtyre ankesave në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale. Hartimin e një plani vjetor të rekrutimit, të bazuar në një analizë të nevojave reale të burimeve njerëzore dhe objektivave strategjike të institucionit. Vendosijen e një sistemi të brendshëm raportimi për shkeljet, që lejon identifikimin dhe reagimin në kohë ndaj çështjeve të ndjeshme. Investime në sisteme funksionale IT që plotësojnë nevojat specifike të bashkisë dhe ndërtimin e një politike për rikuperimin dhe ruajtjen e të dhënave (data back-up), për të garantuar sigurinë dhe vazhdimësinë e funksioneve administrative dhe financiare. Përgatitjen e gjurmëve të auditimit për proceset kryesore të punës.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit u konstatua se nga, Njësia e Auditit të Brendshëm të Bashkisë Bulqizë për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2024, nuk janë audituar aktivitete që kryen Bashkia Bulqizë, si Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit si dhe Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të miratuar me Urdhrin e Ministrit nr. 100, datë 25.10.2026. Kapitulli III, pika 3.3;

Në çdo raport auditimi, audituesit nuk kanë dhënë asnjë opinion të përgjithshëm mbi të gjitha sistemet e audituara, nëse këto sisteme funksionojnë në nivelin e duhur nga të gjitha strukturat apo punonjësit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve.

- NjAB në Bashkinë Bulqizë nuk ka dosje të përhershme për çdo njësi publike ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli VI, pika “Dosja e Përhershme”.

-Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Bulqizë nuk ka hartuar “Programin për sigurimin e brendshëm të cilësisë të drejtorisë së auditimit të brendshëm”.

- Një nga Audituesit e Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NjAB) në Bashkinë Bulqizë nuk është i certifikuar sipas kërkesave të përcaktuara në Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, neni 11, neni 19, dhe neni 20 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1.2, faqe 25-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) në Bashkinë Bulqizë të përfshijë në planet vjetore të punës auditimet e aktiviteteve me risk të lartë. Gjithashtu, audituesit duhet të japin një opinion të përgjithshëm mbi funksionimin e sistemeve të audituara në çdo raport auditimi, duke reflektuar vlerësimin e funksionimit të tyre në tërësi nga strukturat përkatëse. Gjithashtu, NjAB të krijojë dhe të mirëmbajë dosje të përhershme për çdo njësi publike të audituar, si referencë për auditimet pasardhëse, NjAB duhet të hartojë dhe zbatojë një Program për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, si dhe të merren masa për përfundimin me sukses të procesit të certifikimit për të gjithë audituesit e Njesisë së Auditimit të Brendshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i përllogaritjes së amortizimit të aktiveve afatgjata rezultoi se janë llogaritur në mënyrë të gabuar amortizimet për dy grup aktiveve si:

- Për aktivet e llogarisë 202 “*Studime dhe kërkime*” është aplikuar norma e amortizimit miratuar në masën 15%, por në përlllogaritje është përdorur metoda e amortizimit “me vlerë të mbetur” dhe jo “me vlerë lineare”, duke sjellë ndikim në gjendjen e aktiveve në PF.

- Referuar analizës së gjendjes së llogarisë 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*”, konstatohet se regjistri analitik i aktiveve të kësaj llogarie nuk është i plotësuar me aktive të ndara në mënyrë të veçantë, por është paraqitur me grup aktivesh. Gjithashtu amortizimi për këtë grup aktivesh është kryer me normë amortizimi 5%, kur norma e amortizimit e miratuar për këto grup aktivesh është në masën 20%.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar, pika 36 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 32-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë masa të menjëhershme për rrillogaritjet e vlerave të amortizimeve sipas metodave dhe normave të klasave përkatëse të miratuara, si dhe të bëhet korigjimi i të dhënave nëpërmjet veprimeve të sistemimit kontabël, duke bërë që llogaritë e aktiveve afatgjata materiale të paraqiten në vlera të sakta dhe të paraqesin gjendjen reale të tyre në PF.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 231 “*Për aktive afatgjata materiale*” e cila pasqyrohet në shumën 232,089,659 lekë në pasqyrën e pozicionit financiar, konstatohet mosrakordim me llogaritë kundërparti të saj në rubrikën “Fondit të konsoliduar” si: llog 106 “*Teprica e granteve kapitale të huaja*” gjendja e së cilës paraqitet në shumën 117,223,816 lekë dhe llogaria 105 “*Teprica e granteve kapitale të brendshme*” gjendja e së cilës paraqitet në shumën 0 lekë, pra me një diferencë prej 114,865,843 lekë. Kjo diferencë është keqklasifikuar në llogarinë 101 “*Teprica(fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar*” në PF. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar, Kap. II, Aneksi 1 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 32-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa të menjëhershme për sistemimin e veprimeve kontabël në llogaritë 106 “*Teprica e granteve kapitale të huaja*” dhe 105 “*Teprica e granteve kapitale të brendshme*” dhe 101 “*Teprica(fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar*” me qëllim paraqitjen sa më të drejtë të investimeve dhe burimeve të investimeve që i përkasin njësisë për periudhën ushtrimore sipas kërkesave të teknikave kontabël.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive analitike të llogarisë sintetike “Detyrime afatshkurtra” në pasiv të formatit 1 “Pozicioni financiar”, u konstatuan mosrakordime në tre llogari përkatësisht:

- Teprica kreditore e llogarisë 42 “*Detyrime ndaj personelit*” në formatin e pozicionit financiar në mbyllje të vitit 2024 paraqitet në shumën 28,144,748 lekë, ndërsa detyrimi i konstatuar për pagat neto sipas listëpagesës E-sig025 të muaji dhjetor 2024 është në shumën 25,273,083 lekë, pra rezulton një diferencë në shumën 2,871,665 lekë, duke mbivlerësuar detyrimin e konstatuar për paga neto për punonjësit për këtë shumë. Kjo diferencë e konstatuar është keqklasifikuar në llogarinë 435 “*Sigurime shoqërore*”.

- Teprica kreditore e llogarisë 435 “*Sigurime shoqërore*” në formatin e pozicionit financiar në mbyllje të vitit 2024 paraqitet në shumën 4,519,798 lekë, ndërsa detyrimi i konstatuar për sigurimet shoqërore sipas listëpagesës së deklaruar në organet tatimore të muaji dhjetor 2024 është në shumën 7,391,463 lekë, duke nënvlerësuar detyrimin e konstatuar për sigurime

shoqërore për punonjësit në shumën 2,871,665 lekë, shumë e cila është keqklasifikuar në llogarinë 42 “Detyrime ndaj personelit”.

Mos pasqyrimi jo të drejtë dhe i saktë të detyrimeve financiare të subjektit për paga, sigurime shoqërore në PF është në kundërshtim me Udhëzimin e MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar pika 5. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 32-56 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa të menjëhershme për konstatimin dhe kontabilizimin e saktë të detyrimeve afatshkurtra në llogaritë 42 “Detyrime ndaj personelit” dhe 435 “Sigurime shoqërore” me qëllim paraqitjen sa më të drejtë të tyre për periudhën ushtrimore sipas kërkesave të teknikave kontabël.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se totali i llogarive të fondit të konsoliduar në pasqyrën e pozicionit financiar në shumën 3,817,579,756 lekë, rakordon me totalin e llogarive të pasqyrës së ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto në shumën 3,817,579,756 lekë.

Nga kryqëzimi i të dhënave konstatohet se për të njëjtat llogari analitike në të dyja pasqyrat paraqiten në shuma të ndryshme, duke u evidentuar diferenca të cilat në mënyrë të detajuar paraqiten më poshtë:

- Teprica e llogarisë 85 “Nga rezultatet e vitit ushtrimor” në pasqyrën e pozicionit financiar në mbyllje të vitit 2024 paraqitet në shumën 290,435,202 lekë ndërsa teprica e kësaj llogarie në pasqyrën e ndryshimeve në fondet neto paraqitet 0 lekë, pra me një diferencë prej 290,435,202 lekë e cila është përfshirë në llogarinë 101 “Teprica(fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar” në pasqyrën e ndryshimeve në fondet neto.

- Teprica e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” në pasqyrën e pozicionit financiar në mbyllje të vitit 2024 paraqitet në shumën 442,152,048 lekë, ndërsa teprica e kësaj llogarie në pasqyrën e ndryshimeve në fondet neto paraqitet në shumën 101,830,342 lekë, pra me një diferencë në shumën 340,321,706 lekë, e cila është përfshirë në llogarinë 101 “Teprica(fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar” në pasqyrën e ndryshimeve në fondet neto.

- Teprica e llogarisë 12 “Nga rezultatet e mbartura” në pasqyrën e pozicionit financiar në mbyllje të vitit 2024 paraqitet në shumën 0 lekë, ndërsa në pasqyrën e ndryshimeve në fondet neto paraqitet në shumën 23,635,354 lekë, pra me një diferencë në shumën 23,635,354 lekë, e cila është përfshirë në llogarinë 101 “Teprica(fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar” në pasqyrën e ndryshimeve në fondet neto.

- Teprica e llogarisë 106 “Nga grantet e jashtme kapitale” në pasqyrën e pozicionit financiar në mbyllje të vitit 2024 paraqitet në shumën 117,223,816 lekë ndërsa në pasqyrën e ndryshimeve në fondet neto paraqitet në shumën 4,088,044 lekë, pra me një diferencë në shumën 113,135,772 lekë, e cila është përfshirë në llogarinë 101 “Teprica(fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar” në pasqyrën e ndryshimeve në fondet neto.

- Nga auditimi i pjesës së tretë të pasqyrës së performancës “Teprica ose Deficiti i Periudhës (Rezultati i Veprimtarisë së vitit Ushtrimor)” konstatohet se rezultati i nxjerrë nuk është i saktë, me diferencë në shumën 26,956,107 lekë, që i përket tepricës së llogarisë 8420 “Transferim i të ardhurave në buxhet” e cila evidentohet në pasqyrën e flukseve monetare në rubrikën III “Transferta të tjera”

Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, Aneksi 1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 32-56 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masat për kryerjen e sistemimeve dhe regjistrimeve në kontabilitet për një pasqyrim më të drejtë të fondit neto, me qëllim që të eliminohen parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë sintetike 602 “Blerje mallra e shërbime” në pasqyrën e performancës financiare në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në shumën 124,609,391 lekë, e cila rakordon me akt rakordimin e thesarit për këtë zë shpenzimesh. Nga auditimi i llogarive analitike të shpenzimeve u konstatua se ka keqklasifikime shpenzimesh mes nënllogarive të klasës 602. Diferencat mes tepricave të paraqitura në pasqyrë me aktrakordimin e thesarit në nivel analitik janë keq klasifikime mes nënllogarive me efekt denatyrimit shpenzimesh. Pavarësisht se rakordojnë me thesarin, ka keqklasifikime brenda llogarive dhe konkretisht:

- Nga verifikimi i tepricës së llogarisë sintetike 6020 “*Materiale zyre e të përgjithshme*” e cila paraqitet në shumën 5,290,340 lekë në mbyllje të vitit 2024 konstatohen keqklasifikime shpenzimesh në shumën 760,800 lekë për shpenzime si “Shërbime eskavatori volvo”, “Projekte elektrike”, “Blerje katrama”, keqklasifikime të cilat denatrojnë paraqitjen e shpenzimeve në pasqyrën e performancës. Gjithashtu konstatohet mosrakordim mes llogarisë sintetike dhe asaj analitike në shumën 2,179,372 lekë.

- Nga verifikimi i tepricës së llogarisë 6021 “*Materiale dhe shërbime speciale*” konstatohet diferencë mes llogarisë sintetike dhe asaj analitike në shumën 47,306,067 lekë. Llogaria sintetike paraqitet në shumën 52,732,662 lekë në pasqyrën e performancës ndërsa llogaria analitike ka të kontabilizuara shpenzime në shumën 5,426,595 lekë.

- Nga verifikimi i tepricës së llogarisë 6022 “*Shërbime nga të tretë*” konstatohet diferencë mes llogarisë sintetike dhe asaj analitike në shumën 27,859,112 lekë. Llogaria sintetike pasqyrohet në shumën 25,053,827 lekë, ndërsa llogaria analitike ka të kontabilizuara shpenzime në shumën 52,912,939 lekë.

- Nga verifikimi i tepricës së llogarisë 6023 “*Shpenzime transporti*” konstatohet diferencë mes llogarisë sintetike dhe asaj analitike në shumën 21,663,465 lekë. Llogaria sintetike paraqitet në shumën 1,166,910 lekë, ndërsa llogaria analitike ka të kontabilizuara shpenzime në shumën 22,830,375 lekë.

- Nga verifikimi i tepricës së llogarisë 6024 “*Shpenzime udhëtimi*” konstatohet diferencë mes llogarisë sintetike dhe asaj analitike në shumën 6,364,156 lekë. Llogaria sintetike pasqyrohet në shumën 7,531,066 lekë në pasqyrën e performancës ndërsa llogaria analitike ka të kontabilizuara shpenzime në shumën 1,166,910 lekë.

- Nga verifikimi i tepricës së llogarisë 6026 “*Shpenzime për qiramarrje*” konstatohet diferencë mes llogarisë sintetike dhe asaj analitike në shumën 6,364,156 lekë. Llogaria sintetike pasqyrohet në shumën 988,760 lekë në pasqyrën e performancës ndërsa llogaria analitike ka të kontabilizuara shpenzime qiramarrje në shumën 7,258,180 lekë.

- Nga verifikimi i tepricës së llogarisë 6029 “*Shpenzime të tjera operative*” konstatohet diferencë mes llogarisë sintetike dhe asaj analitike në shumën 9,012,013 lekë. Llogaria sintetike pasqyrohet në shumën 21,979,776 lekë në pasqyrën e performancës ndërsa llogaria analitike ka të kontabilizuara shpenzime në shumën 12,967,763 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr.8, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme*”, i ndryshuar, Aneksi 1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 32-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masat për kryerjen e regjistrimeve në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, për të kryer dhe

pasqyruar saktë shpenzimet e kryera sipas rregullave kontabël, me qëllim pasqyrimin sa më të saktë të shpenzimeve në pasqyrat financiare.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i PF konstatohet se të hyrat nga të ardhurat jo tatimore në Formatin 3 “Pasqyra e flukseve monetare (Cash Flow)”, nuk rakordojnë me të ardhurat jo tatimore të realizuara në Formatin 2 “Pasqyra e performancës financiare” në shumën 14,938,028 lekë. Shuma 14,938,028 lekë në pasqyrën e flukseve monetare është kontabilizuar në fondet buxhetore për shpenzime korrente, kontabilizimi në këtë llogari është keqklasifikim. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, Aneksi 1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 32-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Financës të merren masat e nevojshme për kryerjen e regjistrimeve kontabël dhe rakordimit të të ardhurave me qëllim pasqyrimin sa më të saktë të tyre në pasqyrat financiare.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Formatit 6 “Investimeve dhe burimeve të financimit” konstatohet se veprimet kontabël në kredi të llogarisë 231 “Për aktive afatgjata materiale” nuk rakordojnë me veprimet në debi të klasës 2 pas kapitalizimeve të aktiveve me një diferencë në shumën 24,514,182 lekë. Kjo shumë nuk është kontabilizuar nëpërmjet llogarisë së investimeve por direkt në klasën 2.

Në llogarinë 105 “Grante të brendshme kapitale nga buxheti” janë akorduar 204,001,812 lekë ndërsa sipas Formatit 3 “Pasqyrës së flukseve monetare” zëri “Akordim fonde buxhetore për shpenzime kapitale (+)” janë në shumën 427,559,455 lekë, duke sjellë një diferencë në shumën 223,557,643 lekë. Kjo diferencë i përket fondeve të trashëguara. Akordimet e kontabilizuara janë paraqitur në shumën neto.

Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, Aneksi 1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 32-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masat për evidentimin e diferencës së konstatuar në shumën 24,514,182 lekë dhe të kryejë sistemimet e regjistrimit në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, për një pasqyrim më të drejtë dhe të saktë të pozicionit financiar, me qëllim që të parandalohen parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurat e ndjekura për hipotekimin dhe vlerësimin e pronave të paluajtshme të transferuara me VKM nga pushteti qendror, u konstatua se Bashkisë Bulqizë i janë transferuar në përdorim/pronësi 2068 asete dhe 43209.66 ha pyje e kullota, nga të cilat ka të regjistruara dhe pajisur me çertifikatë vetëm 85 asete, rrjedhimisht dhe të inventarizuara. Për pjesën tjetër të pasurive të pa luajtshme dhe parcelat nga fondi pyjor/kullosor nuk është kryer përditësimi i inventarit dhe nuk janë marrë masa për përgatitjen e dokumentacionit tekniko-ligjor të tyre për të vijuar me procesin e aplikimit dhe regjistrimit të tyre në DVASHK Dibër, duke mos pasur informacion për gjendjen e tyre, nëse janë ende ekzistente, të zaptuara, dëmtuara, në proces legalizimi nga individë etj. Gjithashtu nuk ka vlerësim të pasurive të paluajtshme si ato të certifikuara dhe ato të pa certifikuara, duke mos evidentuar si aktive në PF me ndikim në pasqyrimin e gjendjes reale të pasurisë së kësaj njësie vendore.

Për aktivet afatgjata materiale të evidentuara në llogaritë: llog.210 “Toka, troje, terrene” në vlerën 5,193,576 lekë, llog.211 “Pyje, kullota plantacione” në vlerën 16,494,469 lekë dhe llog. 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 1,032,069,149 lekë Bashkia Bulqizë nuk ka kryer asnjë veprim për regjistrimin në ASHK në pronësi të saj. Pra kontabilizimi i këtyre aktiveve nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, Kreu I, pika 4, Kreu III, pika 35. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 32-56 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).

10.1 Rekomandimi: Bashkia Bulqizë nëpërmjet Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës dhe Drejtorisë së Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Kontratave, të marrë masa për identifikimin e gjendjes së aseteve të mbetura pa regjistruar, të cilat i janë transferuar në pronësi në mënyrë përfundimtare, si dhe të fillojë përgatitja e dokumentacionit tekniko ligjor të secilit prej tyre për të vijuar me aplikimet përkatëse në ASHK, Drejtoria Vendore Dibër, për pajisje me çertifikatë pronësie. Më pas të vijohet me vlerësimin dhe kontabilizimin e aseteve (akiveve) të pa vlerësuara, në mënyrë që këto aktive kjo njësi vendore ti zotërojë e të sigurojë njohjen në kontabilitet mbi bazën e dokumenteve ligjorë.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Të ardhurat nga taksat dhe tarifat janë realizuar në shumën 127,198 mijë lekë nga 111,663 mijë lekë të parashikuara, ose në masën 114%. Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave konstatohet se:

- Për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në nivel të ulët si:

taksa mbi tokën bujqësore në masën 11%, taksa e fjetjes në hotel masën 16%, taksa mbi truallin në masën 64%, tarifa e pastrimit për familjet në masën 49%, tarifa e gjelbërimit nga familjet në masën 43%, tarifa e ndriçimit publik në masën 68%, tarifë për licencë për tregtimin e hidrokarbureve në masën 65%, tarifë për shërbimet shtesë nga zjarrfikësja në masën 56%, debitorë në vite në masën 48%

- Për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet mbi planin në masa të konsiderueshme si:

taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja në masën 138%, taksa e tabelës në masën 115%, taksa e rentës minerare në masën 171%, Tatimi mbi të ardhurat personale në masën 152%, tarifa për parkimin publik në masën 271%, tarifat për pyjet dhe kullotat në masën 127%, tarifa për kopshte dhe çerdhe në masën 153%

Ky fakt tregon se planifikimi i të ardhurave në disa zëra nuk është bërë mbi baza reale dhe realizimi i viteve të mëparshme nuk është marrë në konsideratë në planifikim. Gjithashtu për një pjesë të ardhurash nuk është bërë punë e mjaftueshme për arkëtimin e tyre, gjë që ka sjellë ndikim negativ në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 5/a, dhe 6. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 32-56 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).

11.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave të marrë masa që në hartimin e buxhetit për të ardhurat të ketë në konsideratë realizimin faktik të vitit paraardhës dhe të kryejë procedurat për përfshirjen e gjithë kapaciteteve tatimore në planifikim.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.897/7 prot., datë 18.09.2024, rezulton se nga Bashkia Bulqizë nuk është respektuar afati 6 mujor i kthimit të përgjigjes për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve,

në kundërshtim me nenin 30, pika 2 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

- Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Nga **14** masa organizative të rekomanduara gjithsej, **7** janë zbatuar plotësisht, **1** është në proces zbatimi, **1** është zbatuar pjesërisht dhe **5** nuk janë zbatuar.

- Nga **1** masë e rekomanduar për arkëtimin e detyrimeve në vlerën 99,933,852 lekë për tatim taksat vendore (të ardhura të munguara) të rekomanduara, **1** masë është zbatuar pjesërisht.

- Nga **4** masa të rekomanduara për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, me efekt mungesë të ardhurash në vlerën 42,132,697 lekë, **2** masa janë zbatuar pjesërisht, **2** masa janë pa zbatuar.

- Nga **1** masë e rekomanduar për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike, **1** masë është zbatuar.

- Nga **1** masë disiplinore e rekomanduar për **3** punonjës, **3** masa nuk janë zbatuar.

Niveli i pranimit të rekomandimeve është 100% dhe realizimi në masën 40%. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 56-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1 Rekomandimi: Gjatë procesit të auditimit u konstatuan përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që rezultojnë ende të pazbatuara. Me qëllim unifikimit dhe rritjen e efektivitetit të ndjekjes së masave korrigjuese, rekomandimet e përsëritura do të konsiderohen në një të vetme dhe do të rikërkohen në mënyrë të centralizuar në vijim të këtij raporti.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përshpejtimin e atyre në proces zbatimi, si më poshtë:

A. Masat Organizative

2.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Bulqizë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për identifikimin e gjendjes së aseteve të mbetura pa regjistruar, të cilat i janë transferuar në pronësi në mënyrë përfundimtare, si dhe të fillojë përgatitja e dokumentacionit tekniko ligjor të secilit prej tyre për të vijuar me aplikimet përkatëse për pajisje me certifikatë pronësie.

8.1.Rekomandimi: Bashkia Bulqizë, të marrë masa që të krijojë një grup pune me specialistë të fushës, me qëllim transferimin në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” sh. a të 1 (një) artikulli të mbetur pjesë të inventarit të aktiveve, duke ndjekur procedurat e marrjes në dorëzim të firmosura nga të dy palët, si dhe të kryej veprimet kontabël në mbyllje të pasqyrave financiare duke zbritur e mbetur prej 225,599,068 lekë.

9.1.Rekomandimi: Bashkia Bulqizë të marrë masa që për aktivet të cilat kanë qenë pjesë e llogarisë 24 “Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara” të konsideruara si mjete të dëmtuara për vlerën 11,955,591 lekë, të bëjë grupimin e tyre si dhe të ngrëjë komision për asgjësimin dhe vlerësimin si mbeturinë (skrap) me qëllim shitjen e tyre duke realizuar të ardhura. Kjo si rrjedhojë edhe e faktit që këto aktive nuk figurojnë më si pjesë e kësaj llogarie në kontabilitet, pasi janë bërë veprimet e amortizimit total të tyre duke bërë që në fund të vitit 2023 këto aktive të rezultojnë në vlerën 0 lekë, pra të amortizuara totalisht.

11.1.Rekomandimi: Nga Drejtoria e Financës në Bashkinë Bulqizë të merren masat që në vijimësi:

- Të kryhet procesi i inventarizimit duke mundësuar realizimin e të gjitha fazave të tij, si inventarizimi fizik, vlerësimi i gjendjes së aktiveve dhe nxjerrja jashtë përdorimit për aktivet sipas nevojës, duke u bazuar në gjendjen e tyre reale të amortizimit, të evidentuar gjatë procesit të inventarizimit.

- Të hartohet dhe miratohet një regjistër aktivesh ku të paraqiten të gjitha aktivet që zotëron apo ka në administrim Bashkia Bulqizë, si dhe të hartohet një rregullore specifike për ndjekjen e procedurave të ruajtjes, mbrojtjes dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike.

13.1.Rekomandimi: Nga Drejtoria e Financës në Bashkinë Bulqizë të merren masat që në vijimësi të paraqiten në mënyrë të saktë dhe reale vlerat e llogarive të klasës 7 në pasqyrën e performancës financiare, në mënyrë që të kuadrojnë me akt-rakordimet e thesarit.

14.1 Rekomandimi: Sektori përgjegjës për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave pranë Bashkisë Bulqizë, të marrë masa për hartimin e planeve të menaxhimit apo mbarështimit për secilën prej ngastrave që ka në pronësi përpara dhënies së tyre në përdorim, si dhe të lidhë kontratat për dhënie në përdorim duke respektuar llojin e përdorimit të planifikuar në plane menaxhimi.

C. Masa për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave me efekt mungesë ardhurash

1.1 Rekomandimi: Bashkia Bulqizë, Drejtoria e të Ardhurave të marrin masa për identifikimin e saktë të listave të debitorëve, detyrimi i të cilëve nuk është kontabilizuar dhe të dërgojë pranë Drejtorisë së financës listat përkatëse për kontabilizimin e detyrimit prej 3,577,360 lekë.

2.1.Rekomandimi: Bashkia Bulqizë, Drejtoria e të Ardhurave, të marrë masa që me shkresë zyrtare të dërgohen në Drejtorinë e Financës për kontabilizim detyrimet e papaguara, si dhe për pajisjen me Autorizim/Licencë për shitje karburanti dhe të zbatohen të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin nga 7 subjekte të vlerës 5,800,000 lekë

3.1.Rekomandimi: Bashkia Bulqizë, Drejtoria e të Ardhurave, të marrë masa që me shkresë zyrtare të dërgohen në Drejtorinë e Financës për kontabilizim listat me vlerat e taksës së llogaritur dhe të zbatohen procedurat ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit për 44 persona me vlerë 1,273,024 lekë.

4.1. Rekomandimi: Bashkia Bulqizë, Drejtoria e të Ardhurave, të marrë masa që me shkresë zyrtare të dërgohen në Drejtorinë e Financës për kontabilizim listat me vlerat e qirave të papaguara dhe të zbatohen të gjitha procedurat administrative e ligjore për të kërkuar zbatimin e kontratave dhe arkëtimin nga 7 subjekte të vlerës 31,482,313 lekë.

Menjëherë

B. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion rezultoi se, ka nivel të lartë debitorësh në numër dhe në vlerë për taksat dhe tarifat vendore, ku në **fund të vitit 2023 vlera debitorëve është 99,933,852 lekë**, shtesat gjatë vitit 2024 janë në shumën 14,530,797 lekë dhe janë kryer arkëtime në shumën 4,839,489 lekë. Detyrimet progresive **në fund të vitit 2024** janë në shumën **109,625,160 lekë**, e cila përbëhet nga:

- Detyrimet debitore nga biznesit i madh dhe i vogël në shumën 84,305,448 lekë.

- Detyrimet debitore nga familjarët në shumën 25,037,908 lekë.

Mos arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga taksapaguesit debitorë ka sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, nenet 6 dhe 9/pika 1.3.

„Për vjeljen e detyrimeve, Drejtoria e të Ardhurave është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e njoftim-vlerësimeve dhe nuk është aplikuar asnjë masë tjetër shtrënguese, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89, 90, 91 dhe 93 dhe me VKB nr. 104, datë 04.12.2023 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore dhe kundërvajtjet administrative për vitin 2024”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 32-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 1.1: Drejtoria e të Ardhurave të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimeve tatimore për debitorët dhe në vijim të ndjekë të gjitha rrugët ligjore në rend shterues, për arkëtimin e detyrimeve debitore në shumën **109,625,160 lekë** nga subjektet e biznesit dhe taksapaguesit familjarë.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se nga shuma progresive e debitorëve nga taksat dhe tarifatat vendore prej 109,625,160 lekë është kontabilizuar vetëm vlera prej 107,182,804 lekë dhe diferenca prej 2,442,356 lekë dhe nuk është kontabilizuar në llogarinë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” në aktiv të Formatit 1 “Pasqyra e pozicionit financiar” të pasqyrave financiare, duke mos u njohur si e drejtë e konstatuar për tu arkëtuar dhe për pasojë konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e bashkisë. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr.5, datë 21.02.2022 “*Për disa ndryshime në UMFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar, Kap. III, pika 3.2, paragrafi “Vlerësimi i të drejtave dhe detyrimeve” faqe 28-30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 32-56, Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave të marrë masa për identifikimin e saktë të listave të debitorëve, detyrimi i të cilëve nuk është kontabilizuar dhe të dërgojë pranë Drejtorisë së Financës listat përkatëse për kontabilizimin e detyrimit prej 2,442,356 lekë.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit dhe të dhënave të vënë në dispozicion konstatohet se:

- Në lidhje me detyrimet për taksën në infrastrukturë nga legalizimet e ndërtimeve pa leje në fund të vitit 2023 kanë qenë 44 individë në shumën 1,273,024 lekë, nga të cilët gjatë vitit 2024 kanë likuiduar detyrimin 4 individë në shumën 332,765 lekë. Në fund të vitit 2024 rezulton të jenë debitorë 40 persona me vlerë 940,259 lekë, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e bashkisë. Mos arkëtimi i detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë është në kundërshtim VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “*Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim*”, pika 5, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “*Për Sistemin e Taksave vendore*”, i ndryshuar, neni 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, pika 3 dhe me paketën fiskale.

Gjithashtu vlera debitore prej 940,259 lekë për TNI në fund të vitit 2024 nuk është kontabilizuar në llogarinë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” në aktiv të Formatit 1 “Pasqyra e pozicionit financiar” të pasqyrave financiare në papajtueshmëri me UMF nr. 5, datë 21.02.2022 “*Për disa ndryshime në UMFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar, Kap. III, pika 3.2, paragrafi “Vlerësimi i të drejtave dhe detyrimeve” faqe 28-30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 32-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave dhe Drejtoria e Financës të marrin masa që, të kryhen veprimet për kontabilizimin detyrimeve debitore sipas listave me vlerat e taksës të llogaritur dhe të zbatohen procedurat ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit për 40 persona në shumën 940,259 lekë.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se 9 subjekte ushtrojnë aktivitetet të tregtimit të karburanteve me seli në territorin e Bashkisë Bulqizë. Nga këto 2 subjekte nuk janë pajisur me autorizim/licencë për shitje karburanti, për të cilët nuk është asnjë masë shtrënguese. Ndërsa nga 7 subjektet e tjerë, 3 prej tyre kanë likuiduar pjesërisht vlerën e plotë dhe 4 subjekte nuk kanë likuiduar detyrimet gjithsej në vlerën 5,800,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë. Kjo vlerë debitore nuk është evidentuar në kontabilitet në llog. 468 “*Debitorë të ndryshëm*”. Këto veprime janë në papajtueshmëri me Ligjin nr. 10296, datë

08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 22, pika 3, germa “dh” me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 35, VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, me UMF nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në UMFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kap. III, pika 3.2, paragrafi “Vlerësimi i të drejtave dhe detyrimeve” faqe 28-30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 32-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave të marrë masa që me shkresë zyrtare të dërgojë në Drejtorinë e Financës për kontabilizim detyrimet debitore nga tregtimi i karburanteve në vlerën 5,800,000 lekë. Po kështu, të zbatohen të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin nga 7 subjektet të vlerës debitorë, duke vijuar edhe me pajisjen e tyre me autorizimet përkatëse.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Bulqizë janë lidhur dhe administrohen 16 kontrata për dhënie me qira të parcelave nga fondi pyjor/kullosor me sipërfaqe 107863 ha, me afate 10 dhe 35 vjeçare. Nga auditimi në lidhje me arkëtimin e të ardhurave nga dhënia me qira të parcelave nga fondi pyjor/kullosor u konstatua se, në fund të vitit 2024 paraqiten debitorë 4 shoqëri qiramarrëse që nuk kanë shlyer detyrimet e kontratës në vlerën 30,038,472 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë. Gjithashtu nuk është bërë në mbyllje të PF të vitit ushtrimor 2024 kontabilizimi në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” i vlerës debitore prej 30,038,472 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me kontratat përkatëse të lidhura të qiradhënies neni 4 “vlera e qirasë vjetore” dhe neni 5 “pagesa dhe regjimi i saj”, me Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar neni 830, me UMF nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kap. III, pika 3.2, paragrafi “Vlerësimi i të drejtave dhe detyrimeve” faqe 28-30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 32-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave të marrë masa që me shkresë zyrtare të dërgohen në Drejtorinë e Financës për kontabilizim listat me vlerat e qirave të papaguara dhe të zbatohen të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin nga 4 subjekte të vlerës 30,038,472 lekë.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, t’i kërkojë Komisionit Disiplinor të ngritur pranë këtij Institucioni, që bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore si më poshtë:

a -“Vërejtje” neni 58 shkronja (a), për 2 punonjës, si më poshtë:

1. Z. R. B. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe hartuesit të pasqyrave financiare, për parregullsitë dhe pasaktësitë e konstatuara në pasqyrat financiare në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar.

2. Z. R. H. me detyrë Drejtor i të Ardhurave

Për problemet e konstatuara në lidhje me arkëtimin e të ardhurave të bashkisë dhe monitorimin e borxhit në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30/10/2006 “*Për sistemin e taksave vendore*”, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, me ligjin nr. 68/2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*” i ndryshuar, me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “*Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim*”, me Ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 “*Kodi civil i Republikës së Shqipërisë*” i ndryshuar.

E. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër (Drejtorja e Burimeve Njerëzore e Institucionit), pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013 “*Për Nëpunësin Civil*”, të ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të Ligjit nr. 152/2013 “*Për Nëpunësin Civil*”, të ndryshuar.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT